



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 139

Tiranë – E martë, 26 shtator 2023

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 542, datë 20.9.2023	Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023–2030 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj.....	15823
Udhëzim i ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 1, datë 19.9.2023	Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 4, datë 31.12.2020, “Mbi kriteret dhe procedurën për certifikimin e operatorëve të turizmit detar”.....	15876
Udhëzim i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 106, datë 12.9.2023	Për një ndryshim në udhëzimin nr. 10, datë 20.4.2022, “Për përcaktimin e procedurës, llojit dhe mënyrës për dhënien e shërbimeve <i>online</i> të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar”, të ndryshuar.....	15878
Urdhër i drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave nr. 498, datë 20.9.2023	Për delegim kompetencash.....	15878
Vendim i Gjykatës së Lartë nr. 00-2023-3406 (258), datë 7.7.2023	Me objekt përcaktimin e kompetencës lëndore midis Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.....	15879

**VENDIM****Nr. 542, datë 20.9.2023**

**PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË
KOMBËTARE PËR KËRKIMIN
SHKENCOR, TEKNOLOGJINË DHE
INOVACIONIN 2023–2030 DHE TË
PLANIT TË VEPRIMIT PËR ZBATIMIN
E SAJ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Strategjisë Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023–2030 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe të gjitha ministritë e institucionet përgjegjëse të përmendura në tekstin e kësaj strategjie për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku**

**STRATEGJIA KOMBËTARE
PËR KËRKIMIN SHKENCOR,
TEKNOLOGJINË DHE INOVACIONIN
2023–2030
Tiranë, 2023**

Përmbajtja

PJESA I: KONTEKSTI STRATEGJIK

1. Përmbledhje dhe qëllimi i dokumentit strategjik

Performanca e Shqipërisë në programet kombëtare dhe ndërkombëtare të kërkimit shkencor (veçanërisht në programin kuadër H2020)

Raportet e Komisionit Evropian për vitin 2021–'22

2. Korniza ligjore dhe institucionale, arritjet dhe mësimet e nxjerra

Lidhja me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2022–2030 (SKZHI III)

Lidhja me dokumente dhe strategji kombëtare

- Strategjia e Arsimit 2021–2026

- Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030

- Plani kombëtar për zhvillimin e qëndrueshëm të infrastrukturës digjitale *broadband* 2020–2025, miratuar me vendimin nr. 434, datë 3.6.2020, të Këshillit të Ministrave

Lidhja me PKIE-n & *acquis* të BE-së

Lidhja me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ)

Lidhja me angazhime/marrëveshje të tjera ndërkombëtare

PJESA II – QËLLIMET E POLITIKAVE DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKË TË SKKSHTI 2023–2030

Objektivat specifikë:

-Institucionet drejtuese

-Institucioni pjesëmarrës

Lidhja midis qëllimit të politikës dhe Objektive të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) 34

Objekti i Specifik 1.1: Plotësimi dhe zbatimi i kuadrit ligjor dhe rregullator për të garantuar cilësinë, etikën dhe efektivitetin në zhvillimin dhe aplikimin e kërkimit në përputhje me fushat prioritare

Analiza e Situatës dhe Sfidat

Rezultatet që pritet të arrihen përmes zbatimit të masave që lidhen me objektivin specifik.

Institucionet drejtuese

Institucionet pjesëmarrëse

Lidhja e objektivit specifik me nënkapitullin përkatës të BE-së sipas MSA-së

Lista e masave për arritjen e objektivit specifik 1.1

Treguesit kryesorë të rezultateve

Objekti i Specifik 1.2: Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore dhe infrastrukturës mbështetëse të kërkimit shkencor (infrastrukturës akademike) për rritjen e performancës në programet kombëtare dhe ndërkombëtare

Analiza e Situatës dhe Sfidat

Rezultatet që pritet të arrihen përmes zbatimit të masave që lidhen me objektivin specifik

Institucionet drejtuese

Institucionet pjesëmarrëse

Lidhja e objektivit specifik me nënkapitullin përkatës të BE-së sipas MSA-së

Lista e masave për arritjen e objektivit specifik 1.2

Treguesit kryesorë të rezultateve

Objekti i Specifik 1.3: Përmirësimi i mbledhjes, përpunimit, interpretimit dhe publikimi i treguesve



statistikorë dhe të tjerë të kërimit, zhvillimit të teknologjisë dhe inovacionit

Analiza e Situatës dhe Sfidat

Rezultatet që pritet të arrihen përmes zbatimit të masave që lidhen me objektivin specifik

Institucionet drejtuese

Institucionet pjesëmarrëse

Lidhja e objektivit specifik me nënkapitullin përkatës të BE-së sipas MSA-së

Lista e masave për arritjen e objektivit specifik 1.3

Treguesit kryesorë të rezultateve

Qëllimi i Politikës 2:

Qëllimi i Politikës 2: Krijimi i një mjedisi që lehtëson dhe inkurajon mekanizmat e ndërveprimit dhe transferimit të teknologjive për bashkëpunim midis komunitetit të kërimit, ekonomisë, inovacionit dhe institucioneve publike

Objekti i Specifik 2.1: Rritja e bashkëpunimit ndërmjet Institucioneve të Arsimit të Lartë, institucioneve të pushtetit qendror dhe pushtetit vendor, sektorit të biznesit dhe shoqërisë civile nëpërmjet zgjerimit të kërimit dhe zhvillimit të projekteve të përbashkëta (*Quadruple Helix Model*)

Analiza e Situatës dhe Sfidat

Rezultatet që pritet të arrihen përmes zbatimit të masave që lidhen me objektivin specifik

Institucionet drejtuese

Institucionet pjesëmarrëse

Lidhja e objektivit specifik me nënkapitullin përkatës të BE-së sipas MSA-së

Lista e masave për arritjen e objektivit specifik 2.1

Treguesit kryesorë të rezultateve

Objekti i Specifik 2.2: Përmirësimi i mekanizmave dhe rritja e mbështetjes së transferimit ndërkombëtar të teknologjisë (TNT).

Analiza e Situatës dhe Sfidat

Rezultatet që pritet të arrihen përmes zbatimit të masave që lidhen me objektivin specifik.

Institucionet drejtuese

Lidhja e objektivit specifik me nënkapitullin përkatës të BE-së sipas MSA-së

Lista e masave për arritjen e objektivit specifik 2.2

Objekti i Specifik 2.3: Rritja e rolit të shkencës dhe inovacionit në zhvillimin teknologjik

Analiza e Situatës dhe Sfidat

Rezultatet që pritet të arrihen përmes zbatimit të masave që lidhen me objektivin specifik

Institucionet përgjegjëse drejtuese

Institucionet kryesore pjesëmarrëse

Lidhja e objektivit specifik me nënkapitullin përkatës të BE-së sipas MSA-së

Lista e masave për arritjen e objektivit specifik 2.3

Treguesit kryesorë të rezultateve

Objekti i Specifik 2.4: Fuqizimi dhe rritja e kapaciteteve të qendrave të transferimit të teknologjisë për të avancuar njohuritë në një fushë të caktuar ose për të zhvilluar më tej teknologjinë

Analiza e Situatës dhe Sfidat

Rezultatet që pritet të arrihen përmes zbatimit të masave që lidhen me objektivin specifik

Institucionet përgjegjëse drejtuese

Institucionet kryesore pjesëmarrëse

Lidhja e objektivit specifik me nënkapitullin përkatës të BE-së sipas MSA-së

Lista e masave për arritjen e objektivit specifik 2.4

Treguesit kryesorë të rezultateve

Qëllimi i Politikës 3

Qëllimi i Politikës 3: Promovimi i kulturës së shkencës dhe inovacionit në edukim për të siguruar një qasje didaktike me theksin në praktikat kërkimore dhe projektet

Objekti i Specifik 3.1: Reformimi i kurrikulës së shkencës në arsimin parauniversitar duke përfshirë STEM në edukim

Analiza e Situatës dhe Sfidat

Rezultatet që pritet të arrihen përmes zbatimit të masave që lidhen me objektivin specifik

Institucionet përgjegjëse drejtuese

Institucionet kryesore pjesëmarrëse

Lidhja e objektivit specifik me nënkapitullin përkatës të BE-së sipas MSA-së

Lista e masave për arritjen e objektivit specifik 3.1

Treguesit kryesorë të rezultateve

Objekti i Specifik 3.2: Sensibilizimi në të gjitha nivelet e edukimit parauniversitar, për fuqizimin e rolit të të rinjve në kërkim dhe inovacion

Analiza e Situatës dhe Sfidat

Objekti i Specifik 3.3: Zhvillimi i kompetencës digjitale

Analiza e Situatës dhe Sfidat

Pjesa IV: Zbatimi, llogaridhënia dhe koordinimi

PJESA V: Plani i veprimit dhe vlerësimet financiare

Nevojat për shpenzime kapitale dhe shpenzime korente

Aneks 1 Plani i veprimit i kostuar

Aneks 2 Treguesit e monitorimit të dokumentit të strategjisë

**Lista e shkurtimeve**

ACRIS:	Sistemi Shqiptar i Informacionit të Kërkimit Shkencor
AIDA:	Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve
AKFAL:	Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë
AKSHI:	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Inovacionit
AKKSHI:	Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit
AMSHC:	Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile
ASHSH:	Akademia e Shkencave e Shqipërisë
COST:	<i>European Cooperation in Science and Technology</i> (Bashkëpunimi Evropian në Shkencë dhe Teknologji)
ERA:	<i>European Higher Education Area</i> (Zona Evropiane për Kërkim)
EEA:	Zona Evropiane e Arsimit
ERP:	<i>Economic Reform Programme</i> (Programi i Reformave Ekonomike)
ESFRI:	<i>European Strategic Framework of Research Infrastructure</i>
INSTAT:	Instituti i Statistikave
IPSIS:	Sistemi Informatik i Planifikimit të Integruar
KE:	Komisioni Evropian
MAS:	Ministria e Arsimit dhe Sportit
MBZHR:	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
MEPJ:	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
MFE:	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MIE:	Ministria e Infrastrukturës dhe Ekonomisë
MK:	Ministria e Kulturës
MM:	Ministria e Mbrojtjes
NCP:	<i>National Contact Point</i>
NVM:	Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme
QTT:	Qendra e Transferimit të Teknologjive
PBA:	Planifikimi Buxhetor Afatmesëm
RCC:	<i>Regional Cooperation Council</i>
RVN:	Raporti i Vlerësimit të Ndikimit
RSH:	Republika e Shqipërisë
SASPAC:	Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndhmës
SEE-2020:	<i>South East Europe Strategy 2020</i>
SEEDS:	<i>South East Europe Data Services</i>
SHTI:	Shkenca, Teknologjia dhe Inovacioni
SKKSHTI:	Strategjia Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin

PJESA I – KONTEKSTI STRATEGJIK**1. Përmbledhje dhe qëllimi i dokumentit strategjik**

Strategjia Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin (SKKSHTI) 2023–2030 u hartua në përfundim të ciklit të SKKSHTI 2017–2022. Kjo strategji është hartuar si një dokument politikash afatmesëm, e shtrirë në 8 vite, duke qenë në këtë mënyrë në përputhje edhe me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2022–2030. Gjithashtu, strategjia është hartuar në përputhje dhe kontribuon në realizimin e Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, e miratuar në

vitin 2015 nga qeveria shqiptare. Në këtë dokument strategjik parashikohet në një formë gjithëpërfshirëse vizioni i strategjisë, qëllimet e politikave, objektivat specifike për secilin qëllim dhe masat e nevojshme për arritjen e secilit objektiv specifik. Në të njëjtën kohë, dokumenti strategjik parashikon edhe treguesit kryesorë të performancës, me qëllim matjen e rezultateve për arritjen e objektiveve specifike dhe përmbushjen e qëllimeve të politikave. Për të siguruar arritjen e objektiveve specifike, SKKSHTI është shoqëruar me Planin e Veprimit të Strategjisë që mbulon të njëjtën periudhë 2023–2030, si edhe parashikon buxhetin e



nevojshëm për realizimin e masave të parashikuara për çdo objektiv dhe qëllim politik. Plani i veprimit është hartuar me synimin për të zërthyer në hollësi masat e detajuara që secili institucion do të ndërmarrë në përmbushje të secilit objektiv specifik, me qëllimin final përmbushjen e qëllimeve të politikës dhe arritjen e vizionit të qeverisë shqiptare në kuadër të kërimit shkencor, teknologjisë dhe inovacionit.

Duke marrë në konsideratë se kërkit shkencor dhe inovacioni ka një sferë të gjerë veprimi dhe ndërthuret me disa fusha, ky dokument është konceptuar si një strategji ombrellë, e cila do të përmbajë objektivat më të rëndësishme për përmbushjen e qëllimeve politike në fushën e kërimit shkencor, teknologjisë dhe inovacionit nën drejtimin e ministritë përgjegjëse për arsimin dhe kërkitin shkencor.

Performanca e Shqipërisë në programet kombëtare dhe ndërkombëtare të kërimit shkencor (veçanërisht në programin kuadër H2020)

Strategjia e re për Ballkanin Perëndimor, prezantuar nga Komisioni Evropian në 2018, njeh “edukimin, kulturën, rininë dhe sportet së bashku me kërkitin shkencor dhe inovacionin”, si treguesit kryesorë për të nxitur zhvillimin ekonomik të rajonit, konkurrencën dhe kohezionin social.¹

Pjesëmarrja e Shqipërisë në *Horizon 2020* është përmirësuar dhe ka arritur rezultate të kënaqshme. Lidhur me këtë program, gjatë periudhës 2014–2022 janë paraqitur një numër total prej 605 aplikimesh nga të cilat janë shpallur fitues 53 aplikime për pjesëmarrje në veprime të *Horizon 2020*, duke përfutur 5.82 milionë euro të kontributit të drejtpërdrejtë të BE-së. Gjithashtu, gjatë periudhës 2017–2022, janë rritur aplikimet dhe projektet e fituara me më shumë se 10% në vit. Shkalla e suksesit të propozimeve me pjesëmarrje shqiptare është 8,7% (nga 7,8% që nga viti i kaluar) krahasuar me 12,1% normë suksesi të vendeve në *Horizon 2020*. Rezultatet e Shqipërisë në programin *Horizon 2020* janë pothuajse tre herë më të larta se e njëjta periudhë e programit paraardhës (FP7). Megjithatë, pjesëmarrja e sektorit privat në program vazhdon të mbetet veçanërisht e ulët.²

Përmes marrëveshjeve dypalëshe për bashkëpunim shkencor dhe teknologjik, AKKSHI ka krijuar hapësira për lehtësimin e lëvizjes së kërkuësve të huaj. AKKSHI aktualisht po monitoron zbatimin e Marrëveshjeve me Republikën e Italisë, Austrisë, Kosovës. Gjithashtu, Shqipëria është duke rishikuar marrëveshjen ekzistuese me Turqinë, si dhe duke hartuar një marrëveshje të re me Republikën e Maltës. Aktualisht ekzistojnë marrëveshje ndërkombëtare të bashkëpunimit dypalësh, të ndara si më poshtë:

- 32 (tridhjetë e dy) marrëveshje me vendet e BE-së;

- 5 (pesë) marrëveshje me vendet e Ballkanit Perëndimor;

- 6 (gjashtë) marrëveshje me shtete në Amerikë, Azi, Afrikë.

Në kuadër të programit *Horizon 2020*, AKKSHI ka organizuar 250 ditë informuese dhe trajnuese, në IAL-të publike dhe jopublike. Një fokus të veçantë kanë pasur Thirrjet Tematike *Horizon 2020* në ardhje, rrjetet NCP, CORDIS dhe gjetja e partnerëve.

Një nga detyrat e Sektorit të Marrëdhënieve Multilaterale, gjatë vitit 2021, ka qenë nxitja dhe përfshirja e Agjencisë Kombëtare të Kërimit Shkencor dhe Inovacionit, AKKSHI, si organizatë partnere në projekte të ndryshme në kuadër të *Horizon Europe*, IPA, IPA *Cross-Border* e INTEREG.

Me rëndësi ishte pjesëmarrja gjatë 2021–2022 në 5 projekte fituese, në kuadër të *Horizon Europe*, IPA, IPA *Cross-Border* e INTEREG. Gjithashtu, nga prilli i vitit 2018, Shqipëria është një nga anëtarët e COST pasi plotësoi kushtin e pjesëmarrjes në të paktën 5% të veprimeve COST.

Në 2021, Shqipëria është bërë anëtare e plotë e programit EUREKA. Në të njëjtën kohë, ajo është e angazhuar në mënyrë aktive në Bashkëpunimin Evropian në Shkencë dhe Teknologji (COST) me pjesëmarrjen e rreth 200 kërkuësve shqiptarë. Me rëndësi shihet pjesëmarrja në Vlerësimin Evropian të Inovacionit (*European Innovation Scoreboard*)³. Kërkitin shkencor, inovacioni dhe zhvillimi janë gjithashtu prioritete të shtetit shqiptar, në kuadër të

¹OECD (2020), *Education in the Western Balkans: Findings from PISA, PISA, OECD Publishing*, fq 3. Paris, <https://doi.org/10.1787/764847ff-en>.

²Albania 2021 Report, European Commission, Strasbourg, 19.10.2021, SWD (2021) 289 final, faqe 99.

³Albania 2021 Report, European Commission, Strasbourg, 19.10.2021, SWD (2021) 289 final, faqe 99.



programit të BE-së për Reformën Ekonomike (ERP).⁴

Për më tepër, Shqipëria ka marrë pjesë, me mbështetjen e IPA-s, në programet e bashkëpunimit ndërkombëtar të BE-së: Erasmus+, Evropa Kreative (Kultura dhe Media), Punësimi dhe Inovacioni Social, Programi për Konkurrueshmërinë e Ndërmarrjeve dhe Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (COSME), Drejtësia, Evropa për Qytetarët dhe Agjencia për të Drejtat Themelore të BE-së.⁵ Në vitin 2022, Shqipëria nënshkroi Marrëveshjen e Asocimit *Horizon Europe*, e cila nënvizon rëndësinë që do të luajë në të ardhmen bashkëpunimi në fushën e kërkimit dhe inovacionit dhe fuqinë transformuese të politikave të kërkimit shkencor dhe inovacionit në përshejtimin e reformave në fushën e digjitalizimit, ekonomisë së gjelbër dhe zhvillimeve teknologjike.⁶

Gjithashtu, Shqipëria ka marrë pjesë në ciklet e vlerësimit ndërkombëtar të studentëve të kryer nga Organizata për Zhvillimin dhe Bashkëpunimin Ekonomik (OECD) nga viti 2000. Po kështu, Shqipëria ka qenë pjesë e shteteve të Ballkanit Perëndimor që ka përfunduar në vitin 2020 rishikimin e politikave arsimore nga OECD në bashkëpunim me UNICEF.⁷

Në drejtim të inovacionit, krijimi i një ekosistemi të favorshëm për *startup*-et është bërë një prioritet për Shqipërinë. Në 2022-shin u miratua ligji për inovacionin i dedikuar për *startup*-et, i cili parashikon një ndarje të buxhetit të shtetit në mbështetje të ekosistemit të inovacionit. Janë ngritur nisma të shumta të mbështetura nga sektori privat, ofrimi i programeve të përshejtit për *startup*-et me potencial të lartë, asistencë teknike, mentorim dhe trajnime për marrëdhëniet me investitorët.⁸ Si pjesë e Agjendës së Ballkanit Perëndimor mbi

inovacionin, kërkimin, edukimin, kulturën, rininë dhe sportet, asociacioni dhe veçanërisht integrimi i Shqipërisë në Zonën e re Evropiane për Kërkim (ERA) dhe Zonën Evropiane të Arsimit (EEA) do të shërbejë si nxitës për reformat kombëtare dhe tranzicionin e politikave drejt një sistemi kërkimi dhe inovacioni më efikas, duke ndihmuar vendin të rrisë kapacitetet e tij dhe potencialin në infrastrukturë, si dhe përafrimin e tij të vazhdueshëm me *acquis* të Bashkimit Evropian.⁹

Raportet e Komisionit Evropian për vitin 2021–2022

Pjesëmarrja e Shqipërisë në bashkëpunimet kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare ka qenë një nga prioritetet e qeverisë shqiptare, gjatë viteve 2021–2022. Bazuar në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian (KE) për vitin 2021, shteti shqiptar ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm në fushat e mbuluara nga **kapitulli 25 “Shkenca dhe kërkimi shkencor”**, sidomos lidhur me procesin e hartimit të Strategjisë së Specializimit të Zgjuar, si edhe pjesëmarrjen në programin e kërkimit Horizon 2020. Megjithatë, pavarësisht arritjeve, KE ka evidentuar si pikë të dobët ndërveprimin midis biznesit dhe kërkuesve shkencorë në Shqipëri. Raporti i progresit për vitin 2021 nënvizon se përqindja e kompanive që investojnë në “Kërkim dhe zhvillim” në Shqipëri është e ulët (rreth 18%) dhe 0.03% e produktit të brendshëm bruto (PBB-së) për kërkimin shkencor mbeten të pamjaftueshme për të forcuar lidhjen midis biznesit dhe akademisë.¹⁰ Në të njëjtën kohë, rritja e investimeve për kërkimin shkencor, në përputhje me parimet dhe prioritetet e Zonës së Kërkimit

⁴OECD (2022), SME Policy Index: Western Balkans and Turkey 2022: Assessing the Implementation of the Small Business Act for Europe, SME Policy Index, OECD Publishing, Paris, <https://doi.org/10.1787/b47d15f0-en>, fq 356.

⁵European Commission (2022), Programme Statement - Pre-Accession Assistance (IPA III), https://ec.europa.eu/info/sites/default/files/about_the_european_commission/eu_budget/programme_statement_-_ipa.pdf

⁶European Commission (2022), Updates on the Association of Third Countries to Horizon Europe, <https://ec.europa.eu/info/news/updates-association-third-countries-horizon-europe-en>

⁷OECD (2020), Education in the Western Balkans: Findings from PISA, PISA, OECD Publishing, Paris, <https://doi.org/10.1787/764847ff-en>, fq 19.

⁸OECD (2022), SME Policy Index: Western Balkans and Turkey 2022: Assessing the Implementation of the Small Business Act for Europe, SME Policy Index, OECD Publishing, Paris, <https://doi.org/10.1787/b47d15f0-en>, fq 351.

⁹WESTERN BALKANS AGENDA ON INNOVATION, RESEARCH, EDUCATION, CULTURE, YOUTH & SPORT, European Union, 2021.

¹⁰*Albania 2021 Report, European Commission, Strasbourg*, 19.10.2021, SWD(2021) 289 final, faqe 99.



Evropian ka qenë një nga detyrimet e qeverisë shqiptare për vitin 2022.¹¹

Ndërkohë, Raporti i Komisionit Evropian për vitin 2022, duke njohur arritjet e shtetit shqiptar në këtë fushë për vitin 2021, nënvizon se qeveria shqiptare nevojitet ende të marrë masa lidhur me:¹²

- Rritjen e nivelit të investimeve në kërkimin shkencor, në përputhje me angazhimet qeveritare dhe prioritetet e reja të Zonës Evropiane Kërkimore;

- Finalizimin dhe miratimin e Strategjisë së Specializimit të Zgjuar dhe ligjit për kërkimin shkencor;

- Prodhimin e statistikave dhe të dhënave të besueshme për shkencën dhe teknologjinë, duke përfshirë treguesin mbi shpenzimet e brendshme bruto për kërkimin dhe inovacionin.

Nisur nga rekomandimet e raport progresit të vitit 2022 janë identifikuar si nevoja për t'u plotësuar në kuadër të këtij dokumenti strategjik:¹³

- Hartimi i metodologjisë për krijimin e fondeve për kërkimin dhe shkencën;

- Zhvillimi i politikave inovative që synojnë promovimin e lidhjeve më të mira ndërmjet akademisë, industrisë dhe qeverisë në fushat e aksesit të hapur dhe të dhënave të hapura;

- Rritja e ndërgjegjësimit për pjesëmarrjen në programin e ri *Horizon Europe*;

- Përmirësimi i lidhjeve me partnerët evropianë, me qëllim rritjen e projekteve të përbashkëta ndërkombëtare, në kuadër të integritimit në Zonën Evropiane të Kërkimit;

- Rritja e angazhimit të Shqipërisë në Bashkëpunimet Evropiane në fushën e shkencës dhe teknologjisë;

- Arritja e rezultateve të kënaqshme të pjesëmarrjes së Shqipërisë në programin EUREKA.

2. Korniza ligjore dhe institucionale, arritjet dhe mësimet e nxjerra

Procesi i hartimit të SKKSHTI

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 12, datë 13.1.2022, "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 290, datë 11.4.2020, 'Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të Sistemit Informatik të Planifikimit të Integruar (SIPI/IPSIS)'", procesi për Strategjinë Kombëtare

të Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit 2023–2030 ka filluar me hartimin e koncept-dokumentit të kësaj strategjie, i cili pas konsultimit me të gjithë përfaqësuesit e grupeve të punës për hartimin e strategjisë u prezantua në Komitetin e Planifikimit Strategjik përpara Agjencisë Shtetërore për Programimin Strategjik dhe Koordinimin e Ndihmës (SASPAC) në Kryeministri.

Në nivel teknik, puna për hartimin e dokumentit strategjik nisi me miratimin e urdhrat të ministrit nr. 53, datë 9.2.2022, "Për ngritjen e grupit të koordinimit për hartimin e strategjisë kombëtare për shkencën, teknologjinë dhe inovacionin", që përcakton të gjithë anëtarët e grupeve të punës për secilin institucion pjesëmarrës, që mund të ndërlidhë aktivitetet e tij me hartimin e strategjisë dhe mund të kenë kontribut në fushën e kërkimit shkencor, teknologjisë dhe inovacionit. Me urdhrin e ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 336, datë 16.6.2022, "Për ngritjen e grupeve teknike për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023–2030" janë ngritur katër grupet teknike:

- a) grupi teknik i punës për hartimin e politikave dhe kuadrit ligjor;

- b) grupi teknik i punës për infrastrukturën institucionale;

- c) grupi teknik i punës për buxhetimin dhe statistikën;

- d) grupi teknik për inovacionin dhe kërkimin shkencor.

Bazuar në secilin prej këtyre dy urdhrave, anëtarët e grupeve të koordinimit për hartimin e dokumentit strategjik dhe grupeve teknike të punës, në bashkëpunim me ekspertët kombëtarë përgatitën planin e detajuar të punës për hartimin e SKKSHTI, në respektim të hapave dhe përmbajtjes së dokumentit strategjik sipas standardeve të sistemit IPSIS.

Dokumenti strategjik u konsultua në disa faza me grupet teknike në ministrinë përgjegjëse për kërkimin shkencor, si edhe me grupet teknike të ministrive të tjera të linjës me përgjegjësi të veçanta, sidomos në fushën e teknologjisë dhe inovacionit. Në të njëjtën kohë, draftstrategjia së bashku me Planin e Veprimit dhe Treguesit kryesorë të

¹¹Albania 2021 Report, European Commission, Strasbourg, 19.10.2021, SWD(2021) 289 final, faqe 99.

¹²Albania 2022 Report, European Commission, Bruksel, 12.10.2022, SWD (2021) 332 final, faqe 96.

¹³Albania 2022 Report, European Commission, Strasbourg, 19.10.2021, SWD (2021) 332 final, faqe 97.



performancës u konsultuan me të gjitha grupet e interesit, në kuadër të procesit të konsultimit publik. Komentet dhe sugjerimet e dala nga ky proces janë reflektuar në dokumentin final të strategjisë i cili kaloi për miratim te Këshilli i Ministrave.

Kuadri institucional

Aktualisht, institucionet përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e politikave në lidhje me kërkimin shkencor, teknologjinë dhe inovacionin janë:

- Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS);
- Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI);
- Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL) dhe institutet kërkimore që janë pjesë e tyre;
- Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL);
- Qendra Ndërinstitucionale “Rrjeti Akademik Shqiptar” (RASH);
- Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) Akademia e Shkencave e Shqipërisë (ASHSH);
- Ministrinë përgjegjëse për politika në fusha të veçanta lidhur me kërkimin shkencor, teknologjinë dhe inovacionin;
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR);
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE);
- Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes;
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS);
- Ministria e Mbrojtjes (MM);
- Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI);
- Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA);
- Agjencia Kombëtare e Diasporës (AKD);
- Agjencia e Mbështetjes së Shoqërisë Civile (AMSHC);
- Instituti i Statistikave (INSTAT);
- Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë;
- Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Intelktuale (DPPI);
- Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA).

Ministria e Arsimit dhe Sportit është institucioni kryesor përgjegjës për hartimin dhe

zbatimin e politikave të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, si dhe miraton planin strategjik në këtë fushë. Ajo harton dhe propozon bazën ligjore në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor dhe propozon në Këshillin e Ministrave modelin e financimit të buxhetit për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore, në fuqi¹⁴. Fusha e përgjegjësisë së MAS-it mbulon kërkimin shkencor dhe inovacionin që zhvillohet në IAL. Pra, për sa i përket inovacionit, MAS-i ka një përgjegjësi të kufizuar. Pavarësisht se ka ndryshuar fushën e përgjegjësisë shtetërore disa herë, përsëri kompetencat në këtë fushë nuk kanë ndryshuar, por janë shtuar edhe në fushën e inovacionit. Përveç drejtorive politikëbërëse, pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit është ngritur edhe Këshilli i Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor që përbëhet nga 12 anëtarë. Ky këshill është organi kryesor që këshillon ministrinë për kuadrin strategjik dhe politik të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor.

Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI) u krijua bazuar në vendimin nr. 607, datë 31.8.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor, Teknologjisë dhe Inovacionit”. AKKSHI është një institucion juridik publik në varësi të ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe kërkimin shkencor, që synon ndërtimin e një sistemi modern të shkencës, fuqizimin e kërkimit shkencor dhe teknologjik, si dhe integrimin e tyre në sistemin e arsimit të lartë. Nga viti 2017, Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (zëvendësoi AKTI) mori përgjegjësitë kryesore në lidhje me financimin e kërkimit shkencor dhe zbatimin e politikave në fushën e kërkimit shkencor, inovacionit dhe teknologjisë. Kjo agjenci duhet të bashkërendojë punën për zbatimin e politikave me institucionin përgjegjës për mbrojtjen e sipërmarrjes, që aktualisht është Ministria e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA) institucionin përgjegjës për mbështetjen e NVM-ve, që aktualisht është Agjencia Shqiptare e NVM dhe Fondin e Inovacionit.

¹⁴Ligji nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, kreu II, neni 7.



Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) është institucioni kryesor për sa i përket digjitalizimit të administratës publike dhe shërbimeve publike të ofruara për qytetarët dhe bizneset në Shqipëri. AKSHI administron infrastrukturën *e-Gov*, si dhe infrastrukturën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) për institucionet dhe organet e administratës buxhetore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, si dhe institucioneve jobuxhetore, për të cilat përdoren tarifat e shërbimit. Rregullon sektorin e TIK-ut dhe është një ofrues i shërbimeve TIK dhe shërbimeve elektronike për qytetarët, bizneset dhe administratën publike. AKSHI krijon, mirëmban dhe administron sistemet dhe aplikacionet e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, infrastrukturën e centralizuar dhe infrastrukturën e TIK-ut për institucionet e administratës shtetërore dhe organet nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave. Ky institucion promovon gjithashtu teknologji të reja, harton strategji dhe plane veprimi për zbatimin e politikave në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit elektronik *e-Gov*, si dhe promovon aktivitetet e sektorit të TIK-ut brenda kornizës së detyrimeve, konventave dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, bilaterale dhe shumëpalëshe, në fushën e komunikimeve elektronike *e-Gov*.

Akademia e Shkencave e Shqipërisë (ASHSH) është institucioni publik më i lartë që përfaqëson e mbart vlerat më të mira të shkencës, të kërkimit shkencor, të krijimtarisë dhe të debatit e bashkëveprimit të mendimit shkencor në vend, përmes një bashkësie të zgjedhur shkencëtarësh e krijuesish. Në të njëjtën kohë, ASHSH-ja propozon fusha të reja kërkimore e studimore, në përputhje me nevojat e zhvillimit të vendit dhe u ofron institucioneve shtetërore ekspertizën e nevojshme për zgjidhjen e çështjeve të rëndësishme për vendin.¹⁵ Akademia e Shkencave të Shqipërisë është institucion qendror shkencor kombëtar. Akademia duhet të: i. të kryejë kërkime shkencore fundamentale dhe aplikative në fusha të ndryshme të shkencave sociale, humanitare, natyrore e albanologjike; ii. të kujdeset për të hapur fusha të reja

të kërkimeve shkencore, në përputhje me nevojat e vendit; iii. t'u parashtrojë organeve shtetërore çështje të rëndësishme për gjendjen e kërkimit shkencor e të zhvillimit teknologjik në fusha të ndryshme, për rrugët e zhvillimit të shkencës e të kulturës; iv. të punojë për përfshirjen sa më të frytshme të shkencës shqiptare në shkencën botërore.¹⁶

Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL) luajnë një rol shumë të rëndësishëm në rritjen e kërkimit shkencor, inovacionit dhe teknologjisë pasi ato janë hartuesit, zbatuesit dhe përfituesit kryesorë nga marrëveshjet apo anëtarësimet në organizata të ndryshme që bëhen nga vetë ato ose nga AKSHI apo institucione të tjera. Aktualisht ekzistojnë 15 IAL publike dhe 27 IAL jopublike. Një pjesë e këtyre institucioneve kanë hapur qendra apo zbatojnë projekte që nxisin përdorimin e inovacionit dhe teknologjisë jo vetëm nga IAL-të, por edhe nga bizneset apo institucione të tjera. Një model i ri financimi i institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, i miratuar në vitin 2018¹⁷, prezantoi një sistem financimi të përditësuar, por jo të plotë, për IAL-të dhe RDI-të¹⁸. Sipas sistemit, financimi institucional ndahet në bazë të renditjes kombëtare të institucionit dhe nëpërmjet granteve konkurruese, ku këto të fundit shpërndahen nëpërmjet AKSHI-t në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare. Në drejtim të inovacionit, disa IAL kanë përfituar nga financimi i donatorëve për projekte inovative ose bashkëpunuese, siç janë inkubatorët e biznesit.

Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL) është institucioni publik në varësi të ministrisë përgjegjëse për arsimin, që ka për detyrë kryesore shpërndarjen e fondeve publike për: mbështetjen e veprimtarisë së institucioneve publike të arsimit të lartë, ku përfshihet mësimdhënia, kërkimi shkencor dhe pjesëmarrja në çështjet e menaxhimit akademik dhe administrativ; mbështetjen me bursa studimi për studentët e shkëlqyer me notë mesatare maksimale nga sistemi i arsimit të mesëm të lartë, studentët në programet e studimit në fusha prioritare dhe studentët nga shtresa sociale në nevojë; garantimin e skemës së

¹⁵Ligji nr. 53/2019, “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”.

¹⁶Ligji nr. 7893, datë 22.12.1994, “Për shkencën dhe zhvillimin teknologjik”, neni 18.

¹⁷ Vendim nr. 75, datë 12.2.2018, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”, i ndryshuar.

¹⁸ Kërkimi, zhvillim dhe inovacion.



kredive studentore. AKFAL-i propozon kriteret për shpërndarjen e fondeve publike.

Qendra Ndërinstitucionale “Rrjeti Akademik Shqiptar” është një organ i ngritur pas reformës së arsimit të lartë të vitit 2015 dhe veprimtaria e saj ndikon drejtpërdrejtë në realizimin e politikave, në lidhje me kërkimin shkencor dhe bashkëpunimin ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë. Rrjeti Akademik Shqiptar (RASH) është krijuar me vendimin nr. 88, datë 14.2.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar (RASH)” dhe ka për qëllim:

a) zhvillimin dhe promovimin e projekteve të kërkim-zhvillimit dhe inovacionit në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) për arsimin dhe shkencën;

b) krijimin e infrastrukturës për ngritjen e një qendre të përbashkët ndërdisiplinore kërkim-zhvillimi (TIK) nga IAL-të pjesëmarrëse apo palë të treta;

c) koordinimin e pjesëmarrjes së kërkuesve vendas në projektin evropian të kërkimit GÉANT dhe projekte të tjera në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK), pjesë përbërëse e programit kuadër evropian të kërkim-zhvillimit dhe inovacionit;

d) zhvillimin e programeve *software* dhe ofrimin e shërbimeve përkatëse për ministrinë përgjegjëse për arsimin, agjencitë e varësisë për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, institucionet e arsimit të lartë, të kërkimit shkencor dhe inovacionit e për të gjithë anëtarësinë e RASH-it, si dhe për palë të treta.

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) është krijuar në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, me vendimin nr. 109, datë 15.2.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë”, të ndryshuar. Kjo agjenci u krijua nga riorganizimi i Agjencisë Publike të Arsimit të Lartë, e cila ishte krijuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 303, datë 1.7.1999. ASCAL-i është i vetmi institucion në RSH që kontrollon dhe vlerëson cilësinë në arsimin e lartë.

Kjo, duke u mbështetur në standardet shtetërore të cilësisë dhe në standardet dhe udhëzimet përkatëse të cilësisë në hapësirën evropiane dhe atë ndërkombëtare të arsimit të lartë. ASCAL-i kryen vlerësimin paraprak të cilësisë për IAL-të, njësitë e tyre dhe programet e studimit të të tre cikleve në kuadër të licencimit të tyre, si dhe vlerësimin e jashtëm në kuadër të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit. Gjithashtu, Agjencia kryen vlerësime analitike dhe krahasuese për IAL-të, programet dhe fushat e studimit. Misioni i ASCAL-it është: i. sigurimi i cilësisë në arsimin e lartë përmes vlerësimit të jashtëm, objektiv dhe të pavarur; ii. ruajtja e standardeve të cilësisë; iii. promovimi dhe përmirësimi i cilësisë së institucioneve të arsimit të lartë e të programeve të studimit që ato ofrojnë. Në procesin e akreditimit vlerësohet edhe cilësia e kërkimit shkencor në institucionin e arsimit të lartë. Pra, ndoshta jo në mënyrë të drejtpërdrejtë, por ky institucion ndikon në forcimin dhe rritjen e cilësisë së kërkimit shkencor që realizohet në institucionet e arsimit të lartë dhe institutet e kërkimit dhe zhvillimit.

Agjencia Kombëtare e Diasporës (AKD) u ngrit bazuar në ligjin nr. 115, datë 18.12.2017, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”. Edhe pse ligji është ndryshuar me ligjin nr. 35/2021, përsëri qëllimi i punës së agjencisë nuk është prekur. Ajo ka qëllim ruajtjen dhe promovimin e vlerave të identitetit kombëtar dhe trashëgimisë kulturore, si dhe forcimin dhe konsolidimin e bashkëpunimit institucional me diasporën. Nëpërmjet marrëveshjes së bashkëpunimit, të nënshkruar në 2021-shin me Institutin “AlbShkenca”, AKD-ja synon nxitjen e bashkëpunimit me Diasporën Shkencore Shqiptare në fushën e kërkim-zhvillimit¹⁹. Gjithashtu, është planifikuar ngritja e Këshillit Koordinues të Pjesëtarëve të Diasporës për Kërkimin Shkencor. Anëtarët e tij do të jenë profesorë, doktorë shkencash, kërkues shkencorë, hulumtues të cilët gjatë karrierës së tyre kanë dhënë kontribut të çmuar në zhvillimin e shkencës, promovimin e gjuhës dhe kulturës shqiptare.

Agjencia e Mbështetjes së Shoqërisë Civile (AMSHC) është agjenci që mund të nxisë adaptimin dhe përdorimin më të shpejtë të

¹⁹Gjithashtu, synohet organizimi i takimeve dhe konferencave shkencore, si dhe botimi i punimeve dhe studimeve shkencore. Gjithashtu, do të hartohen nisma të përbashkëta, projekte në fushën e kërkimit shkencor e

teknologjik dhe do të organizohen takime dhe konferenca shkencore, apo do të botohen dhe promovohen punime dhe studime shkencore të pjesëtarëve të Diasporës.



teknologjisë dhe inovacionit, si dhe mund të financojë, nëpërmjet granteve, kërkimin shkencor. Ndër objektivat e saj është edhe zhvillimi i sipërmarrjes shoqërore dhe punësimit në sektorin jofitimprurës.

Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes është krijuar në 2021-shin dhe si mision ka mbrojtjen e sipërmarrjes dhe nxitjen e *startup*-eve, që janë një mundësi e mirë e promovimit të teknologjive të reja.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka në varësi një sërë institucioneve që janë të rëndësishme për zhvillimin e kërkimit shkencor në fushën e shëndetësisë. Kështu në ligjin nr. 10 138, datë 11.5.2009, “Për shëndetin publik”, pikërisht në nenin 12, ku jepet organizimi i Institutit të Shëndetit Publik (ISHP), theksohet:

1. Institutit i Shëndetit Publik është institucion publik, buxhetor, në varësi administrative të ministrit të Shëndetësisë.

2. ISHP-ja është qendër e kërkimit shkencor, qendër reference e shërbimeve në fushën e shëndetit publik, qendër universitare dhe qendër informacioni.

Në ligjin nr. 55/2022, datë 7.7.2022, “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë” thuhet se: Spitale terciare quhen spitalet me organizim teknik, pajisje mjekësore dhe me shërbime, që janë në gjendje të sigurojnë:

- a) ndihmë mjekësore të nivelit të lartë;
- b) punë kërkimore-shkencore, në bashkëpunim me departamentet e mësimdhënies;
- c) përgatitje profesionale për njohjen e personelit mjekësor me të rejtat e shkencës;
- d) shikolla për kualifikimin e personelit ndihmës dhe teknik.

Kjo ministri është përgjegjëse për fushën e barazisë gjinore dhe ndikon në përfshirjen e grave dhe vajzave në fushën e kërkimit shkencor.

Kontributi i institucioneve në varësi të kësaj ministrie shtrihet edhe tek Shërbimi Social Shtetëror. Mbështetur në vendimin nr. 135, datë 7.3.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e statutit të Shërbimit Social Shtetëror”, i ndryshuar, Shërbimi Social Shtetëror, ka si mision zbatimin e politikave të ministrisë përgjegjëse për çështjet e ndihmës ekonomike, të aftësisë së kufizuar dhe të

shërbimeve të kujdesit shoqëror, shërbime të cilat themelohen në bazë të studimeve sipas nevojës.

Gjithashtu, Shërbimi Social Shtetëror bashkëpunon me Fakultetin e Shkencave Sociale, Tiranë (https://fshs-ut.edu.al/?page_id=9175), bashkëpunim i cili ka në bazën e funksionit të tij veprimtari të përbashkëta kërkimore, trajnime, dhënie konsulence, ekspertize dhe transferim teknologjie. Nëpërmjet tyre ky partneritet sjell një kontribut në zhvillimin e kërkimit shkencor. Aktualisht Shërbimi Social Shtetëror bashkëpunon me Urdhrin e Punonjësit Social dhe Urdhrin e Psikologut, për çështje që lidhen me profesionistët e shërbimeve të kujdesit shoqëror. Bashkëpunimi dhe partneriteti që Shërbimi Social Shtetëror ka me institucione të fushave të kërkimit, si INSTAT-i, Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës, do të japë kontributin e tij në kërkimin shkencor të shkencave humane.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka kontributin e saj tek inovacioni në fushën e energjisë.

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) është organ që ndikon drejtpërdrejtë në zbatimin e politikave që hartohen në lidhje me inovacionin. AIDA administron fonde të buxhetit të shtetit që forcojnë kapacitetet në inovacion dhe zhvillim teknologjik të *startup*-eve. Këto fonde janë: i. Fondi i Konkurrueshmërisë; ii. Fondi i Ekonomisë Kreative; iii. Fondi në Mbështetje të Sipërmarrjeve të Reja “*Startup*”; iv. Fondi i Inovacionit.²⁰ AIDA, e cila ofron Fondin Shqiptar të Inovacionit, ka operuar një skemë që ndihmon SME-të për të inovuar që nga viti 2018. Megjithatë, skema nuk fokusohet në mënyrë eksplicite në bashkëpunimin biznes-akademi.

Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Intelektuale është institucion që luan një rol të rëndësishëm për nxitjen e inovacionit në vend pasi ajo ka të drejtën ekskluzive të dhënies së të drejtave për patentat mbi shpikjet dhe modelet e përdorimit, disenjot industriale etj., duke u njohur mbajtësve të së drejtave pronësinë mbi këto objekte, nëpërmjet regjistrimit të tyre. Ndërkohë që Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI) ofron shërbime që mbështesin këshillimin për patentat dhe komercializimin e pronësisë intelektuale.

²⁰<https://aida.gov.al/sq/nvm/iniciativat-e-financimit/fondet-e-aida-s>



Aktualisht, në kuadër të bashkëpunimit midis Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Intellektuale (DPPI) dhe IAL-ve, DPPI-ja ka ngritur 4 qendra të informacionit tekniko-shkencor pranë IAL-ve në shkallë vendi, konkretisht:

- Qendra e Informimit Tekniko-Shkencor në Universitetin Politeknik të Tiranës;
- Qendra e Informimit Tekniko-Shkencor në Universitetin “Ismael Qemali” Vlorë;
- Qendra e Informimit Tekniko-Shkencor në Universitetin “Fan S. Noli” Korçë;
- Qendra e Informimit Tekniko-Shkencor në Universitetin “Luigj Gurakuqi”, Shkodër.

Ngritja e këtyre qendrave është mjaft e rëndësishme dhe shërben për rritjen e ndërgjegjësimit të studentëve, stafit akademik shkencor, kërkuesve shkencorë dhe profesionistëve të përfshirë në punë kërkimore shkencore, në nxitjen e tyre, si dhe në të drejtat që i përkasin nëpërmjet regjistrimit pranë DPPI-së. Qendrat janë të pajisura me logjistikën e nevojshme dhe me sistem kërkimi, “*EspaceNet*”, i cili është në gjuhën shqipe.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural është institucion mjaft i rëndësishëm për transferimin e teknologjisë në vend. Drejtpërdrejtë, nëpërmjet Programit Buxhetor të Këshillimit dhe Informacionit Bujqësor mundësohet transferimi i teknologjive të reja si në bujqësi ashtu edhe në blegtori. Kështu, aktualisht ekzistojnë 5 qendra të transferimit të teknologjive bujqësore. Institucion i rëndësishëm është edhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV). ISUV bazuar në ligjin nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë” dhe VKM-në nr. 732, datë 16.11.2022, “Për organizimin dhe funksionimin e Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë”. Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV), shërben si Qendër Kombëtare e Referencës Laboratorike Veterinare dhe është institucion qendror, në varësi të ministrit dhe pjesë e Rrjetit të Shërbimit Veterinar Kombëtar. ISUV-i bashkëpunon me institutet, qendra kërkimore-shkencore, ente ndërkombëtare dhe qendra reference. Misioni i tij është të garantojë sigurinë dhe cilësinë e ushqimeve, ushqimeve për kafshë, mbrojtjen e shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve, mbrojtjen e bimëve dhe produkteve bimë dhe mbrojtjen e shëndetit publik në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet kryerjes së veprimtarive laboratorike dhe vlerësimeve shkencore në këto

fusha. ISUV-i e ushtron veprimtarinë në këto fusha përgjegjësie:

- a) kryerjen e analizave të sigurisë ushqimore, veterinarisë dhe mbrojtjes së bimëve;
- b) kryerjen e aktiviteteve të mjekësisë veterinare;
- c) kryerjen e vlerësimeve shkencore dhe kërkimeve teknologjike.

Instituti i Statistikave është institucioni që mbështet hartimin e politikave me të dhëna që mundësojnë një politikëbërje sa më cilësore në fushën e kërkimit shkencor, inovacionit dhe teknologjisë. Ky institucion ka kryer vrojtime pranë katër sektorëve, përkatësisht, sektori i bizneseve private, organizatave jofitimprurëse, institucionet publike dhe institucionet e arsimit të lartë, si dhe ka mbledhur të dhënat administrative për fondet e alokuara buxhetore për kërkim dhe zhvillim.

Lidhur me treguesit e teknologjisë pranë ndërmarrjeve, Instituti i Statistikave (INSTAT) kryen vrojtime mbi përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) nga ndërmarrjet ekonomike me mbi 10 e më shumë të punësuar. Të dhënat mikro të TIK-ut janë:

- Përdorimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në ndërmarrje sipas aktivitetit ekonomik të ndërmarrjes, 2015–2021.

- Përdorimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në ndërmarrje sipas madhësisë së ndërmarrjes, 2015–2021.

INSTAT-i, për statistikën e inovacionit zhvillon çdo dy vite vërtetimin pranë ndërmarrjeve ekonomike me 10 ose më shumë të punësuar ku grumbullohet informacion për tre vitet paraardhëse. Të dhënat kryesore lidhur me këtë aktivitet gjenden në faqen zyrtare të INSTAT-it dhe paraqiten si më poshtë:

- Aktiviteti i inovacionit në ndërmarrje sipas aktivitetit ekonomik të ndërmarrjes;

- Aktiviteti i inovacionit në ndërmarrje sipas madhësisë së ndërmarrjes;

- Aktiviteti i inovacionit në ndërmarrje.

Ministria e Mbrojtjes ka në varësi një sërë institucionesh që janë të rëndësishme për zhvillimin e kërkimit shkencor dhe inovacionit në fushën e mbrojtjes siç janë:

- Instituti i Kërkimit Shkencor të Mbrojtjes dhe Inovacionit është në përbërje të institucionit të Akademisë së Forcave të Armatosura, me profil kërkimor-shkencor dhe realizon kërkime dhe projekte inovative në fushën teknologjike dhe të



informacionit sipas nevojave të identifikuar të Forcave të Armatosura.

- Instituti i Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake si institucion ushtarak, kërkimor, shkencor dhe prodhues, mbështetës i veprimtarisë ushtarake të Forcave të Armatosura operon si Agjenci Hartografike Kombëtare dhe është përgjegjëse për hartografinë masiv tokësor, detar dhe ajror.

- Qendra e Inovacionit që po ngrihet pranë Akademisë së Forcave të Armatosura, nga Ministria e Mbrojtjes, ka për mision inovacionin në Forcat e Armatosura për mbrojtjen dhe sigurinë, mbështetjen e *startup*-eve në fushën e mbrojtjes civile, të sigurisë kibernetike dhe më gjerë.

Lidhja me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2022–2030 (SKZHI III)

Strategjia Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023–2030, së bashku me dokumentet strategjike shoqërues harmonizohet dhe është në përputhje të plotë me qëllimet, objektivat dhe parashikimet e **Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2022–2030 (SKZHI III)** sipas shtyllës 2: Agjenda për Zhvillim të Qëndrueshëm Ekonomik, Ndërlidhjen dhe Rritjen e Gjellbër²¹.

Konkretisht seksioni “Zgjerimi i kërkimeve shkencore dhe inovacionit” paraqet si vizion të tij: “Krijimin e një sistemi kërkimor dhe inovator të aftë të përballojë me sukses sfidat e ardhshme të zhvillimit të vendit të tilla, si: rritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore, çështje të energjisë, çështje mjedisore, çështje të shëndetit publik, çështje të inovacionit, dhe të kohezionit social”.

Lidhur me kërkimin shkencor dhe Inovacionin në SKZHI III konkretisht parashikohet komponenti:

“Zgjerimi i kërkimeve shkencore dhe inovacionit” që parashikon objektivat e mëposhtme strategjike:

1. Përmirësimi i cilësisë së kërkimeve në sektorin publik;

2. Forcimi i inovacionit dhe transferimi i njohurive dhe teknologjive në sektorin prodhues;

3. Specializimi i zgjuar për të mbështetur priorizimin në sektorë, fusha dhe teknologji inovative;

4. Përmirësimi i kapaciteteve institucionale të sistemit kërkimor dhe të inovacionit.

Lidhja me dokumente dhe strategji kombëtare

- Strategjia e Arsimit 2021–2026

Në këtë strategji qëllimi i politikës C mbulon fushën e arsimit të lartë. Për këtë qëllim janë identifikuar 7 objektiva specifike. Në mënyrë të drejtpërdrejtë nga të 7 objektivat, vetëm 3 objektiva ndikojnë drejtpërdrejtë edhe në realizimin e synimeve për kërkimin shkencor, ndërkombëtarizimin dhe inovacionin. Këta objektiva janë:

Objektivi C2 “Nxitja e përsosmërisë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor”.

Objektivi specifik C6 “Ndërkombëtarizimi i arsimit të lartë në Shqipëri dhe integrimi në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë (EHEA)”.

Objektivi specifik C7 “Avancimi i infrastrukturës së TIK-ut dhe i shërbimeve digjitale për IAL-të publike”.

- Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030

Në këtë dokument është specifikuar rëndësia e përfshirjes së grave dhe vajzave në shkencë dhe teknologji, të qëllimi i parë (nga 4 qëllime të strategjisë), tek Objektivi specifik 1.3 “Zvogëlimi i barrierave që i mbajnë gratë, të rejat dhe vajzat larg tregut të punës, si dhe rritja e aksesit të grave, të rejave dhe vajzave nga të gjithë grupet, për punë të denjë edhe në sektorët jotradicionalë të punësimit (në veçanti në shkencë, teknologji, inxhinieri, matematikë)”.

- Plani kombëtar për zhvillimin e qëndrueshëm të infrastrukturës digjitale broadband 2020–2025, miratuar me vendimin nr. 434, datë 3.6.2020, të Këshillit të Ministrave

Nga shtatë objektivat specifike të identifikuar, objektivi i katërt lidhet drejtpërdrejtë me cilësinë e kërkimit shkencor. Kështu, objektivi është “nga fundi i vitit 2025 100% e IAL-ve të jenë të lidhura me *broadband* me shpejtësi 1 gbps; rrjeti Akademik Shqiptar të jetë pjesë e rrjetit evropian të *High Performance Computer* (HPC)”.

²¹ Vendim nr. 88, datë 22.2.2023, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian, 2022–2030”, tek: <http://qbz.gov.al/eli/vendim/2023/02/22/88>.



- Strategjia e re e zhvillimit të investimeve dhe biznesit për periudhën 2021–2027

Kjo strategji jep orientimin kryesor të qeverisë shqiptare për zhvillimin ekonomik afatmesëm, duke u fokusuar kryesisht në zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, si edhe investimet. Planifikimi i masave për nxitjen e sipërmarrjes dhe inovacionit përfshihet tek *Objektivi Specifik 1.2. “Zhvillimi i NVM-ve, sipërmarrja dhe inovacioni”* i kësaj strategjie. Institucioni përgjegjës për këtë objektiv është AIDA dhe treguesit që do të synojë që të arrijë dhe që lidhen drejtpërdrejtë me inovacionin dhe SME-të janë:

- i. rritja e dendësisë së *startup*-eve nga 88 në 132 (*startup*-e për një milionë banorë);
- ii. rritja e vlerësimit në indeksin e konkurrueshmërisë globale (aftësitë inovative) nga 29.8 në 34.

Pjesa më e madhe e masave të planifikuara për të bërë të mundur realizimin e objektivit specifik janë të lidhura drejtpërdrejtë me përmirësimin e përdorimit të teknologjive të reja dhe inovacionit nga NVM-të.

- Ligji nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” jep përkufizimet e llojeve të kërkimit shkencor në nenin 6 si më poshtë:

“Institucionet e arsimit të lartë” janë personat juridikë që ofrojnë arsimim të lartë ose kualifikim profesional pas arsimit të mesëm dhe, sipas llojit të institucionit, edhe kërkim shkencor, si pjesë e sistemit të arsimit të lartë të krijuar, dhe që ushtrojnë veprimtarinë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

“Kërkimi shkencor bazë” është veprimtaria kërkimore-shkencore, që ka për qëllim kryesor zgjerimin, thellimin, rikonceptimin dhe riintegrimin e njohurive shkencore mbi fenomenet e studiuar dhe të kuptuarit teorik të ndërveprimit midis aktorëve të ndryshëm dhe vetë procesit ku ato ndikojnë.

“Kërkimi shkencor i zbatuar” është veprimtaria kërkimore-shkencore, që ka për qëllim të gjejë zgjidhje praktike dhe specifike me objektiv kryesor shfrytëzimin e njohurive teorike, me qëllim zbatimin e tyre në praktikë.

Gjithashtu, në këtë ligj përcaktohen edhe institucionet kryesore si Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL), në varësi

të MAS-it, që ka detyrë kryesore shpërndarjen e fondeve publike dhe ndër të tjera në nenin 11, shkronja “a”, përcakton mbështetjen e veprimtarisë së institucioneve publike të arsimit të lartë, ku përfshihet mësimdhënia, kërkimi shkencor dhe pjesëmarrja në çështjet e menaxhimit akademik dhe administrativ.

Institucioni tjetër që përcaktohet në ligj, në nenin 12, është Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI), institucion publik në varësi të ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe kërkimin shkencor, që ka për detyrë kryesore shpërndarjen e fondeve për programet e kërkimit shkencor, mbi bazën e projekteve të paraqitura prej institucioneve të arsimit të lartë dhe institucioneve të kërkimit shkencor në fushat e shkencave natyrore, inxhinierike dhe teknologjike, mjekësore, bujqësore, sociale dhe humane.

Në të njëjtën kohë, ligji përcakton ASCAL-in si person juridik publik që është përgjegjës për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë. ASCAL-i, përmes mekanizmave të sigurimit të cilësisë, akreditimit dhe proceseve të tjera, monitoron dhe vlerëson cilësinë e institucionit dhe të programeve të ofruara. Kjo agjenci vlerëson dhe akrediton IAL-të dhe programet e të tre cikleve të studimit, nëpërmjet të cilave realizohet kërkimi shkencor.

- Strategjia Kombëtare e Pronësisë Intelektuale 2022–2025, ka 5 qëllime politike dhe tek qëllimi i parë i politikës

“Përmirësimi i kuadrit ligjor në fushën e pronësisë intelektuale” është hartuar objektivi specifik që ndikon drejtpërdrejtë në cilësinë e kërkimit shkencor, objektivi specifik 4 “Ngritja e platformës për të drejtën e autori”.

Tek qëllimi “*Zhvillimi dhe forcimi i institucioneve, të përfshira në zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale*”, objektivi specifik i gjashtë i strategjisë “Rritja e nivelit të cilësisë së shërbimeve të DPPI-së dhe Drejtorisë së të Drejtave të Autorit”, lidhet drejtpërdrejtë me inovacionin. Gjithashtu, objektivi 14 “Ngritja e qendrave të transferimit të teknologjisë” synon që deri në 2025-n të mbarojë procesi i ngritjes së qendrave në IAL-të publike.

Strategjia Kombëtare e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Peshkimit 2021–2027 parashikon masa që ndikojnë drejtpërdrejtë dhe ndërlidhen me cilësinë e kërkimit shkencor që bëhet nga institucionet, veprimtaria e të cilave mbulohet nga kjo strategji.



- Programi shumëvjeçar për Politikën Spektrale dhe Plani i Veprimit²² objektivi strategjik (f) synon promovimin e inovacionit dhe më specifikisht “Promovimin e inovacionit dhe të investimeve, duke përforcuar fleksibilitetin në përdorimin e spektrit radio, nëpërmjet aplikimit të parimeve të neutralitetit teknologjik midis zgjidhjeve teknologjike që mund të zbatohen dhe nëpërmjet një parashikimi të përshtatshëm rregullator, bazuar midis të tjerash në ligjin për komunikimet elektronike, dhe nëpërmjet lirimit të spektrit radio në harmoni me zhvillimet në BE për teknologjitë e reja të avancuara, si dhe përmes mundësisë së transferimit/tregtimit të të drejtave të përdorimit të spektrit radio, duke krijuar në këtë mënyrë mundësi për zhvillimin e shërbimeve të ardhshme digjitale”.

- Agjenda Digjitale e Shqipërisë dhe Plani i Veprimit 2022–2026²³ Edhe pse vizioni i qeverisë në këtë fushë lidhet dhe kontribuon drejtpërdrejtë tek SKKSHTI, përsëri mund të evidentohet synimi 4 “5.4. Synimi 4: Edukimi digjital dhe aftësitë digjitale: transformimi i të mësuarit dhe mësimdhënies”, si qëllim apo synim që është më afër vizionit të kësaj strategjie.

Në objektivin 4, të edukimit digjital, referon ndër synimet edhe kërkimin shkencor në TIK, konkretisht: “Kërkimi shkencor në institucionet e arsimit të lartë”.

- Mundësimi i kërkimit shkencor - fuqizimi i grupeve të kërkimit shkencor duke ofruar mjediset e duhura të bazuara në *cloud* që mbështeten në politikat, sigurinë dhe modelet e qeverisjes së universiteteve.

- Qendrat kompjuterike me performancë të lartë & IA - mundësimi i kompjuterizimit me performancë të lartë, *machine learning* dhe inteligjencës artificiale në atë shkallë që shumë kërkues në shumë fusha të përshpejtojnë ritmin e kërkimit shkencor dhe të shkurtojnë kohën e publikimit.

Strategjia Kombëtare e Shëndetësisë 2021–2030²⁴. Kjo strategji është miratuar në prill 2022 dhe ka të identifikuar 5 qëllime politike. Lidhja dhe kontributi i drejtpërdrejtë që jepet tek SKKSHTI lidhet me objektivin 5.5, që është objektivi specifik 5 i qëllimit të politikës V: Fuqizimi i kapaciteteve për kërkimin shkencor dhe publikimi i evidencave shkencore. Për realizimin e këtij objektivi është planifikuar masa 5.5.1: Fuqizimi i sistemit kombëtar për kërkimin shkencor²⁵.

Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2023–2030²⁶. Kjo strategji është miratuar në mars të 2023 dhe vizioni i saj jetësohet në 2 qëllime politike. Lidhja dhe kontributi i kësaj strategjie me SKKSHTI jepet në qëllimin e parë të politikës së kësaj strategjie “Zhvillimi i aftësive dhe lidhje më e mirë e kërkesës me ofertën në tregun e punës për më shumë punësim” dhe më specifikisht, objektivi strategjik 1.1: Reduktimi i mospërputhjes së aftësive për të gjitha profesionet, ku si masë për realizimin e tij janë edhe masat forcimi i mekanizmave të garantimit dhe zhvillimit të cilësisë në sistemin e AFP-së dhe nxitja e mundësive gjithëpërfshirëse për të nxënëit gjatë gjithë jetës.

Kontributi Kombëtar i Përcaktuar (NDC) 2021–2030. Sipas Kontributit Kombëtar të Përcaktuar 2021–2030, për zhvillimin e ekonomisë me karbon të ulët, do të nevojiten investime të rëndësishme dhe transferime teknologjike, në veçanti me teknologji të reja me karbon të ulët, në energjinë e rinovueshme, eficiencën e energjisë dhe infrastrukturën e rrjetit. Përshtatja e infrastrukturës mbështetëse dhe mbrojtja e infrastrukturës së banesave dhe të asaj të prodhimit, akomodimit dhe të aseteve turistike nga faktorët klimatikë do të ketë nevojë për akses në teknologji të reja.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit, institucion i varësisë së Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, do të jetë pjesë e standardizimit të formateve për të dhënat nga institucionet kërkuese duke qenë se është një

²²VKM nr. 636, datë 29.7.2020.

²³VKM nr. 370, datë 1.6.2022.

²⁴ <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2022/04/06/210>.

²⁵ Aktivitetet e planifikuara për të realizuar këtë masë janë:
5.5.1.a. Analizimi dhe prezantimi i gjendjes aktuale të kërkimit shëndetësor në vend, me qëllim zhvillimin e politikave dhe strategjive kombëtare për kërkimin shëndetësor shkencor.

5.5.1.b. Hartimi i strategjisë së kërkimit shkencor në sistemin shëndetësor.

Faqe | 15836

5.5.1.c. Mbështetja dhe përdorimi i evidencave kërkimore në zhvillimin e politikave shëndetësore

5.5.1.d. Rritja e kapaciteteve të kërkimit shkencor nëpërmjet programit “Kërkime Operacionale në Shëndetësi”.

²⁶ Vendimi nr. 173, datë 24.3.2023, “Për miratimin e strategjisë kombëtare të punësimit dhe aftësive 2023–2030”, planit të veprimit për zbatimin e saj, si dhe planit të zbatimit të garancisë rinore 2023–2024.

<https://qbz.gov.al/eli/vendim/2023/03/24/173>



institucion i cili grumbullon dhe gjeneron të dhëna të cilat mund të përdoren për kërkim shkencor, inovacion dhe transferim teknologjik.

Lidhja me PKIE & *acquis* të BE-së

Strategjia Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023–2030 synon të reflektojë standardet e parashikuara në kapitullin 25 “Shkenca dhe kërkimi shkencor”, si dhe lidhet drejtpërdrejtë me rritjen e kapaciteteve institucionale për të udhëhequr procesin e përafrimit të legjislacionit me *acquis* të BE-së për këtë kapitull.

Detyrimi i Shqipërisë për të ndërmarrë iniciativa politike, ligjore, institucionale dhe financiare në kapitullin 25, në mbështetje të konsolidimit të sistemit të kërkimit, rrjedh nga neni 109, i Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit (MSA), i cili përcakton shtyllat e bashkëpunimit ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian në fushën e kërkimit shkencor dhe zhvillimit teknologjik (titulli VIII - Politikat e bashkëpunimit/bashkëpunimit për kërkimin dhe zhvillimin teknologjik).

Në zbatim të metodologjisë së përcaktuar, kapitulli 25 përmban: - Financimin e programit buxhetor për kërkimin shkencor në kuadrin e Arsimit të lartë; - Performancën e Shqipërisë në programet kombëtare dhe ndërkombëtare të kërkimit shkencor (veçanërisht në programin kuadër H2020); - Strategjinë e Specializimit të Zgjuar, ecuria gjatë 2021; - Politikën e Shkencës së Hapur (*Open Science*).

Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2022–2024 rendit, ndër arritjet kryesore për kapitullin 25, “Shkenca dhe kërkimi”, për vitin 2021:

- Ecuria me përgatitjen e Strategjisë së Specializimit të Zgjuar;
- Rritja e buxhetit për kërkimin shkencor;
- Përmirësimi i infrastrukturës së kërkimit shkencor si rezultat i masave në kuadrin të “Paktit për Universitetin”;
- Ndërtimi i anketës dhe marrja e informacionit mbi disa indikatorë dhe prodhimin e statistikave të fushës së kërkimit shkencor dhe inovacionit;
- Përmirësimi i kuadrit rregullator të vlerësimit të cilësisë së kërkimit shkencor, nëpërmjet VKM-së nr. 165, datë 21.3.2018, të ndryshuar. Në MAS është ngritur një grup pune për të siguruar informacionin e institucioneve të arsimit të lartë i cili do të shërbejë si bazë kombëtare të dhënash për këtë sistem.

Ndërkohë që për vitin 2022, Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2022–2024, bazuar edhe në

rekomandimet e Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë, për vitin 2021, rendit si prioritet për kapitullin 25 “Shkenca dhe kërkimi”:

- Financimin e programeve kombëtare/ndërkombëtare të bashkëpunimit shkencor e teknologjik të mbështetura financiarisht;
- Nxitjen e punës kërkimore në IAL-të publike, nëpërmjet financimit të drejtpërdrejtë të 3,500 kërkuesve, ku prioritet kanë gratë dhe vajzat;
- Projekte bashkëpunimi të institucioneve të arsimit të lartë me biznesin privat në programet kombëtare të kërkimit dhe zhvillimit, programet kombëtare dhe ndërkombëtare. Zgjerimi i bashkëpunimit të institucioneve të arsimit të lartë me biznesin privat;
- Fonde për pjesëmarrjen në marrëveshjen kuadër të programeve të BE-së për kërkim dhe inovacion, pjesëmarrje që premtan arritje të mëdha në kërkimin shkencor dhe synon sigurimin e konkurrueshmërisë;
- Fonde grant për pjesëmarrje më të drejtë dhe të plotë të Republikës së Shqipërisë në programin Erasmus+, programi i BE-së për arsimin, trajnimin, rininë dhe sportin, propozuar nga Komisioni Evropian, që synon të nxisë modernizimin e sistemeve arsimore me 20 milionë lekë në vit;
- Granti i punës kërkimore-shkencore dhe veprimtarive krijuese, ku janë parashikuar 1 miliard e 50 milionë lekë me një fond vjetor prej 250 milionë lekë në vit.

Lidhja me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm (OZHQ)

Strategjia Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023–2030 reflekton qëllimet dhe objektivat e hartuara në kuadrin të OZHQ 9 “Industri, inovacion dhe infrastrukturë”, sipas të cilit shtetet janë zotuar të ndërtojnë një infrastrukturë elastike, të promovojnë industrializimin e qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës dhe të nxisin inovacionin.

Në veçanti, ky dokument strategjik reflekton synimet 9.5 të OZHQ 9, në kontekstin e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm 2015–2030, për të inkurajuar maksimizimin e kërkimit shkencor, përmirësimin e aftësive teknologjike të sektorëve industrialë në të gjitha vendet, në veçanti vendet në zhvillim, duke përfshirë, deri në vitin 2030, inkurajimin e inovacionit dhe rritjen e konsiderueshme të numrit të kërkuesve shkencorë



dhe shpenzimeve publike dhe private të kërkimit dhe zhvillimit.

Lidhja me angazhime/marrëveshje të tjera ndërkombëtare

SKKSHTI 2023–2030 reflekton standardet dhe objektivat e parashikuara në marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuara nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, si dhe standarde të përpunuara nga organizmat ndërkombëtarë dhe rajonalë, ku shteti shqiptar ka marrë përsipër angazhime afatgjata. Ky dokument strategjik reflekton, ndër të tjera, standardet e akteve me natyrë ndërkombëtare, si më poshtë:

a) Agjenda e Ballkanit Perëndimor për inovacionin, kërkimin, edukimin, kulturën, të rinjtë dhe sportet;²⁷

b) Qasja Globale Evropiane për Kërkimin Shkencor dhe Inovacionin: Strategjia evropiane për bashkëpunimin ndërkombëtar në një botë që ndryshon;²⁸

c) Strategjia Evropiane për Kërkimin dhe Inovacionin 2020–2024 dhe Plani Strategjik i BE-së për Kërkimin dhe Inovacionin 2020–2024;

d) Parimet e Zonës Evropiane për Kërkimin *European Research Area* (ERA), që janë:

i. Sisteme kombëtare të kërkimit shkencor më efektive;

ii. bashkëpunim dhe konkurrencë ndërkombëtare optimale, duke përfshirë “zgjidhje e përbashkët e sfidave të mëdha” dhe “infrastrukturat e kërkimit”;

iii. një treg pune i hapur për kërkuesit;

iv. barazi gjinore dhe aplikimi i politikave gjinore edhe në kërkim;

v. qarkullim optimal, akses dhe transferim i njohurive shkencore, duke përfshirë “qarkullimin e njohurive” dhe “aksesin e hapur”;

vi. bashkëpunimi ndërkombëtar²⁹;

e) *European Research Area Policy Agenda: Overview of Actions for the period 2022–2024*³⁰;

f) programi kuadër i ri evropian për kërkimin dhe inovacionin “*Horizon Europe*”;

g) *European Research Infrastructure Consortium* (ERIC)³¹;

Lidhja e Strategjisë me Agjendën e Ballkanit Perëndimor për Kërkimin, Inovacionin, Edukimin, Kulturën, Rininë dhe Sportet (Agjenda)

Strategjia e re për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023–2030 mishëron në të njëjtën kohë frymën dhe qëllimet politike të Agjendës së Ballkanit Perëndimor për Kërkimin, Inovacionin, edukimin, kulturën, rininë dhe sportet (Agjenda). Agjenda rendit si pjesë të reformës së saj politike mbështetjen e reformave në vendet e Ballkanit Perëndimor (përfshirë Shqipërinë) në fushën e kërkimit shkencor dhe inovacionit. Në mënyrë të veçantë, Agjenda politike rendit si pjesë të prioritetëve strategjike:

a) asocimi i plotë në *Horizon Europe* për Ballkanin Perëndimor;

b) mbështetja e asocimit afatgjatë dhe të plotë në programet Erasmus+ dhe Korpusit Evropian të Solidaritetit për Ballkanin Perëndimor;

c) asocimi i plotë në programin e Evropës Krijuese për Ballkanin Perëndimor;

d) integrimi në Zonën e re Evropiane të Kërkimit dhe Inovacionit (ERA);

e) Të mundësojë një pjesëmarrje më të fortë në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë (EHEA);

f) Finalizimi i Strategjisë së Specializimit të Zgjuar (S3) dhe mbështetja e zbatimit e tyre për të gjithë shtetet.³²

Arritjet dhe mësimet e nxjerra nga zbatimi i Strategjisë për Shkencën, Teknologjinë dhe Informacionin gjatë periudhës 2017–2022

²⁷Western Balkans Agenda on Innovation, Research, Education, Culture, Youth and Sports tek

https://ec.europa.eu/info/research-and-innovation/strategy/strategy-2020-2024/europe-world/international-cooperation/western-balkans_en#agenda-on-innovation-research-education-culture-youth-and-sports.

²⁸Komisioni Evropian “COMMUNICATION FROM THE COMMISSION TO THE EUROPEAN PARLIAMENT, THE COUNCIL, THE EUROPEAN ECONOMIC AND SOCIAL COMMITTEE AND THE COMMITTEE OF THE REGIONS on the Global Approach to Research and Innovation Europe’s strategy for international cooperation in a changing World” Brussels, 18.5.2021 COM(2021) 252 final, tek

https://ec.europa.eu/info/sites/default/files/research_and_innovation/strategy/strategy-2020-2024/europe-world/international-cooperation/western-balkans_en#agenda-on-innovation-research-education-culture-youth-and-sports
Faqe | 15838

https://ec.europa.eu/info/research-and-innovation/documents/ec_rtd_com2021-252.pdf.

²⁹https://research-and-innovation.ec.europa.eu/strategy/strategy-2020-2024/our-digital-future/european-research-area_en

³⁰https://research-and-innovation.ec.europa.eu/system/files/2021-11/ec_rtd_era-policy-agenda-2021.pdf.

³¹https://research-and-innovation.ec.europa.eu/strategy/strategy-2020-2024/our-digital-future/european-research-infrastructures/eric_en

³²Western Balkans Agenda on Innovation, Research, Education, Culture, Youth & Sport, Political Agenda, European Union 2021.



Strategjia Kombëtare e Kërkimit Shkencor, Teknologjisë dhe Inovacionit 2017–2022 pasqyrore dhe përfshinte gjashtë prioritetet e ERA-s. Gjithashtu, ajo mbështetej në prioritetet e përcaktuara në Agjendën e 21-të OKB-së, Agjendën 2030 për Zhvillimin e Qëndrueshëm, Strategjinë Evropë 2020, Agjendën Evropiane për Unionin e Inovacionit dhe Strategjinë e Zhvillimit Rajonal SEE-2020. Në zbatim të saj, AKKSHI ka vazhduar të koordinojë dhe promovojë *Horizon Europe*, MSCA, COST, EURAXESS, *Charter and Code*, HRS4R dhe CEEPUS program.

Strategjia Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin 2017–2022 u monitorua për herë të parë në 2019-n, përmes urdhrit të ministrit nr. 120, datë 28.2.2019, “Për monitorimin e Strategjisë Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin 2017–2022”. Gjatë 2021-shit, me urdhrin nr. 425, datë 2.11.2021, të ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për ngritjen e grupit të punës për monitorimin e Strategjisë Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin 2017–2022”, GP-ja monitoroi për herë të dytë zbatimin e “Strategjisë Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin 2017–2022”.

Në të dyja rastet, analiza u realizua **në dy nivele** për çdo prioritet strategjik:

- Identifikim të statusit të produkteve;
- Identifikim të statusit për arritjen e treguesve.

SKKSHTI 2017–2022 ishte e organizuar në katër (4) prioritetet strategjike, tetë (8) qëllime strategjike dhe njëzet (20) objektiva, progresi i të cilave synohej të matej nëpërmjet realizimit të dyzet e pesë (45) produkteve dhe arritjes së gjashtëmbëdhjetë treguesve të rezultetit për një periudhë pesëvjeçare. Bazuar në raportin e monitorimit, Strategjia Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin 2017–2022 (SKKSHTI) dhe plani i veprimit të saj janë vlerësuar si një hap pozitiv në kuadër të planifikimit të masave për konsolidimin institucional, ligjor e financiar të kërkimit shkencor, ekosistemit të inovacionit dhe zhvillimit teknologjik. Megjithatë, raporti i monitorimit të Strategjisë evidentoi rëndësinë e rishikimit të resurseve buxhetore të planifikuara për kërkimin shkencor dhe inovacionin nga 0.03% e PBB-së në 1% të saj.

Hartimi i strategjisë u ndërmor në kuadër të procesit të reformimit të Sistemit të Shkencës

iniciuar nga qeveria, mbështetur në hartimin e tri dokumenteve kryesorë:

1. Hartimi i Strategjisë Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin për periudhën 2017–2022;

2. Hartimi i dokumentit politik për riformimin e sistemit institucional të kërkimit shkencor në Republikën e Shqipërisë;

3. Hartimi i projektligjit për shkencën në Republikën e Shqipërisë.

Me gjithë përpjekjet dhe iniciativën në nivel ministrie, raporti i vlerësimit nënvizon se projektligji për kërkimin shkencor është ende në pritje të miratimit. Mosmiratimi i projektligjit ka ndikuar në vonesën e ngritjes së sistemit institucional të kërkimit shkencor të planifikuar në Strategji:

- Krijimi i këshillit ndërmintor të politikave të shkencës, teknologjisë e inovacionit;

- Krijimi i një strukture koordinuese kombëtare për politikën SHTI;

- Krijimi i nënkomisionit të përhershëm parlamentar për shkencën, teknologjinë e inovacionin pranë komisionit të arsimit.

Raportet e monitorimit kanë evidentuar një sërë arritjesh në fushën e shkencës, teknologjisë dhe inovacionit. Është hartuar dokumenti rekomandues mbi riformimin e sistemit institucional të kërkimit shkencor në Shqipëri nga grupi i punës, ngritur me urdhrin nr. 276, datë 1.6.2016, të ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për ngritjen e grupit të punës për riformimin e sistemit institucional të kërkimit shkencor”. Ky dokument përcakton vizionin, misionin dhe parimet bazë të reformës së kërkimit shkencor.

AKKSHI, bazuar në vendimin nr. 11, datë 26.6.2019, të Bordit të Administrimit, ka realizuar financimin e 6 projekteve të aplikuara në thirrjen e shpallur në muajin qershor 2018, në 6 fushat e programeve kombëtare të kërkim-zhvillimit. Vlera e financuar për këto projekte është 39,779,340 lekë. Në vitin 2021 u financua faza e dytë e këtyre projekteve në vlerën 8,941,663 lekë. Po kështu, bazuar në vendimin nr. 1, datë 21.7.2021, të Bordit të Administrimit, AKKSHI ka realizuar financimin e 15 projekteve të infrastrukturës së kërkimit shkencor në vitin 2019. Vlera e projekteve të financuara është 164,114,255 lekë. Gjatë 2021-shit, bazuar në vendimin nr. 1, datë 1.10.2021, të Bordit të Administrimit, AKKSHI ka realizuar financimin e 15 projekteve të infrastrukturës së kërkimit



shkencor për vitin 2021, në shumën 186,300,255 lekë. 55% e drejtuesve të projekteve të financuara në AKKSHI, në vitin 2021, ishin gra dhe vajza.

Ndërkohë, Agjencia Kombëtare e Financimit dhe Arsimit të Lartë (AKFAL), organizimi dhe funksionimi i të cilës është miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 397, datë 3.5.2017, në zbatim të ligjit të arsimit të lartë nr. 80/2015, me funksion parësor shpërndarjen e fondeve publike për mbështetjen e veprimtarisë së institucioneve publike të arsimit të lartë, mbështetjen me bursa të studentëve, dhe garantimin e skemës së kredive studentore, është bërë funksionale.

Mbështetur në vendimin nr. 504, datë 24.6.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të studentëve të cilët studiojnë jashtë vendit dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare të cilët përfitojnë bursa nga Republika e Shqipërisë”, platforma “Databaza e studentëve” aktualisht është funksionale dhe e aksesueshme. Baza e të dhënave shtetërore e studentëve shqiptarë ka si institucion administrues Agjencinë Kombëtare të Diasporës. Platforma përbën risi në zhvillimin e një sistemi informatik për automatizimin e procedurës së përfitimit të bursave të studimit nga Republika e Shqipërisë, i cili në zbatim të politikave të institucionit do të përmirësojë procesin e regjistrimit, verifikimit dhe menaxhimit të të gjithë të dhënave të nevojshme të studentëve.

Agjencia Kombëtare e Diasporës, në kuadër të realizimit të misionit të saj, bazuar në ligjin nr. 115, datë 18.12.2017, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”, të ndryshuar, me qëllim ruajtjen dhe promovimin e vlerave të identitetit kombëtar dhe trashëgimisë kulturore, si dhe forcimin dhe konsolidimin e bashkëpunimit institucional me diasporën, ka nënshkruar me datë 16.9.2021, marrëveshje bashkëpunimi me institutin “Alb-Shkenca”. Nëpërmjet kësaj marrëveshje palët synojnë nxitjen e bashkëpunimit me Diasporën Shkencore Shqiptare në fushën e kërkim-zhvillimit, organizimin e takimeve dhe konferencave shkencore, botimin e punimeve dhe studimeve shkencore.

Referuar rritjes së bashkëpunimit mes komunitetit të kërkimit shkencor dhe biznesit 2017–2022, për periudhën 2017–2019 qeveria shqiptare vuri në dispozicion të mbështetjes së NVM-ve fondin total prej 194 000 000 lekë, të ndarë sipas fushave përkatëse, konkretisht:

- Fondi i Konkurrueshmërisë, për periudhën referuese, me një total prej 94 000 000 lekë.

- Fondi në Mbështetje të Sipërmarrjeve të Reja *Startup*, për periudhën referuese, me një total prej 30 000 000 lekë.

- Fondi i Inovacionit, për periudhën referuese, me një total prej 40 000 000 lekë.

- Fondi i Ekonomisë Kreative, (Artizanatit), për periudhën referuese, me një total prej 30 000 000 lekë.

Gjatë kësaj periudhe aplikuan në total 246 ndërmarrje dhe prej tyre u mbështetën 169 ndërmarrje, pra rreth 70% e aplikuesve kanë qenë aplikime cilësore të vlerësuara nga KAG (Komisioni i Aprovimit të Grantit) si fituese të mbështetjes financiare.

Për vitin 2020 dhe 2021, AIDA, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, ka finalizuar procesin e hartimit të skemave të reja të grantit për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme shqiptare dhe ka hapur thirrjet për aplikime në vitin 2022.

Në fushën e bashkëpunimit midis institucioneve publike dhe IAL-ve në vend, Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI) ka nënshkruar disa marrëveshje me institucionet e arsimit të lartë (IAL) në vendin tonë.

Qëllimi i nënshkrimit të këtyre marrëveshjeve është përcaktimi i mënyrave dhe modaliteteve të caktuara për të rritur ndërgjegjësimin për konceptin e pronësisë industriale dhe intelektuale në tërësi, informimin dhe sensibilizimin e studentëve, stafit akademik të përfshirë në punë kërkimore dhe shkencore, lidhur me rëndësinë e mbrojtjes së të drejtave të pronësisë industriale, si dhe organizimin e aktiviteteve të përbashkëta, *internship*-eve, sesioneve të ndryshme të informimit sipas fushës së përgjegjësisë etj.

Në kuadër të rritjes së bashkëpunimit mes komunitetit të kërkimit shkencor dhe biznesit 2017–2022, janë realizuar një sërë aktiviteteve për rritjen e njohurive të bizneseve mbi projektet e Bashkimit Evropian për kërkimin shkencor, si dhe inovacionin, programet rajonale. Pozitive është mbështetja financiare e alokuar nga Delegacioni Evropian prej 6.6 milionë euro, në mbështetje të ekosistemit të inovacionit dhe *startup*-eve, në lidhje me hartimin dhe zbatimin e projektit pilot *Innovation Albania*. Vizioni i këtij projekti ishte:



1. Forcimi i ekosistemit të inovacionit në Shqipëri;

2. Përfshirja e qytetarëve në diskutimin e hulumtimit;

3. Krijimi e një mjedisi që tërheq dhe ushqen talentin;

4. Mbështetja e *startup*-eve shqiptare.

Megjithatë, raporti nënvizon se ende mbetet sfida ndërveprimi dhe koordinimi midis bizneseve dhe kërkuesve shkencorë.

Në kuadër të **vlerësimit të cilësisë së kërkimit shkencor** është miratuar vendimi nr. 165, datë 21.3.2018, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e metodologjisë së procesit të vlerësimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore të njësive bazë të institucioneve të arsimit të lartë”. Po kështu, për krijimin e Regjistrat Kombëtar të Revistave dhe Periodikëve Shkencorë në Republikën e Shqipërisë, në vitin 2021 është ngritur grupi i punës, me urdhrin nr. 394, datë 4.10.2021, të ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e udhëzimit për krijimin e Regjistrat Kombëtar të Revistave dhe Periodikëve Shkencorë në Republikën e Shqipërisë dhe për përcaktimin e kriterëve që duhet të plotësojnë revistat dhe periodikët shkencorë për t’u regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Republikës së Shqipërisë”. Në fund të vitit 2022, grupi i punës ka përfunduar punën e tij dhe rregullorja është miratuar.

Referuar krijimit të platformës (*online*) të të dhënave për kërkimit shkencor në RSH, në lidhje me kapacitetet njerëzore, infrastrukture, biblioteka & arkiva (*Albanian Research Information System-ARIS*), është ngritur portali i Kërkimit Shkencor (kërkimi-shkencor.arsimi.gov) qëllimi i të cilit është mbledhja, analizimi dhe përpunimi i të dhënave në shërbim të zhvillimit dhe rritjes së cilësisë së kërkimit shkencor në vend.

Në të njëjtën fushë është ngritur platforma UCRIS, e cila mbledh të dhënat e kërkimit shkencor që nevojiten për platformën ACRIS. Platforma bazohet në arkitekturën DSPACE-CRIS e cila është adaptuar sipas specifikave EUROCRIS dhe CERIF. Platforma është e lidhur me databazat e rëndësishme të kërkimit, si: PubMed, Scopus, *Web of Knowledge* (WoS), Google Scholar dhe ORCID, dhe mundëson edhe lidhjen me databazat evropiane të kërkimit *Open Air*. Platforma U-CRIS do të lidhet edhe me platformën kombëtare ACRIS, e

parashikuar për rankimin e IAL-ve në bazë të performancës në fushën e kërkimit shkencor.

Në fushën e nxitjes së inovacionit dhe mbështetjes së biznesit, Rrjeti Evropian i Ndërmarrjeve (*Enterprise Europe Network, EEN*) është rrjeti më i madh në botë për mbështetjen e NVM-ve me fokus ndërkombëtarizimin. Ai nxit rritjen e bizneseve dhe punësimin duke ofruar shërbime për NMV-të, si dhe burime për biznese të tjera, universitete dhe qendra kërkimore, ofron shërbime mbështetëse për të ndihmuar NVM-të të bëjnë biznes në Tregun Unik të BE-së, si dhe të përmirësojnë konkurrencën e NVM-ve evropiane. Rrjeti operon në Shqipëri me bashkëfinancim nga BE-ja, nën programin COSME që prej 2015. AIDA është koordinatori i këtij programi në Shqipëri, duke bashkëpunuar me 3 organizata të tjera brenda konsorciumit shqiptar, si: Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë dhe Instituti për Politikat Publike dhe Mirëqeverisje. Deri në 2021-shin, nëpërmjet shërbimeve të ofruara nga ky rrjet janë nënshkruar 32 marrëveshje partneriteti midis ndërmarrjeve shqiptare dhe atyre evropiane (www.een.al).

Gjithashtu, për nxitjen e biznesit për krijimin e sipërmarrjeve të reja (*startup*) në inovacion dhe teknologji, është miratuar fondi në mbështetje të sipërmarrjeve të reja “*startup*” me VKM-në nr. 593, datë 10.9.2014, “Për krijimin e fondit në mbështetje të sipërmarrjeve të reja *startup*”, të ndryshuar. Ky fond është menaxhuar nga AIDA për periudhën 2014–2019.

Sektorët kryesorë që ka mbështetur fondi, janë:

- Sektorin prodhues dhe të shërbimit;
- Sektorin e industrisë së lehtë;
- Sektorin e turizmit;
- Fushën e kërkimit dhe zhvillimit;
- Procesin e agropërpunimit;
- Fushën e dizenjimit, modelimit, artizanatit.

Për periudhën 2017–2019, nga ky fond kanë përfituar 51 kompani të reja nga 89 kompani aplikuese dhe janë disbursuar në total 21 551 378 lekë.

Gjithashtu, në 2022-shin janë miratuar edhe ligje dhe akte nënligjore, të tjera si:

1. Ligji nr. 25/2022, “Për mbështetjen dhe zhvillimin e *startup*-eve”;

2. VKM-ja nr. 311, datë 11.5.2022, “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për



veprimtarinë dhe mënyrën e ofrimit të shërbimit *startup one-stop-shop*, si dhe shërbimeve për të cilat aplikohet tarifa zero për mbështetjen e *startup-eve*”;

3. VKM-ja nr. 312, datë 11.5.2022, “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për përmbajtjen e regjistrimit të *startup-eve* dhe lehtësuesve, mënyrën e funksionimit dhe ndërlidhjen e tij me portalin qeveritar “*e-Albania*”, si dhe për dokumentet elektronike - pasaporta e *startup-eve* dhe pasaporta e lehtësuesve

4. VKM-ja nr. 315, datë 11.5.2022, “Për përcaktimin e kërkesave dhe kritereve që duhet të plotësojnë *startup-et* dhe lehtësuesit e *startup-eve*, si dhe miratimin e procedurave dhe afateve të thirrjes për përfitimin e granteve dhe masave mbështetëse”.

Referuar projekteve të bashkëpunimit ndërkufitar e ndërkombëtar në fushën e kërkimit shkencor, bazuar në Marrëveshjen e Bashkëpunimit Shkencor e Teknologjik midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Austrisë, nënshkruar në 2 maj 2012 dhe Protokollit të Përbashkët të mbajtur në 5.12.2014, gjatë 2018-s u çel thirrja për projekte bilaterale Shqipëri–Austri, në të cilin u përzgjedhën 10 projekte fituese dhe u financuan 7 projekte bilaterale me Austrinë. Gjatë vitit 2021, AKKSHI çeli thirrjen e dytë për paraqitjen e projektpropozimeve dypalëshe.

Bazuar në “Programin e bashkëpunimit në kuadër të marrëveshjes për bashkëpunimin mes Ministrisë së Arsimit e Sportit (MAS) të Republikës së Shqipërisë dhe Qendrës Kombëtare të Kërkimeve (*Centro Nazionale di Ricerca - CNR*)”, nr. 5295 prot., datë 19.5.2017, dhe në zbatim të udhëzimit nr. 13 prot., datë 12.7.2012, “Për procedurën e paraqitjes, shqyrtimit, miratimit dhe raportimit të projekteve që financohen në kuadrin e programeve të bashkëpunimit shkencor dhe teknologjik ndërmjet dy vendeve”, gjatë 2018-s, u financuan 2 projekte të paraqitura nga IAL-të private dhe 8 projekte të paraqitura nga IAL-të publike. Gjatë 2021-shit, pas hapjes së thirrjes së dytë tekniko-shkencore mes Shqipërisë dhe Italisë u përzgjedhën fitues 10 projektpropozime.

Në zbatim të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës, për bashkëpunimin në fushën e arsimit dhe shkencës, nënshkruar më 8.3.2010, hyrë në fuqi më datë 1.12.2011, miratuar me VKM-në nr. 265, datë 21.4.2010, “Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të

Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës, për bashkëpunimin në fushat e arsimit dhe të shkencës” dhe në zbatim të udhëzimit nr. 1 prot., datë 30.11.2017, “Për procedurën e paraqitjes, shqyrtimit, miratimit dhe raportimit të projekteve që financohen në kuadrin e programeve të bashkëpunimit shkencor dhe teknologjik ndërmjet dy vendeve”, gjatë 2020-s janë financuar 17 (shtatëmbëdhjetë) projektpropozime.

Gjithashtu, në kuadër të rritjes së bashkëpunimit rajonal, në fushën e shkencës dhe teknologjisë AKKSHI, gjatë 2021-shit, ka filluar procesin për bashkëpunim dhe programe të përbashkëta me Kroacinë, Maltën, Serbinë dhe Slloveninë.

Gjatë periudhës së zbatimit të programit kuadër të BE-së për kërkim shkencor dhe inovacion H2020, Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI), në rolin e Koordinatorit Kombëtar për H2020 dhe Rrjetin e Pikave Kombëtare të Kontaktit, ka ndërmarrë një sërë veprimtarish për promovimin, informimin dhe ngritjen e kapaciteteve të komunitetit kërkimor në vendin tonë.

Nga ana e AKKSHI-it u hartua databaza me adresat elektronike të listës së kërkuesve shkencorë të universiteteve publike, jopublike, si dhe instituteve kërkimore. Në këtë databazë janë regjistruar mbi 3800 adresa elektronike, të cilat shërbejnë si platformë *online* e shpërndarjes së informacionit mbi aplikimet në *Horizon* 2020 në kohë reale.

Gjithashtu, AKKSHI ka përgatitur dhe botuar në shqip udhërrëfyes e prezantimet informuese mbi Programin *Horizon* 2020 (H2020), ku çdo studiues mund të marrë çdo të dhënë mbi përmbajtjen e programit dhe mënyrën e aplikimit. Staf i AKKSHI-t ka asistuar grupet e kërkuesve shkencor, stafet akademike mbi aplikimin në thirrjet tematike të hapura dhe në ardhje H2020, partneritetet, rrjetet, trajnime etj.

Gjatë periudhës së zbatimit të programit, AKKSHI ka organizuar 190 ditë informuese dhe trajnuese në kuadër të programit H2020 në universitete publike, universitete jopublike, aktivitete në bashkëpunim me Komisionin Evropian DG *Research and Innovation*, APRE, *Research Executive Agency* (REA), RCC, Instituti Italian i Kulturës, NCP *Academy*, Projekti i Asistencës Teknike për Programet EU, aktivitetet të përbashkëta me kërkues shkencorë, SME dhe ekspertë vlerësues.



Lidhur me angazhimin institucional në iniciativat *Open Science* të Komisionit Evropian dhe Grupin e Punës *Open Science* të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal, RASH-i, në bashkëpunim me partnere të tjerë të *GÉANT Association* ka filluar implementimin e iniciativës kombëtare për *Open Science* në rajonin e Evropës Jugperëndimore përfshirë Shqipërinë përmes projektit NI4OS: *National Initiative for Open Science*. RASH-i ka krijuar iniciativën shqiptare për *Open Science* në bashkëpunim me AKKSHI-n. Janë bërë trajnime me të gjithë universitetet publike shqiptare për platformën UCRIS, e cila mbledh të dhëna për kërkimin shkencor dhe i bën ato “*FAIR ready*” për *Open Science* dhe ka filluar regjistrimi i të dhënave në platformën AGORA të NI4OS për *Open Science*.

Raporti i vlerësimit evidentoi disa mësimet e nxjerra nga zbatimi i SKKSHTI 2017–2022, përmes të cilave u hartuan disa rekomandime për çështje të cilat duhet t’i adresojë SKKSHTI 2023–2030:

- Përfshirja në planet vjetore të njësisë që mbulojnë fushën e kërkimit shkencor në MAS dhe institucionet e varësisë si AKKSHI, të masave të planifikuara në SKKSHTI;

- Rritja e bashkëpunimit dhe ndarja e informacionit midis njësisë që mbulojnë sektorin e kërkimit shkencor në MAS dhe institucioneve të varësisë;

- Integrimi i qëllimeve, objektivave strategjikë dhe produkteve në PBA e programit buxhetor “Kërkimi shkencor”;

- Rishikimi i fondit buxhetor, i planifikuar në draft PBA 2020–2022, në përputhje me planifikimin në strategji për arritjen e fondeve publike për kërkimin shkencor deri në 1 % të GDP-së;

- Plotësimi i kuadrit ligjor, i planifikuar në SKKSHTI ku theksohen: miratimi i ligjit për shkencën, draftudhëzimi mbi përcaktimin e kriterëve që duhet të plotësojnë revistat dhe periodikët shkencorë për t’u regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Republikës së Shqipërisë; plotësimi i akteve nënligjore në kuadër të metodologjisë së vlerësimit të kërkimit shkencor; kuadrit rregullator për lëvrimin e granteve të përbashkëta midis komunitetit të kërkuesve shkencor–bizneseve përmes Fondit të Teknologjisë e Inovacionit;

- Ngritja/konsolidimi i strukturës institucionale, krijimi i Këshillit Ndërmintor të Politikave të Shkencës, Teknologjisë e Inovacionit; krijimi i një Struktura Koordinuese Kombëtare për politikën

SHTI; krijimi i Nënkomisionit të Përhershëm Parlamentar për Shkencën, Teknologjinë e Inovacionin pranë komisionit të arsimit;

- Realizimi i vlerësimit dhe përmirësimit të infrastrukturës kombëtare të kërkimit shkencor duke krijuar Hartën Kombëtare të Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor, si dhe planin kombëtar të investimeve për infrastrukturën e kërkimit;

- Vijimi i masave për sigurimin e aksesit të hapur *online* për të gjitha botimet shkencore të financuara me fondet publike;

- Rishikimi i akteve nënligjore për krijimin e mekanizmave nxitës ligjorë dhe fiskalë për financimin e kërkimit shkencor nga biznesi;

- Marrja e masave në kuadër të përmirësimit të përfshirjes së Shqipërisë në programin *Horizon Europe* dhe bashkëpunimit me partnerë evropianë për t’u angazhuar në kërkim ndërkombëtar të përbashkët.

3. Deklarata e vizionit

3.1 Vizioni

Duke marrë në konsideratë zhvillimet e deritanishme, vizioni për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Informacionin 2023–2030 është: “*Deri në vitin 2030, Shqipëria do të sigurojë kërkim shkencor cilësor për një zhvillim socio-ekonomik të qëndrueshëm gjithëpërfshirës dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe evropiane, bazuar në njohuritë e reja shkencore dhe risitë në teknologji dhe inovacion*”.

Kjo strategji bazohet në parimet e mëposhtme:

- Cilësi, risi dhe origjinalitet në fushën e kërkimit shkencor, teknologjisë dhe inovacionit;

- Efektiviteti i kostos për rezultatet e dëshiruara;

- Qasje shumë disiplinore dhe ndërsektoriale për adresimin e sfidave në fushën e kërkimit shkencor, teknologjisë dhe inovacionit;

- Bashkëpunimi dhe partneriteti evropian dhe ndërkombëtar;

- Fuqizimi dhe rritja e pjesëmarrjes së grave, vajzave dhe të rinjve në procesin e kërkimit shkencor dhe hartimit të projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare në këtë fushë.

3.2 Qëllimet e politikave SKKSHTI

Vizioni i Strategjisë Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Informacionin 2023–2030 synohet të arrihet përmes këtyre qëllimeve të politikës:

Qëllimi i politikës 1: Rritja e efikasitetit dhe qëndrueshmërisë së sistemit për mbështetjen e




kërkimit shkencor, të integruar në nivel ndërkombëtar, në të gjithë spektrin e fushave të shkencave natyrore, inxhinierike dhe teknologjike, mjekësore, bujqësore, sociale dhe humane;

Qëllimi i politikës 2: Krijimi i një mjedisi që lehtëson dhe inkurajon mekanizmat e ndërveprimit dhe transferimit të teknologjive për bashkëpunim

midis komunitetit të kërkimit, ekonomisë, inovacionit dhe institucioneve publike;

Qëllimi i politikës 3: Promovimi i kulturës së shkencës dhe inovacionit në edukim për të siguruar një qasje didaktike me theksin në praktikën kërkimore dhe projektet.

Lidhja midis vizionit dhe qëllimeve të politikës, paraqitet në figurën më poshtë:



PJESA II – QËLLIMET E POLITIKAVE DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKË TË SKKSHTI 2023–2030

Qëllimi i politikës 1

Krijimi i një sistemi efikas dhe të qëndrueshëm për mbështetjen e kërkimit shkencor, të integruar në nivel ndërkombëtar, në të gjithë spektrin e fushave të shkencave natyrore, inxhinierike dhe teknologjike, mjekësore, bujqësore, sociale dhe humane.

Objektivat specifikë:

Objektivi specifik 1.1: Plotësimi dhe zbatimi i kuadrit ligjor dhe rregullator për të garantuar cilësinë, etikën dhe efektivitetin në zhvillimin dhe aplikimin e kërkimit në përputhje me fushat prioritare.

Objektivi specifik 1.2: Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore dhe infrastrukturës mbështetëse të kërkimit shkencor (infrastrukturës akademike) për rritjen e performancës në programet kombëtare dhe ndërkombëtare.

Objektivi specifik 1.3: Përmirësimi i mbledhjes, përpunimit, interpretimit dhe publikimit i treguesve statistikorë dhe të tjerë të kërkimit, zhvillimit të teknologjisë dhe inovacionit.

Institucionet drejtuese:

Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe AKKSHI, që është një institucion në varësi të MAS-it me programet buxhetore 09450, Arsimi universitar, 09770, Fonde për shkencën dhe 0110, planifikim, menaxhim dhe administrim

AKSHI, RASH, ASPA dhe INSTAT me programin buxhetor 01320 'Veprimtari statistikore'

Institucionet pjesëmarrëse:

RASH, IAL, AKKSHI, AKFAL, ML, ASCAL, ASHSH, AKSHI, AKD, institutet kërkimore pranë ministrive të linjës, AMSHC-ja, MAS-i, institucionet e kërkimit shkencor.

Masat dhe buxhetet e ndërlidhura për të arritur rezultatet specifike janë përshkruar në planin e

veprimet të dokumentit strategjik që do të ngarkohet në IPSIS.

Lidhja midis qëllimit të politikës dhe objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm (OZHQ).

Qëllimi i parë i politikës reflekton OZHQ 9 “**Industri, inovacion dhe infrastrukturë**—sipas të cilit shtetet janë zotuar të ndërtojnë një infrastrukturë elastike, të promovojnë industrializimin e qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës dhe të nxisin inovacionin”.

Në veçanti, ky qëllim reflekton **synimet 9.5 të OZHQ 9**, në kontekstin e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm 2015–2030, për të inkurajuar maksimizimin e kërimit shkencor, përmirësimin e aftësive teknologjike të sektorëve industrialë në të gjitha vendet, në veçanti vendet në zhvillim, duke përfshirë, deri në vitin 2030, inkurajimin e inovacionit dhe rritjen e konsiderueshme të numrit të kërkuësve shkencorë dhe shpenzimeve publike dhe private të kërimit dhe zhvillimit.

Objekti i specifik 1.1: Plotësimi dhe zbatimi i kuadrit ligjor dhe rregullator për të garantuar cilësinë, etikën dhe efektivitetin në zhvillimin dhe aplikimin e kërimit në përputhje me fushat prioritare.

Analiza e situatës dhe sfidat

Periodha 2017–2022 ka shënuar disa arritje, në kuadër të përmirësimit të kuadrit ligjor në fushën e shkencës, teknologjisë dhe inovacionit. Në këtë kuadër është hartuar dokumenti rekomandues mbi reformimin e sistemit institucional të kërimit shkencor në Shqipëri nga grupi i punës, ngritur me urdhrin nr. 276, datë 1.6.2016, të ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për ngritjen e grupit të punës për reformimin e sistemit institucional të kërimit shkencor”. Ky dokument përcakton vizionin, misionin dhe parimet bazë të reformës së kërimit shkencor.

Gjithashtu, me urdhrin nr. 57, datë 25.3.2022, të Kryeministrit, “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e projektligjit “Për shkencën në Republikën e Shqipërisë” është ngritur grupi i punës për hartimin e projektligjit të ri. Po kështu, me urdhrin nr. 212, datë 21.4.2022, të ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për caktimin e

përfaqësuesve të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe sekretariatit teknik të grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e projektligjit “Për shkencën në Republikën e Shqipërisë” janë caktuar përfaqësuesit e MAS-it dhe është ngritur sekretariati teknik.

Megjithatë, pavarësisht ngritjes së grupeve të punës ende nuk është finalizuar hartimi i draftit përfundimtar të projektligjit, me qëllim miratimin e tij në parlament. Mbetet gjithashtu problematike ngritja e një strukture të posaçme koordinuese në nivel kombëtar për koordinimin e politikave në fushën e shkencës, teknologjisë dhe inovacionit. Sfidë për t’u kapërcyer gjatë periudhës që do të mbulojë strategjia e re mbetet edhe hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore lidhur me statusin e kërkuësve shkencorë dhe kriteret për vlerësimin e kërimit shkencor që do t’i hapin rrugë rankimit të IAL-ve sipas performancës në kërkimin shkencor. Në kuadër të garantimit të cilësisë dhe etikës në kërkimin shkencor mbetet gjithashtu i nevojshëm hartimi dhe miratimi i Kodit të Etikës në Kërkimin shkencor. Në drejtim të promovimit të barazisë gjinore në fushën e shkencës, teknologjisë dhe inovacionit vlen të përmendet se Shqipëria ka përqindjen më të lartë grave dhe vajzave që kanë fituar gradën shkencore “Doktor” (62.3%).³³ Gjithashtu, nga viti 2021 është ngritur dhe funksionon Rrjeti i Grave Shqiptare në STEM, që synon të kontribuojë në fuqizimin social dhe ekonomik të grave dhe vajzave duke rritur përfaqësimin e tyre në STEM, si në fushën akademike ashtu edhe në kërkimin shkencor dhe inovacion.³⁴ Për më tepër, referuar të dhënave të përpunuara nga AKKSHI, rezulton se numri i projekteve fituese kombëtare dhe ndërkombëtare të drejtuara nga gratë dhe vajzat është më i lartë se ai i projekteve të drejtuara nga meshkuj. Të dhënat e 2022-shit tregojnë se nga 84 propozime të vlerësuara nga AKKSHI në të gjitha fushat prioritare, u shpallën si fitues 46 projekte nga të cilat 31 projekte drejtoheshin nga gra dhe vajza dhe 15 nga meshkuj. Megjithatë, arritjet e përmendura reflektojnë iniciativat për promovimin e barazisë gjinore vetëm në aspekte të veçanta të kërimit shkencor. Në këtë kuadër, me qëllim shtrirjen dhe promovimin e parimit të barazisë gjinore në të tre drejtimet që

³³ Shih të dhënat 2021 tek <https://op.europa.eu/en/web/eu-law-and-publications/publication-detail/-/publication/67d5a207-4da1-11ec-91ac-01aa75ed71a1>

³⁴ <https://scidevcenter.org/network-of-albanian-women-in-stem/>



mbulon kjo strategji, mbetet i rëndësishëm hartimi i një plani kombëtar për promovimin e barazisë gjinore në shkencë, teknologji dhe inovacion.

Së fundmi, procesi i integritimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, ka nxjerrë në pah detyrime lidhur me harmonizimin e kuadrit ligjor dhe rregullator shqiptar, në përputhje me atë të Bashkimit Evropian. Gjatë vitit 2022 ka filluar puna analitike për vlerësimin e përputhshmërisë së kuadrit ligjor dhe nënligjor shqiptar, në kuadër të kapitullit 25 të BE-së “Shkenca dhe kërkimi shkencor”. Në këtë aspekt, gjatë periudhës në të cilën shtrihet kjo strategji, do të mbetet në qendër të vëmendjes rishikimi i plotë i korpusit të akteve ligjore dhe kuadrit rregullator, përfshirë atë institucional për kërkimin shkencor, me qëllim plotësimin e detyrimeve që burojnë nga procesi i asociimit të BE-së, lidhur me kapitullin 25 “Shkenca dhe kërkimi shkencor”.

Rezultatet që pritet të arrihen përmes zbatimit të masave që lidhen me objektivin specifik.

Përmes zbatimit të masave të parashikuara në planin e veprimit synohen të arrihen rezultatet e mëposhtme:

- a) finalizimi dhe miratimi i ligjit “Për shkencën në Republikën e Shqipërisë”;
- b) hartimi i paketës së akteve nënligjore, në zbatim të ligjit “Për shkencën në Republikën e Shqipërisë”;
- c) zhvillimi i fushatave sensibilizuese për ligjin “Për shkencën në Republikën e Shqipërisë”;
- d) ngritja e Strukturës Kombëtare për Koordinimin e Politikave të Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit;
- e) hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore lidhur me Statusin e Kërkuesit Shkencor;
- f) hartimi dhe miratimi i Kodit të Etikës së Kërkuesit Shkencor;
- g) hartimi i kritereve dhe treguesve për vlerësimin e kërkimit shkencor dhe renditja e IAL-ve sipas performancës në kërkimin shkencor;

h) rishikimi i akteve ligjore dhe kuadër të kapitullit 25 të BE-së “Shkenca dhe Kërkimi shkencor”;

i) rishikimi i kuadrit rregullator, përfshirë atë institucional, për kërkimin shkencor në kuadër detyrimeve që burojnë nga procesi i asociimit në BE, lidhur me kapitullin 25 të BE-së “Shkenca dhe kërkimi shkencor”;

j) hartimi dhe miratimi i rregullores për krijimin e regjistrit kombëtar të revistave dhe periodikëve shkencorë;

k) hartimi dhe miratimi i planit kombëtar për promovimin e barazisë gjinore në shkencë, teknologji dhe inovacion.

Institucionet drejtuese:

Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe AKKSHI, që është një institucion në varësi të MAS-it me programet buxhetore 09450, Arsimi Universitar, 09770, Fonde për Shkencën dhe 0110, Planifikim, Menaxhim dhe Administrim, AKSHI

Institucionet pjesëmarrëse:

AKKSHI, IAL, ASCAL, RASH, ASHSH, ML, AKSHI

Lidhja e objektivit specifik me nënkaptullin përkatës të BE-së sipas MSA-së

Objekтиви specifik 1.1 synon të reflektojë standardet e parashikuara në kapitullin 25 “Shkenca dhe kërkimi shkencor”, si dhe lidhet drejtpërdrejtë me rritjen e kapaciteteve institucionale për të udhëhequr procesin e përafrimit të legjislacionit me *acquis* të BE-së për këtë kapitull. Detyrimi i Shqipërisë për të ndërmarrë iniciativë politike, ligjore, institucionale dhe financiare në kapitullin 25, në mbështetje të konsolidimit të sistemit të kërkimit, rrjedh nga neni 109 i Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit (MSA), i cili përcakton shtyllat e bashkëpunimit ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian në fushën e kërkimit shkencor dhe zhvillimit teknologjik (titulli VIII - politikat e bashkëpunimit/bashkëpunimit për kërkimin dhe zhvillimin teknologjik)

Lista e masave për arritjen e objektivit specifik 1.1:

Objektivi specifik 1.1: Plotësimi dhe zbatim i kuadrit ligjor dhe rregullator për të garantuar cilësinë, etikën dhe efektivitetin në zhvillimin dhe aplikimin e kërkimit në përputhje me fushat prioritare

Masat:

1.1.1	Miratimi i ligjit të ri “Për shkencën në Republikën e Shqipërisë”.
1.1.2	Miratimi i paketës së akteve nënligjore në zbatim të ligjit të ri, “Për shkencën në Republikën e Shqipërisë”.
1.1.3	Zhvillimi i fushatave sensibilizuese për ligjin “Për shkencën në Republikën e Shqipërisë”.
1.1.4	Krijimi i një strukture koordinuese kombëtare për politikën mbi shkencën, teknologjinë dhe inovacionin.
1.1.5	Hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore lidhur me statusin e kërkuesit shkencor.
1.1.6	Hartimi dhe miratimi i Kodit të Etikës në kërkimin shkencor.
1.1.7	Hartimi i kriterëve dhe treguesve për vlerësimin e kërkimit shkencor dhe renditja e IAL-ve sipas performancës në kërkimin shkencor.
1.1.8	Rishikimi i akteve ligjore dhe nënligjore në kuadër të kapitullit 25 të BE-së “Shkenca dhe kërkimi shkencor”.
1.1.9	Rishikimi i kuadrit rregullator përfshirë atë institucional, për kërkimin shkencor në kuadër të detyrimeve që burojnë nga procesi i asociimit në BE, lidhur me kapitullin 25 të BE-së “Shkenca dhe kërkimi shkencor”.
1.1.10	Përmirësimi i kuadrit rregullator lidhur me përcaktimin e fushave prioritare të kërkimit shkencor.
1.1.11	Hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore që garantojnë aksesin në publikime të kërkuesve shkencorë të vendit për të qenë në linjë me strategjitë e <i>Open Access</i> që zbatohen në nivel evropian.
1.1.12	Hartimi i një plani kombëtar për promovimin e barazisë gjinore në shkencë, teknologji dhe inovacion.
1.1.13	Miratimi dhe vënia në zbatim (funksionalizimi) i rregullores për krijimin e regjistrit kombëtar të revistave dhe periodikëve shkencorë dhe për përcaktimin e kriterëve që duhet të plotësojnë revistat dhe periodikët shkencorë për t’u regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Republikës së Shqipërisë.

Tabela nr. 1. Lista e masave për arritjen e objektivit specifik 1.1

Detajimi i plotë e masave është dhënë në planin e veprimit IPSIS.

Treguesit kryesorë të rezultateve

Tregues 1: Ligji “Për shkencën në Republikën e Shqipërisë” i përfunduar dhe miratuar.

Tregues 2: Struktura Kombëtare e Koordinimit të Politikave mbi SHTI, e ngritur dhe funksionale.

Tregues 3: Kuadri ligjor dhe rregullator mbi shkencën, teknologjinë dhe inovacionin i harmonizuar dhe në përputhje me direktivat dhe rregulloret e BE-së, në kuadër të kapitullit 25 “Shkenca dhe kërkimi shkencor”.

Tregues 4: Kodi i Etikës në kërkimin shkencor i hartuar dhe miratuar.

Tregues 5: Paketa e akteve nënligjore lidhur me ligjin “Për shkencën në Republikën e Shqipërisë” e finalizuar dhe miratuar.

Tregues 6: Plan kombëtar për promovimin e barazisë gjinore në shkencë, teknologji dhe inovacion i hartuar dhe miratuar.

Objektivi specifik 1.2: Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore dhe infrastrukturës mbështetëse të kërkimit shkencor (infrastrukturës akademike) për rritjen e performancës në programet kombëtare dhe ndërkombëtare.

Analiza e situatës dhe sfidat

Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore dhe ofrimi i trajnimeve të stafëve akademike dhe institucioneve të tjera, lidhur me shkrimin dhe pjesëmarrjen në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, është i rëndësishëm në rritjen e performancës së Shqipërisë në programet kombëtare dhe ndërkombëtare. Gjatë periudhës 2021–2022, AKKSHI ka vazhduar informimin e personelit akademik të IAL-ve lidhur me aplikimin dhe rritjen e pjesëmarrjes së tyre në programet kombëtare dhe ndërkombëtare.



Gjithashtu, sesionet e informimit janë organizuar edhe në kuadër të pjesëmarrjes së IAL-ne në projektet e infrastrukturës së kërkimit shkencor.

Gjatë periudhës së zbatimit të programit kuadër të BE-së për kërkim shkencor dhe inovacion H2020, Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI), në rolin e Koordinatorit Kombëtar për H2020 dhe rrjetin e pikave kombëtare të kontaktit, ka ndërmarrë një sërë veprimtarish për promovimin, informimin dhe ngritjen e kapaciteteve të komunitetit kërkimor në vendin tonë. Nga ana e AKKSHI-it u hartua databaza me adresat elektronike (*email*) të listës së kërkuesve shkencorë të universiteteve publike dhe ato jopublike, si dhe instituteve kërkimore. Në këtë databazë janë regjistruar mbi 3800 adresa elektronike të cilat shërbejnë si platformë *online* e shpërndarjes së informacionit mbi aplikimet në *Horizon* 2020 në kohë reale. Gjithashtu, AKKSHI ka përgatitur dhe botuar në shqip udhërrëfyes e prezantimet informuese mbi programin *Horizon* 2020 (H2020), ku çdo studiues mund të marrë çdo të dhënë mbi përmbajtjen e programit dhe mënyrën e aplikimit. Staf i AKKSHI-t ka asistuar grupet e kërkuesve shkencorë, stafet akademike mbi aplikimin në thirrjet tematike të hapura dhe në ardhje H2020, partneritetet, rrjetet, trajnime etj.

Një nga elementet kryesore të aktiviteteve të AKKSHI-it, për informimin dhe ngritjen e kapaciteteve kombëtare të H2020, ka qenë organizimi i eventeve të ditëve informuese dhe trajnuese H2020, në institucionet publike dhe jopublike të arsimit të lartë. Gjatë periudhës së zbatimit të programit, AKKSHI ka organizuar 190 ditë informuese dhe trajnuese në kuadër të programit H2020 në universitete publike, universitete jopublike, aktivitete në bashkëpunim me Komisionin *Evropian DG Research and Innovation*, APRE, *Research Executive Agency* (REA), RCC, Instituti Italian i Kulturës, NCP *Academy*, Projekti i Asistencës Teknike për programet EU, aktivitetet të përbashkëta me kërkues shkencorë, SME dhe ekspertë vlerësues.

Megjithatë, pavarësisht sesioneve të informimit, mbetet sfida rritja e kapaciteteve të kërkuesve shkencorë, lidhur me shkrimin e projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare, në mënyrë që përmbajtja dhe arritjet e tyre të kontribuojnë në cilësinë, rëndësinë dhe efektivitetin të kërkimit, si edhe në përmbushjen e qëllimeve strategjike në fushat prioritare. Gjithashtu, me rëndësi në këtë drejtim mbetet edhe forcimi i sistemit të shkencës përmes rritjes së bashkëpunimit në nivel ndërkombëtar dhe krijimit të rrjetit të kërkuesve shkencor brenda dhe jashtë Shqipërisë.

Në drejtim të infrastrukturës së kërkimit shkencor ose *infrastruktura akademike*, siç përmendet në ligjin e Arsimit të Lartë³⁵, sistemi shqiptar i kërkimit shkencor dhe inovacionit vuan nga mungesa e mjediseve të përshtatshme kërkimore, laboratorëve dhe infrastrukturave kërkimore për të kryer kërkime në të gjitha nivelet, një kusht themelor për kryerjen e veprimtarisë shkencore dhe teknologjike të çdo lloji. Për periudhën 2021–2023, qeveria shqiptare ka përfshirë mbështetjen për infrastrukturën kërkimore në Planin e saj të Rimëkëmbjes Ekonomike me rishikimet kryesore nga Komisioni Evropian në qershor 2022, duke rekomanduar një mbështetje të fortë për një koordinim të qartë ndërinstitucional, gjetjen e zgjidhjeve për kufizimet buxhetore dhe ndërtimi i besimit midis universiteteve dhe kompanive, subjekte që nuk kanë bashkëpunim në vend.³⁶ Udhërrëfyesi i parë i Infrastrukturës Kërkimore për Shqipërinë u publikua në mars 2022 nga Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal i financuar nga Komisioni Evropian.³⁷ Udhërrëfyesi i Infrastrukturës Kërkimore është një dokument strategjik kyç për identifikimin e kërkimit potencial dhe shërben si një mjet për të drejtuar zhvillimin e mëtejshëm të infrastrukturës kërkimore dhe integrimin e komunitetit të kërkimit shkencor me sektorin e biznesit të Shqipërisë.³⁸ Në drejtim të zhvillimit të infrastrukturës së kërkimit shkencor, udhërrëfyesi parashikon si nevojë rritjen e nivelit të investimeve në infrastrukturën kërkimore.³⁹ Në të njëjtën kohë,

³⁵ Neni 111, granti i politikave të zhvillimit për institucionet publike të arsimit të lartë.

³⁶ Ministria e Financave (2021) <https://www.financa.gov.al/wp-content/uploads/2021/02/Economic-Reform-Programme-2021-2023.pdf>.

³⁷ Regional Cooperation Council (2022) “Research Infrastructure Roadmap for Albania” i aksesueshëm tek

<https://www.rcc.int/download/docs/RI%20Roadmap%20Albania%20digital.pdf/c4abcbbc24ec0f623156ef8b257adebf.pdf>

³⁸ Ibid.

³⁹ Regional Cooperation Council (2022) “Research Infrastructure Roadmap for Albania” i aksesueshëm tek <https://www.rcc.int/download/docs/RI%20Roadmap%20Albania%20digital.pdf/c4abcbbc24ec0f623156ef8b257adebf.pdf>, faqe 6.



me rëndësi shihet rritja e investimeve totale në laboratorët kërkimorë. Përveç kësaj, financimi i qendrave të ekselencës në fushat prioritare kërkimore dhe ngritja e një parku shkencor dhe teknologjik, gjithashtu, duhet të merret parasysh në mënyrë që të krijohen kushte për zhvillimin e aktiviteteve kërkimore dhe inovative. Gjithashtu, mbetet sfiduese rritja e mobilitetit dhe bashkëpunimit institucional ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe më gjerë, si edhe marrja e masave për rritjen e lëvizshmërisë së studiuesve.⁴⁰

Gjatë periudhës që do të mbulojë Strategjia Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023–2030, synohen të përforcohen mekanizmat institucionale për promovimin e SHTI, si edhe të përmirësohet infrastruktura mbështetëse për zhvillimin e projekteve kërkimore dhe atyre në fushën e teknologjisë dhe inovacionit. Gjithashtu, gjatë të njëjtës periudhë, synohet rritja e kapaciteteve të kërkuesve në të gjitha strukturat arsimore, universitare, me qëllim aplikimin nga ana e tyre të projekteve kërkimore shkencore jo vetëm në nivel kombëtar, por edhe ndërkombëtar.

Rezultatet që pritet të arrihen përmes zbatimit të masave që lidhen me objektivin specifik

Përmes zbatimit të masave të parashikuara në planin e veprimit synohet të arrihen rezultatet, si më poshtë:

a) Kapacitetet e kërkuesve shkencor, në lidhje me aplikimin në programe kombëtare dhe ndërkombëtare të forcuara;

b) Infrastruktura mbështetëse e kërkimit shkencor, e forcuar dhe përmirësuar;

c) Platforma për aplikimin *online* të projekteve kërkimore e ngritur dhe funksionale;

d) Qendra Kombëtare Shkencore të Ekselencës të ngritura dhe të forcuara;

e) Harta Kombëtare e Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor në Shqipëri, e krijuar në përputhje me ESFRI (*European Strategic Framework of Research Infrastructure*);

f) Rritje e nivelit të mbështetjes financiare për aplikimin në projekte kombëtare;

g) Sistemi i shkencës dhe kërkimit shkencor, i forcuar dhe i përmirësuar përmes rritjes së bashkëpunimit në nivel ndërkombëtar;

h) Rrjeti i kërkuesve shkencor brenda dhe jashtë vendit, i ngritur.

Institucionet drejtuese:

Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe AKKSHI, që është një institucion në varësi të MAS-it, me programet buxhetore 09450, Arsimi universitar, 09770, Fonde për shkencën dhe 0110, planifikim, menaxhim dhe administrimi, RASH

Institucionet pjesëmarrëse:

AKFAL, IAL, RASH, ASHSH, AKD, institutet kërkimore pranë ministrive të linjës, AMSHC, MAS, ML.

Lidhja e objektivit specifik me nënkapitullin përkatës të BE-së sipas MSA-së

Objekтиви specifik 1.2 synon të reflektojë standardet e parashikuara në kapitullin 25, “Shkenca dhe kërkimi shkencor”, si dhe lidhet drejtpërdrejtë me rritjen e kapaciteteve institucionale për të udhëhequr procesin e përafrimit të legjislacionit me *acquis* të BE-së, për këtë kapitull. Detyrimi i Shqipërisë për të ndërmarrë iniciativë politike, ligjore, institucionale dhe financiare në kapitullin 25, në mbështetje të konsolidimit të sistemit të kërkimit, rrjedh nga neni 109 i Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit (MSA), i cili përcakton shtyllat e bashkëpunimit ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian në fushën e kërkimit shkencor dhe zhvillimit teknologjik (titulli VIII - politikat e bashkëpunimit/bashkëpunimit për kërkimin dhe zhvillimin teknologjik).

⁴⁰ Regional Cooperation Council (2022) “*Research Infrastructure Roadmap for Albania*” i aksesueshëm tek <https://www.rcc.int/download/docs/RI%20Roadmap%20Albania%20digital.pdf/c4abcbb24ec0f623156ef8b257adebf.pdf>, faqe 6.

[0Albania%20digital.pdf/c4abcbb24ec0f623156ef8b257adebf.pdf](https://www.rcc.int/download/docs/RI%20Roadmap%20Albania%20digital.pdf/c4abcbb24ec0f623156ef8b257adebf.pdf), faqe 6.

Lista e masave për arritjen e objektivit specifik 1.2:

Objektivi specifik 1.2: Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore dhe infrastrukturës mbështetëse të kërkimit shkencor për rritjen e performancës në programet kombëtare dhe ndërkombëtare	
	<i>Masat:</i>
1.2.1	Ngritja e kapaciteteve për shkrimin e projekteve kombëtare shkencore, në mënyrë që përmbajtja dhe arritjet e tyre të kontribuojnë në cilësinë, rëndësinë dhe efektivitetin e kërkimit dhe përmbushjen e qëllimeve strategjike në fushat prioritare.
1.2.2	Organizimi i ditëve informative dhe i aktiviteteve promovuese për thirrjet e projekteve në programe ndërkombëtare.
1.2.3	Trajnimi i stafeve akademike lidhur me aplikimin në programe ndërkombëtare.
1.2.4	Ngritja dhe forcimi i qendrave kombëtare shkencore të ekselencës që integrojnë studiues dhe burime kërkimore në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.
1.2.5	Krijimi i Hartës Kombëtare të Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor në Shqipëri në përputhje me ESFRI (<i>European Strategic Framework of Research Infrastructure</i>).
1.2.6	Forcimi i sistemit të shkencës dhe kërkimit shkencor përmes bashkëpunimit në nivel ndërkombëtar.
1.2.7	Krijimi i rrjeteve të kërkuesve shkencorë brenda dhe jashtë Shqipërisë.
1.2.8	Krijimi dhe përditësimi periodik i databazës së kërkuesve shkencorë.
1.2.9	Rritja e mbështetjes financiare për aplikimin në projekte kombëtare.
1.2.10	Forcimi i kapaciteteve të pikave kombëtare të kontaktit (programi <i>Horizon</i>).
1.2.11	Zhvillimi i platformës (<i>online</i>) të të dhënave për kërkimit shkencor në RSH, në lidhje me kapacitetet njerëzore, infrastrukturë, biblioteka dhe arkiva.

Tabela nr. 2: Lista e masave për arritjen e objektivit specifik 1.2

Detajimi i plotë i masave është dhënë në planin e veprimtimit IPSIS.

Treguesit kryesorë të rezultateve

Treguesit kryesorë të rezultateve në lidhje me këtë objektivi:

Tregues 1: Përqindja e kërkuesve shkencorë të trajnuar mbi shkrimin dhe aplikimin në projekte kombëtare/ndërkombëtare.

Tregues 2: Harta Kombëtare e Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor në Shqipëri e krijuar në përputhje me ESFRI (*European Strategic Framework of Research Infrastructure*).

Tregues 3: Përqindja e grave dhe vajzave drejtuese të projekteve shkencore kombëtare të kërkimit

Tregues 4: Përqindja e personelit akademik të IAL-ve, të trajnuar lidhur me aplikimin në programe ndërkombëtare.

Tregues 5: Numri i kërkuesve shqiptarë që kanë përfutur nga programet e shkëmbimit/ mobilitetit në kërkim.

Objektivi specifik 1.3: Përmirësimi i mbledhjes, përpunimit, interpretimit dhe publikimit të treguesve statistikorë dhe të tjerë të kërkimit, zhvillimit të teknologjisë dhe inovacionit.

Analiza e situatës dhe sfidat

Gjatë periudhës së zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin 2017–2022, AKKSHI dhe INSTAT-i kanë mbledhur dhe përpunuar të dhëna dhe tregues statistikorë që janë thelbësore për krijimin e databazave të të dhënave për kërkimin shkencor, teknologjinë dhe inovacionin. Me qëllim përmirësimit të sistemit të mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave mbi kërkimin shkencor, nga 2020-a AKKSHI dhe INSTAT-i kanë nënshkruar një memorandum bashkëpunimi, në kuadër të të cilit të dyja institucionet bashkëpunojnë në fushën statistikore, në kuadër të përmirësimit të cilësisë së prodhimit statistikor, në përputhje me parimet e statistikave zyrtare.⁴¹ Në kuadër të këtij

⁴¹Shih memorandumën e mirëkuptimit lidhur midis INSTAT-it dhe AKKSHI-it, datë 10.7.2020, nr. prot. 296.

memorandumi, AKKSHI ka bashkëpunuar ngushtësisht me INSTAT-it në drejtim të dërgimit të të dhënave të mbledhura brenda fushës së kërkimit shkencor. Megjithatë, mbetet sfidë mungesa e një metodologjie të plotë të mbledhjes së të dhënave statistikore në fushën e kërkimit shkencor.

Gjatë 2021-shit, INSTAT-i ka kryer vrojtime pranë sektorit të bizneseve private, organizatave jofitimprurëse, institucionet publike dhe institucionet e arsimit të lartë, si dhe ka mbledhur të dhënat administrative për fondet e alokuara buxhetore për K&Zh. Për mbledhjen e të dhënave në IAL, INSTAT-i ka bashkëpunuar me MAS-in.

Gjithashtu, me qëllim përmirësimin e sistemit të të dhënave gjatë periudhës që mbulon SKKSHI 2023–2030, nevojitet marrja e masave për rritjen e kapaciteteve të stafit të MAS-it, AKKSHI-y dhe instituteve të tjera kërkimore për mbledhjen, analizën dhe raportimin e standardizuar të statistikave për kërkimin shkencor sipas standardeve ndërkombëtare (EUROSTAT, OECD). Problematikë gjithashtu është numri i kufizuar i treguesve të performancës mbi kërkimin shkencor që do të mundësonte krahasimin në nivel evropian dhe ndërkombëtar.

Rezultatet që pritet të arrihen përmes zbatimit të masave që lidhen me objektivin specifik

- Përmes realizimit të masave të detajuara në planin e veprimit synohet të arrihen këto rezultate:
- Metodologjia e mbledhjes së të dhënave statistikore në fushën e kërkimit shkencor, e hartuar dhe miratuar;

- Buletini vjetor mbi kërkimin shkencor, i hartuar dhe publikuar;

- Kapacitetet teknike të stafit të MAS-it, AKKSHI-t dhe instituteve kërkimore të ngritura lidhur me mbledhjen, analizën dhe përpunimin e të dhënave sipas standardeve ndërkombëtare;

- Treguesit e performancës mbi kërkimin shkencor, të hartuara.

Institucionet drejtuese:

MAS me programet buxhetore 09450, arsimit universitar, 09770, fonde për shkencën, ASPA, INSTAT me programin buxhetor 01320, veprimtari statistikore

Institucionet pjesëmarrëse:

MAS-i, AKKSHI-i, institucionet e kërkimit shkencor, IAL-të, AKFAL-i, ML-ja.

Lidhja e objektivit specifik me nënkaptullin përkatës të BE-së sipas MSA-së

Objekтиви specifik 1.3 synon të reflektojë standardet e parashikuara në kapitullin 25 “Shkenca dhe kërkimi shkencor”, si dhe të lidhet drejtpërdrejtë me rritjen e kapaciteteve institucionale për të udhëhequr procesin e përafrimit të legjislacionit me *acquis* të BE-së për këtë kapitull. Detyrimi i Shqipërisë për të ndërmarrë iniciativë politike, ligjore, institucionale dhe financiare në kapitullin 25, në mbështetje të konsolidimit të sistemit të kërkimit, rrjedh nga neni 109 i Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit (MSA), i cili përcakton shtyllat e bashkëpunimit ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian në fushën e kërkimit shkencor dhe zhvillimit teknologjik (titulli VIII - politikat e bashkëpunimit/bashkëpunimit për kërkimin dhe zhvillimin teknologjik).

Lista e masave për arritjen e objektivit specifik 1.3:

Objekтиви specifik 1.3: Përmirësimi i mbledhjes, përpunimit, interpretimit dhe publikimi i treguesve statistikore dhe të tjerë të kërkimit, zhvillimit të teknologjisë dhe inovacionit	
	Masat:
1.3.1	Hartimi i metodologjisë së mbledhjes së të dhënave statistikore në fushën e kërkimit shkencor.
1.3.2	Hartimi dhe publikimi i të dhënave për kërkimin shkencor sipas periodicitetit të përcaktuar në Programin e Statistikave Zyrtare 2022–2026
1.3.3	Hartimi dhe publikimi i buletinit të përvitshëm për kërkimin shkencor.
1.3.4	Zhvillimi i kapaciteteve të stafit të MAS-it, AKKSHI-t dhe instituteve të tjera kërkimore për mbledhjen, analizën dhe raportimin e standardizuar të statistikave për kërkimin shkencor sipas standardeve ndërkombëtare (Eurostat, OECD).
1.3.5	Hartimi i treguesve të performancës mbi kërkimin shkencor, me qëllim krahasimin në nivel evropian dhe ndërkombëtar.

Tabela nr. 3: Lista e masave për arritjen e objektivit specifik 1.3.



Detajimi i plotë e masave është dhënë në planin e veprimtimit IPSIS.

Treguesit kryesorë të rezultateve

Treguesit e rezultatit të lidhur me këtë objektivi specifik janë:

Tregues 1: Metodologjia e mbledhjes së të dhënave statistikore në fushën e kërkimit shkencor, e hartuar dhe miratuar

Tregues 2: Përqindja e stafit të MAS-it, AKKSHI-t, të trajnuar mbi mbledhjen, analizën dhe raportimin e standardizuar të statistikave për kërkimin shkencor

Qëllimi i politikës 2

Qëllimi i politikës 2: Krijimi i një mjedisi që lehtëson dhe inkurajon mekanizmat e ndërveprimit dhe transferimit të teknologjive për bashkëpunim midis komunitetit të kërkimit, ekonomisë, inovacionit dhe institucioneve publike

Ky qëllim i politikës synohet të realizohet gjatë kohëzgjatjes së zbatimit të strategjisë dhe do të ndërtojë kapacitete për gjenerimin dhe transferimin e teknologjive nëpërmjet realizimit të objektivave specifike që janë:

Objektivi specifik 1: Rritja e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë, institucioneve të pushtetit qendror dhe pushtetit vendor, sektorit të biznesit dhe shoqërisë civile nëpërmjet zgjerimit të kërkimit dhe zhvillimit të projekteve të përbashkëta (*Quadruple Helix Model*).

Objektivi specifik 2: Përmirësimi i mekanizmave dhe rritja e mbështetjes së transferimit ndërkombëtar të teknologjisë (INT).

Objektivi specifik 3: Rritja e rolit të shkencës dhe inovacionit në zhvillimin teknologjik.

Objektivi specifik 4: Fuqizimi dhe rritja e kapaciteteve të qendrave të transferimit të teknologjisë për të avancuar njohuritë në një fushë të caktuar ose për të zhvilluar më tej teknologjinë.

Institucionet përgjegjëse drejtuese janë:

MBZHR, AKKSHI, MAS, MFE, DPPI, AKFAL

Ndërkohë institucionet kryesore pjesëmarrëse janë:

MAS, IAL, AIDA, ML, DPPI, AKKSHI; NJQV, ML, AKSHI, QTT, institutet kërkimore

Programet kryesore buxhetore, fondet e të cilëve do të kontribuojnë drejtpërdrejtë në realizimin e qëllimit janë:

Ministria e Financave dhe Ekonomisë

04130	Mbështetje për zhvillim ekonomik
04160	Mbështetje për mbikq. e tregut, infrast. e cilës. dhe pron. industr.

Ministria e Arsimit dhe Sporteve

09450	Arsimi Universitar
09770	Fonde për Shkencën

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural: 04860 Këshillimi dhe Informacioni Bujqësor

Qëllimi i dytë i politikës reflekton OZHQ 9 “Industri, inovacion dhe infrastrukturë - sipas të cilit shtetet janë zotuar të ndërtojnë një infrastrukturë elastike, të promovojnë industrializimin e qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës dhe të nxisin inovacionin.”.

Në veçanti, ky qëllim reflekton synimet 9.5 të OZHQ 9, në kontekstin e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm 2015–2030, për të inkurajuar maksimizimin e kërkimit shkencor, përmirësimin e aftësive teknologjike të sektorëve industrialë në të gjitha vendet, në veçanti vendet në zhvillim, duke përfshirë, deri në vitin 2030, inkurajimin e inovacionit dhe rritjen e konsiderueshme të numrit të kërkuesve shkencorë dhe shpenzimeve publike dhe private të kërkimit dhe zhvillimit.

Objektivi specifik 2.1: Rritja e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë, institucioneve të pushtetit qendror dhe pushtetit vendor, sektorit të biznesit dhe shoqërisë civile nëpërmjet zgjerimit të kërkimit dhe zhvillimit të projekteve të përbashkëta (*Quadruple Helix Model*)

Analiza e situatës dhe sfidat

Realizimi i këtij objektivi vazhdon të mbetet një sfidë për Shqipërinë. Megjithatë, gjatë periudhës 2020–2021, ka pasur një sërë përpjekjesh me synimin për të krijuar ura bashkëpunimi mes katër aktorëve kryesorë që janë të përfshirë në skemë. Kështu, gjatë 2021-shit ka filluar zbatimi i një projekti për ngritje kapacitetesh në arsimin e lartë në kuadër të programit Erasmus+ me titull “*University to Society Innomediaries in Albania: Co-Production of knowledge and research that matters*” (projekti USIA). Ky projekt bashkon universitetet, organizatat e shoqërisë civile, institucionet publike dhe organizatat e biznesit për të përmirësuar një



mjedis aftësues të arsimit të lartë që mbështet bashkëpunimin e universitetit me shoqërinë, në mënyrë që të bashkëprodhojnë njohuri dhe kërkime me një ndikim jo vetëm akademik, por edhe të zbatueshëm për zhvillimin e Shqipërisë në dritën e integritimit evropian dhe sfidave të shumta aktuale.⁴²

Në të njëjtën kohë, projekti synonte forcimin e kapaciteteve institucionale dhe të burimeve njerëzore në universitetet në Shqipëri nëpërmjet krijimit të njësisë së transferimit të njohurive dhe brokerimit të inovacionit, që lidh në mënyrë të institucionalizuar dhe të qëndrueshme universitetin me biznesin, qeverinë, shoqërinë civile dhe median. Gjithashtu, projekti do të krijonte dhe zgjeronte një rrjet *Quadruple Helix* dhe platformë *online* e cila do të ofronte rrjetëzim, ndërmjetësim, zhvillim kapacitetesh, mbështetje dhe vlerësim për aktorët akademikë dhe joakademikë. Projekti u dha përparësi grave dhe vajzave në akademi, kërkim dhe inovacion.

Kuadri i politikave në sektorin e arsimit të lartë inkurajojnë rritjen e bashkëpunimit dhe zhvillimin e projekteve të përbashkëta midis katër aktorëve (IAL, biznes, shoqëri civile dhe qeveri), në kuadër të promovimit të modelit *Quadruple Helix* në fushën e kërkimit shkencor, teknologjisë dhe inovacionit. Deri tani, në kuadër të bashkëpunimit sipas këtij modeli, si produkt i projektit, janë ngritur ose forcuar 5 qendra të transferimit të njohurive dhe inovacionit në 5 IAL; janë financuar dhe ka filluar zbatimin i 5 projekteve pilot bashkëpunimi universitet–biznes, si edhe janë ngritur 5 laboratorë pilot.⁴³

Megjithatë, mbetet sfida realizimi i një bashkëpunimi sa më efektiv dhe produktiv mes këtyre aktorëve nisur nga disa faktorë si: infrastruktura dhe fondet për kërkim janë të kufizuara; ka mungesë të incentivave për të bashkëpunuar me bizneset; ekziston një ndjenjë e përgjithshme mosbesimi në lidhje me cilësinë e kërkimit shkencor, si dhe kapacitete të kufizuara për të përthithur inovacionin⁴⁴, mungon njohuria e të gjithë aktorëve lidhur me mekanizmat dhe mundësitë e financimit etj.

Me futjen e arteve në fushat e kërkim-zhvillimit, (sipas manualit Frascati - fusha 6/6.4/0ECD 2015) bashkëpunimi ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë, institucioneve të pushtetit qendror dhe pushtetit vendor, sektorit të biznesit dhe shoqërisë civile, do të kishte në ndërvëprim në gjendje për t'u shfrytëzuar progresivisht në një të ardhme jo të largët. Ekosistemet e krijuara nga efektiviteti i bashkëpunimit të katër elementeve përbërëse të sistemit *Quadruple Helix*, vendosin një standard të ri për vetë rolin që mund të marrin dhe të luajnë universitetet në drejtim të ekspertizës së lartë dhe të certifikuar profesionale në dobi të hartimit, zhvillimit, monitorimit dhe të politikave në nivel lokal, qendror, si dhe në lidhje me përfshirjen transversale të shoqërisë civile në sfidat e zhvillimit të vendit. Në rastin e Universitetit të Arteve, politikat kulturore, ndërvëprimi i tyre me fusha të tjera të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik në nivel lokal e qendror, si turizmi dhe mjedisi, do të përfitonin në mënyrë reciproke nga ky pozicionim i arteve, në funksion të rritjes së bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë, institucioneve të pushtetit qendror dhe pushtetit vendor, sektorit të biznesit dhe shoqërisë civile nëpërmjet zgjerimit të kërkimit dhe zhvillimit të projekteve të përbashkëta (*Quadruple Helix Model*).

Rezultatet që pritet të arrihen përmes zbatimit të masave që lidhen me objektivin specifik.

Përmes realizimit të masave të detajuara në planin e veprimit synohet të arrihen këto rezultate:

- Skema novatore për bashkëfinancimin e programeve të kërkimit shkencor që forcojnë bashkëpunimin me sektorin e biznesit për zgjidhjen e sfidave aktuale shoqërore të zbatuara;
- Ditë informimi të të gjitha grupeve të interesit për mekanizmat dhe instrumentet e financimit;
- Udhëzues (*guideline*) për projekte të përbashkëta;
- Kapacitete të përmirësuara të IAL-ve, përfaqësuesve të biznesit, institucioneve qendrore

⁴²Për më tepër shiko: <https://usia.al/about-project/#:~:text=%E2%80%9CUniversity%20to%20Society%20Innomediaries%20in,11%20partners%20in%20Albania%2C%20Serbia>

⁴³Për më tepër shiko <https://www.cci.al/en/university-to-society-innomediaries-in-albania-co-production-of-knowledge-and-research-that-matters/>

⁴⁴Për më tepër shiko: <https://usia.al/mauris-a-diam-maecenas-sed-enim-ut-sem-viverra-aliqet/>



dhe lokale për hartimin e projekteve të përbashkëta.

Institucionet drejtuese:

MAS, MFE, AKKSHI me programet buxhetore:

Ministria e Financave dhe Ekonomisë

04130	Mbështetje për zhvillim ekonomik
04160	Mbështetje për mbikq. e tregut, infrast. e cilës. dhe pron. industr.

Ministria e Arsimit dhe Sporteve

09450	Arsimi universitar
09770	Fonde për shkencën

Institucionet pjesëmarrëse:

MAS, AKKSHI, IAL, AIDA, ML, NJQV, AKKSHI

Lidhja e objektivit specifik me nënkapitullin përkatës të BE-së sipas MSA-së.

Objektivi specifik 2.1 synon të reflektojë standardet e parashikuara në kapitullin 25 “**Shkenca dhe kërkimi shkencor**”, si dhe lidhet drejtpërdrejtë me rritjen e kapaciteteve institucionale për të udhëhequr procesin e përafrimit të legjislacionit me *acquis* e BE për këtë kapitull. Detyrimi i Shqipërisë për të ndërmarrë iniciativë politike, ligjore, institucionale dhe financiare në kapitullin 25, në mbështetje të konsolidimit të sistemit të kërkimit, rrjedh nga neni 109 i Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit (MSA), i cili përcakton shtyllat e bashkëpunimit ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian në fushën e kërkimit shkencor dhe zhvillimit teknologjik (titulli VIII - politikat e bashkëpunimit/bashkëpunimit për kërkimin dhe zhvillimin teknologjik).

Lista e masave për arritjen e objektivit specifik 2.1:

Objektivi specifik 2.1: Rritja e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë, institucioneve të pushtetit qendror dhe pushtetit vendor, sektorit të biznesit dhe shoqërisë civile nëpërmjet zgjerimit të kërkimit dhe zhvillimit të projekteve të përbashkëta (<i>Quadruple Helix Model</i>)	
	<i>Masat:</i>
2.1.1	Krijimi i skemave novatore për bashkëfinancimin e programeve të kërkimit shkencor që forcojnë bashkëpunimin me sektorin e biznesit për zgjidhjen e sfidave aktuale shoqërore.
2.1.2	Informimi dhe njohja e të gjitha grupeve të interesit me mekanizmat dhe instrumentet e financimit.
2.1.3	Promovimi i modeleve të kërkimit shkencor në pjesëmarrjen e projekteve të përbashkëta (<i>Quadruple Helix model</i>).
2.1.4	Hartimi i udhëzuesve (që përfshijnë protokollet dhe procedurat) për projekte të përbashkëta.
2.1.5	Forcimi i kapaciteteve të IAL-ve, përfaqësuesve të biznesit, institucioneve qendrore dhe vendore për hartimin e projekteve të përbashkëta.
2.1.6	Fuqizimi i kapaciteteve të strukturave të vlerësimit të projekteve të kërkimit shkencor, me qëllim përfaqësimin e biznesit në këto struktura.

Tabela nr. 4: Lista e masave për arritjen e objektivit specifik 2.1

Treguesit kryesorë të rezultateve

Tregues 1: Përqindja e projekteve të përbashkëta sipas modelit *Quadruple Helix* financuar nga AKKSHI.

Tregues 2: Përqindja e personelit akademik të trajnuar mbi hartimin e projekteve të përbashkëta (*Quadruple Helix*).

Tregues 3: Përqindja e fondeve të AKKSHI-t, dedikuar për garantet e përbashkët të komunitetit të kërkuesve shkencor–biznes.

Objektivi specifik 2.2: Përmirësimi i mekanizmave dhe rritja e mbështetjes së transferimit ndërkombëtar të teknologjisë (TNT)

Analiza e situatës dhe sfidat

Një sërë institucioneve janë të përfshira në ngritjen dhe përmirësimin e mekanizmave për të bërë të mundur transferimin e teknologjisë.

Ky produkt nuk përfshin angazhimin e AKKSHI-t në tërësinë e saj, por pjesërisht. Në këtë kuadër AKKSHI shpërndan informacion mbi



pronësinë industriale dhe intelektuale gjatë ditëve informative (*Info-Day*), të cilat synojnë auditorin e akademisë dhe biznesit.

Ditët informative organizohen nga Drejtoria e Programeve Ndërkombëtare (DPN) me pjesëmarrjen e Drejtorisë së Programeve Kombëtare (DPK). DPK-ja përfaqësohet në këto *Info-Day* nga Sektori i Inovacionit. Në këto evente, janë të ftuar si referues dhe përfaqësues së DPPI-së.

Gjatë periudhës 2017–2021 janë kryer 30 *Info-Day*, në të cilat është trajtuar pronësia industriale dhe intelektuale.

DPPI-ja në bashkëpunim dhe IAL-të në Republikën e Shqipërisë:

Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale ka nënshkruar 11 marrëveshje me Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL) në vendin tonë dhe më të fundit janë:

- Marrëveshje bashkëpunimi nënshkruar me datë 29.9.2021, ndërmjet DPPI-së dhe Universitetit POLIS;

- Marrëveshje bashkëpunimi nënshkruar me datë 29.4.2021, ndërmjet DPPI-së dhe Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës;

- Marrëveshje bashkëpunimi nënshkruar me datë 17.5.2021, ndërmjet DPPI-së dhe Universitetit të Tiranës/Instituti i Studimeve Evropiane;

Qëllimi i nënshkrimit të këtyre marrëveshjeve është përcaktimi i mënyrave dhe modaliteteve të caktuara për të rritur ndërgjegjësimin për konceptin e pronësisë industriale dhe intelektuale në tërësi, informimin dhe sensibilizimin e studentëve, stafit akademik të përfshirë në punë kërkimore dhe shkencore, lidhur me rëndësinë e mbrojtjes së të drejtave të pronësisë industriale, si dhe organizimin e aktiviteteve të përbashkëta, *internship*-eve, sesioneve të ndryshme të informimit sipas fushës së përgjegjësisë etj.

Në kuadër të këtij bashkëpunimi midis DPPI-së dhe IAL-ve, vlen të theksohet se DPPI-ja është angazhuar dhe ka ngritur 4 qendra të informacionit tekniko-shkencor pranë IAL-ve në shkallë vendi. Ngritja e këtyre qendrave është mjaft e rëndësishme dhe shërben për rritjen e ndërgjegjësimit të studentëve, stafit akademik shkencor, shpikësve dhe profesionistëve të përfshirë në punë kërkimore-shkencore, në nxitjen e tyre, si dhe në të drejtat që i përkasin nëpërmjet regjistrimit pranë DPPI-së. Qendrat janë të pajisura me logjistikën e nevojshme dhe me sistem kërkimi, “*EspaceNet*”, i cili është në

gjuhën shqipe. Krahës informacionit të nevojshëm në lidhje me fushën, pranë këtyre qendrave shpërndahen edhe materiale informuese në lidhje me markat tregtare, patentës, disenjot industriale dhe treguesit gjeografik. Stafi i DPPI-së, në mënyrë periodike, në bazë vjetore realizon trajnimin e studentëve dhe stafit akademik në lidhje me të drejtat e pronësisë industriale dhe kryesisht mbi patentat dhe shpikjet.

Është në fokusin dhe veprimtarinë e DPPI-së informimi i biznesit dhe i *startup*-eve, në lidhje me përfitimet që vijnë nga regjistrimi i të drejtave të pronësisë industriale. Nga burime zyrtare statistikore të të dhënave të DPPI-së, rezulton se kryhen mbi 120 takime pranë biznesit duke përfshirë mbi 20 qytete të Republikës së Shqipërisë. Përveç ndërgjegjësimit që DPPI-ja kryen në këto subjekte, stafi i kësaj të fundit ka kryer dhe IPD (*interview pre-diagnosis*) në biznese inovative, me potencial të mundshëm regjistrimi patente dhe/ose disenjo industriale.

Rezultatet që pritet të arrihen përmes zbatimit të masave që lidhen me objektivin specifik

Përmes realizimit të masave të detajuara në planin e veprimit synohet të arrihen këto rezultate:

- Kapacitete të përmirësuara;
- Infrastrukturë ekzistuese funksionale;
- Zhvillimi i infrastrukturave të reja;
- Transferimi i teknologjisë, i forcuar;
- Platforma e *Network*-ut, e forcuar;
- Protokolle dhe procedura të hartuara.

Institucionet drejtuese:

DPPI, AKKSHI, MFE

Institucionet pjesëmarrëse:

MAS, IAL, ML

Programet kryesore buxhetore, fondet e të cilëve do të kontribuojnë drejtpërdrejtë në realizimin e objektivit janë:

Ministria e Financave dhe Ekonomisë

04160	Mbështetje për mbikq. e tregut, infrast. e cilës. dhe pron. industr.
-------	--

Ministria e Arsimit dhe Sporteve

09450	Arsimi universitar
09770	Fonde për shkencën

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

04860 Këshillimi dhe Informacioni Bujqësor:



Lidhja e objektivit specifik me nënkapitullin përkatës të BE-së sipas MSA-së

Objektivi specifik 2.2 synon të reflektojë standardet e parashikuara në kapitullin 25 “Shkenca dhe kërkimi shkencor”, si dhe lidhet drejtpërdrejtë me rritjen e kapaciteteve institucionale për të udhëhequr procesin e përafrimit të legjislacionit me *acquis* të BE-së për këtë kapitull. Detyrimi i Shqipërisë për të ndërmarrë iniciativa politike, ligjore, institucionale dhe financiare në kapitullin 25, në mbështetje të konsolidimit të sistemit të kërkimit, rrjedh nga neni 109 i

Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit (MSA), i cili përcakton shtyllat e bashkëpunimit ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian në fushën e kërkimit shkencor dhe zhvillimit teknologjik (titulli VIII - politikat e bashkëpunimit/bashkëpunimit për kërkimin dhe zhvillimin teknologjik).

Lista e masave për arritjen e objektivit specifik 2.2:

Lista e masave është detajuar në planin e veprimit.

Objektivi specifik 2.2: Përmirësimi i mekanizmave dhe rritja e mbështetjes së transferimit ndërkombëtar të teknologjisë (TNT)	
<i>Masat:</i>	
2.2.1	Plotësimi i bazës ligjore të nevojshme për transferimin ndërkombëtar të teknologjive (TNT).
2.2.2	Fuqizimi i kapaciteteve të IAL-ve për transferimin ndërkombëtar të teknologjisë.
2.2.3	Zhvillimi i infrastrukturave të reja që mundësojnë transferimin ndërkombëtar të teknologjive.
2.2.4	Promovimi i programeve ndërkombëtare që mbështesin transferimin e teknologjisë dhe njohja e të gjithë grupeve të interesit me mekanizmat, instrumentet e financimit/mbështetjes së transferimit ndërkombëtar të teknologjisë.
2.2.5	Hartimi i udhëzuesve (që përfshijnë protokollet dhe procedurat) për hartimin e projekteve të përbashkëta.

Tabela nr. 5: Lista e masave për arritjen e objektivit specifik 2.2

Objektivi specifik 2.3: Rritja e rolit të shkencës dhe inovacionit në zhvillimin teknologjik

Analiza e situatës dhe sfidat

Së pari AKKSHI duhet që të nxisë bashkëpunimin IAL–biznes dhe për këtë arsye duhet të lëvrojë grante për bashkëpunime IAL–biznes. Hapat e parë janë hedhur, por duhet që të përshpejtohen veprimet. Kështu, pas hartimit të udhëzuesve përkatës duhet që të konsultohen këto udhëzime dhe pastaj të bëhet thirrja e parë me profil të tillë.

Por, nga ana tjetër, ka pasur përpjekje të dukshme për rritjen e financimit të SME-ve nëpërmjet fondeve dhe programeve me kontributin e qeverisë dhe donatorëve. Kështu AIDA ka kontribuar për periudhën 2017–2019 një vlerë prej 194,000,000 lekë⁴⁵. Në 2021-shin u përfundua hartimi i skemave

të reja të grantit për NVM-të dhe është hartuar ligji i ri për NVM-të.

Për sa i përket shërbimeve *online*, platforma Akses në Financë është krijuar për t’u shërbyer NMVM-ve shqiptare, të cilat duan të zgjerojnë dhe investojnë në aktivitetin e tyre duke përfutur mundësitë financiare që tregu ofron, me grante, kredi apo nisma të tjera financuese. Kjo platformë *online* ofron një shërbim *one-stop-shop* me informacione që lidhen drejtpërdrejtë me aksesin në financë për NMVM-të, i cili ofrohet në institucione, organizata apo kompani të ndryshme private dhe publike, kombëtare e ndërkombëtare. Ajo u lancua në maj 2021, dhe në të mesatarisht publikohen 4 thirrje të reja në muaj (<https://aida-smefinance.gov.al/>).

Gjithashtu, rol të rëndësishëm ka edhe AKKSHI me rritjet për projekte për STI-në. Kështu, në 2019-n, në PKKZH (Projekte Kombëtare të Kërkim-

⁴⁵ Fondi i Konkurrueshmërisë, për periudhën referuese, me një total prej 94 000 000 lekë.

• Fondi në Mbështetje të Sipërmarrjeve të Reja *Startup*, për periudhën referuese, me një total prej 30 000 000 lekë.

• Fondi i Inovacionit, për periudhën referuese, me një total prej 40 000 000 lekë.

• Fondi i Ekonomisë Kreative, (Artizanatit), për periudhën referuese, me një total prej 30 000 000 lekë.

Zhvillimit), 20% e fondit ishte për projekte për STI-në, në 2021-shin ishte 10% dhe në 2022-shin kjo përqindje ishte 13%. Luhatja tregon rëndësinë e promovimit dhe nxitjes së aplikimit për projekte në këtë fushë.

Një institucion tjetër që ka kontributin e vet është Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI). Ky institucion promovon teknologji të reja, harton strategji dhe plane veprimi për zbatimin e politikave në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit elektronik *e-Gov*, si dhe promovon aktivitetet e sektorit të TIK-ut brenda kornizës së detyrimeve, konventave dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, bilaterale dhe shumëpalëshe, në fushën e komunikimeve elektronike *e-Gov*. “*TechSpace*” është qendra e inovacionit dhe inkubatori shtetëror TIK në shërbim të *startup*-eve, studentëve dhe entuziastëve të fushës së teknologjisë dhe informacionit. *TechSpace* ka për qëllim të mbështesë me hapësira pune, trajnime, mentorime, asistencë dhe udhëzime të gjithë pjesëtarët e saj, në mënyrë që të ketë sa më shumë produkte në ndihmë të zhvillimit teknologjik. *Techspace*, si një inkubator i sipërmarrjeve të reja, ofron bashkëpunim, ambiente të posaçme për zhvillimin e idesë, rrjetëzim, mbështetje profesionale me konsulencë e mentorim, si dhe krijimin e mundësive për investime të mundshme. *TechSpace* nxit bashkëpunimin *triple helix* mes administratës publike, akademisë dhe bizneseve.

Rezultatet që pritet të arrihen përmes zbatimit të masave që lidhen me objektivin specifik

Përmes realizimit të masave të detajuara në planin e veprimit synohet të arrihen këto rezultate:

Udhëzimi për lëvrimin e granteve i hartuar.

Baza ligjore e hartuar.

Projekte shkencore me ndikim në inovacion dhe zhvillimin teknologjik të promovuar.

Institucionet përgjegjëse drejtuese:

AKKSHI, AKFAL, MFE

Programet buxhetore, buxheti i të cilave do të kontribuojë në realizimin e objektivit janë:

Ministria e Financave dhe Ekonomisë

04160	Mbështetje për zhvillimin ekonomik
-------	------------------------------------

Ministria e Arsimit dhe Sporteve

09450	Arsimi universitar
09770	Fonde për shkencën

Institucionet kryesore pjesëmarrëse:

MAS, DPPI, IAL, ML, AKSHI

Lidhja e objektivit specifik me nënkapitullin përkatës të BE-së sipas MSA-së

Ky objektiv është i lidhur me kapitullin 20 dhe kapitullin 25 të *acquis*, përkatësisht Ndërmarrjet dhe Politikat Industriale, Shkenca dhe Kërkimi Shkencor.

Lista e masave për arritjen e objektivit specifik 2.3

Për realizimin e këtij objektivit është planifikuar realizimi i masave të mëposhtme:

Objektiv specifik 2.3: Rritja e rolit të shkencës dhe inovacionit në zhvillimin teknologjik	
	<i>Masat:</i>
2.3.1	Hartimi i një udhëzuesi (<i>guideline</i>) për lëvrimin e granteve për financimin e programeve kombëtare të kërkim-zhvillimit dhe inovacionit.
2.3.2	Promovimi i projekteve shkencore me ndikim në inovacion dhe zhvillimin teknologjik
2.3.3	Vlerësimi i nevojave për zhvillimet teknologji/inovacion, me qëllim orientimin e projekteve kombëtare
2.3.4	Hartimi i projekteve për krijimin e qendrave rajonale të teknologjisë dhe inovacionit me qëllim mbështetjen e zhvillimit teknologjik

Tabela nr. 6: Lista e masave për arritjen e objektivit specifik 2.3.

Treguesit kryesorë të rezultateve

Tregues 1: Përqindja e projekteve shkencore me ndikim në inovacion dhe zhvillimin teknologjik financuar nga AKKSHI

Objektivi specifik 2.4: Fuqizimi dhe rritja e kapaciteteve të qendrave të transferimit të teknologjisë për të avancuar njohuritë në një

fushë të caktuar ose për të zhvilluar më tej teknologjinë

Analiza e situatës dhe sfidat

Për sa i përket këtij objektivit mund të thuhet se është e vështirë që të fuqizohet bashkëpunimi i shkencës dhe inovacionit me institucionet publike. Hapat e parë janë hedhur pasi IAL të ndryshme kanë



nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucionet publike. Gjithashtu, shumë nga IAL-të kanë nënshkruar edhe marrëveshje bashkëpunimi me biznese të ndryshme. Aktualisht janë krijuar në Shqipëri qendra të transferimit të teknologjive bujqësore⁴⁶, në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 515, datë 19.7.2006, “Për ristrukturimin e instituteve kërkimore shkencore në varësi të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit”. Kështu janë 5 qendra të tilla:

Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Fushë-Krujë;

Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Lushnjë;

Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Vlorë;

Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Korçë;

Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Shkodër;

Sfida është zhvillimi i qendrave të tilla, jo vetëm në bujqësi, por edhe në fusha të tjera.

Rezultatet që pritet të arrihen përmes zbatimit të masave që lidhen me objektivin specifik

Përmes realizimit të masave të detajuara në planin e veprimit synohet të arrihen këto rezultate:

Qendra të transferimit të teknologjisë funksionale.

Marrëveshje bashkëpunimi të ndërmarrjeve me kapacitete teknologjike me IAL-të dhe qendrat e transferimit të teknologjive sipas spirales së trefishtë (akademi–biznes–qeveri).

Institucionet përgjegjëse drejtuese:

Institucionet drejtuese janë AKKSHI, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ML

Programet buxhetore, buxheti i të cilave do të kontribuojë në realizimin e objektivit janë:

Ministria e Arsimit dhe Sporteve

09770	Fonde për shkencën
09450	Arsimi Universitar

Planifikimi, menaxhimi, administrimi në ML-të që kanë në varësi QTT-ja dhe Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

04860 Këshillimi dhe Informacioni Bujqësor:

Institucionet kryesore pjesëmarrëse:

MAS , DPPI, IAL, institutet kërkimore, ML, QTT.

Lidhja e objektivit specifik me nënkapitullin përkatës të BE-së sipas MSA-së.

Ky objektivi është i lidhur me kapitullin 11, kapitullin 20 dhe kapitullin 25 të *acquis*, përkatësisht bujqësia dhe zhvillimi rural, ndërmarrjet dhe politikat industriale, shkenca dhe kërkimi shkencor

Lista e masave për arritjen e objektivit specifik 2.4:

Për realizimin e këtij objektivi është planifikuar realizimi i masave të mëposhtme:

Objektivi specifik 2.4: Fuqizimi dhe rritja e kapaciteteve të qendrave të transferimit të teknologjisë për të avancuar njohuritë në një fushë të caktuar ose për të zhvilluar më tej teknologjinë	
	<i>Masat:</i>
2.4.1	Plotësimi i bazës ligjore për mirëfunksionimin e qendrave të transferimit të teknologjisë
2.4.2	Fuqizimi i marrëdhënieve midis QTT-së dhe akademisë
2.4.3	Rritja e kapaciteteve të punonjësve të QTT-së mbi shkrimin e projekteve
2.4.4	Nxitja e bashkëpunimit midis QTT-së dhe IAL-ve përmes projekteve të përbashkëta

Tabela nr. 7: Lista e masave për arritjen e objektivit specifik 2.4.

⁴⁶ Detyrat kryesore të QTTB-ve, përfshijnë:

Identifikimin, testimin, përshtatjen dhe futjen në praktikë bujqësore të metodave dhe materialeve (inputeve) të reja për vendin.

Përgatitjen e paketave teknologjike për kulturat bujqësore kryesore dhe mbarështimin e kafshëve.

Kërkime dhe testim në ferma bujqësore për problemet e ngritura nga fermerët e rajoneve përkatës.

Trajnime për specialistë të bujqësisë, fermerë, studentë të shkencave bujqësore dhe subjekte të tjera të interesuar.

Sigurimin e ekspertizës teknike për strukturat e shërbimit këshillimor dhe fermerët.

Demonstrimin e teknologjive të reja të kultivimit të kulturave bujqësore dhe mbarështimit të blegtorisë.

Përgatitjen dhe publikimin e materialeve divulgative për specialistët e bujqësisë dhe fermerët.

Mbështetjen me informacion të politikëbërjes nga ana e MBUMK-së në fushën e bujqësisë, ushqimit, mbrojtjes së konsumatorit dhe zhvillimit rural.



Treguesit kryesorë të rezultateve. Tregues 1: Përqindja (%) e IAL-ve që kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me qendrat e transferimit të teknologjisë.

Tregues 2: Baza ligjore për mirëfunksionimin e qendrave të transferimit të teknologjisë, e hartuar dhe miratuar.

Qëllimi i politikës 3

Qëllimi i politikës 3: Promovimi i kulturës së shkencës dhe inovacionit në edukim, për të siguruar një qasje didaktike me theksin në praktikat kërkimore dhe projektet

Ky qëllim i politikës synohet të realizohet gjatë kohëzgjatjes së zbatimit të strategjisë dhe do të rrisë informacionin e disponueshëm, në lidhje me institucionet, mbështetjen financiare apo edhe mundësitë e ofruara nga financimet/bashkëfinancimet e donatorëve, qoftë për ekspertët e fushës ashtu edhe për të rinjtë në arsimin parauniversitar apo edhe ata në arsimin e lartë. Aktualisht mund të thuhet se në sektorin e arsimit të lartë është rritur ndjeshëm informacioni dhe transparenca që u jepet aktorëve kryesorë në arsimin e lartë, por në arsimin parauniversitar ka të dhëna që të rinjtë nuk kanë informacion të mjaftueshëm dhe shpesh herë edhe të nevojshëm, në lidhje me inovacionin dhe pjesëmarrjen në projekte të ndryshme. Ka disa përpjekje për krijimin e rrjeteve të grave dhe vajzave në STEM, si ai i financuar nga Ambasada Amerikane nëpërmjet granteve të vogla. Rrjeti përbëhet kryesisht nga pedagogë të fakulteteve që ofrojnë programe studimi në IT dhe inxhinieri, dhe ata punojnë kryesisht me vajzat e shkollave të mesme për rritjen e interesit të vajzave në lëndët matematike, fizikë, kimi etj. Promovimi do të realizohet nëpërmjet realizimit me sukses të objektivave të mëposhtëm

Objektivi specifik 1: Reformimi i kurrikulës së shkencës në arsimin parauniversitar duke përfshirë STEM-in në edukim.

Objektivi specifik 2: Sensibilizimi në të gjitha nivelet e edukimit parauniversitar, për fuqizimin e rolit të të rinjve në kërkim dhe inovacion.

Objektivi specifik 3: Zhvillimi i kompetencës digjitale.

Institucionet përgjegjëse drejtuese janë MAS, ASCAP, AKSHI

Ndërkohë institucionet kryesore pjesëmarrëse janë MFE, AKKSHI, ASCAP, DPPI, NJQV Programet kryesore buxhetore, fondet e të cilëve do

të kontribuojnë drejtpërdrejtë në realizimin e qëllimit janë:

Ministria e Financave dhe Ekonomisë - 09240 Arsimi i mesëm (profesional)

Ministria e Arsimit dhe Sporteve - 09120 Arsimi bazë (përfshirë parashkollorin), 09230 Arsimi i mesëm (i përgjithshëm), 09770 Fonde për shkencën

Objektivi specifik 3.1: Reformimi i kurrikulës së shkencës në arsimin parauniversitar duke përfshirë STEM-in në edukim.

Analiza e situatës dhe sfidat

Aktualisht në arsimin parauniversitar janë bërë përpjekje që në lëndë jashtëkurrikulare të përfshihen elemente të cilat japin informacion në lidhje me praktikat kërkimore dhe projektet. Megjithatë, vihet re se nuk ka një modul apo një lëndë të mirëfilltë për praktikat kërkimore dhe projektet. Për këtë arsye synohet që të reformohen kurrikulat dhe të përçohet më shumë informacion, në fazat më të hershme të mundshme, tek të rinjtë dhe të rejat. Për vitin shkollor 2022–2023 ka nisur pilotimi i lëndës së TIK-ut që nga klasa e parë në 100 shkolla pilot, në të cilat janë ndërtuar laboratorët *smart*. Në këtë kuadër është miratuar programi mësimor i lëndës së TIK-ut për klasën e parë dhe është rishikuar plani mësimor i arsimit bazë për të përfshirë lëndën e re “TIK” si lëndë me zgjedhje për klasat I–III. Në terma afatgjatë, programi synon transformimin e sistemit të mësimdhënies së TIK-ut në kurrikulat parauniversitare nga klasa e I–XII, përmes kurrikulave të përditësuara, trajnimit të mësuesve dhe pajisjes së ambienteve shkollore me infrastrukturën e nevojshme për të kryer mësimdhënien cilësore të kësaj lënde. Gjithashtu, synohet përhapja sa më shpejt në rreth 1,200 shkolla në të gjithë vendin, duke i pajisur me *smartlabs* dhe zbatuar përdorimin e kurrikulave të reja apo të përditësuara.

Rezultatet që pritet të arrihen përmes zbatimit të masave që lidhen me objektivin specifik:

- Lëndë të reja që kanë të bëjnë me shkrimin akademik dhe shkrimin e projekteve të përgatitura;
- Staf mësimor i përgatitur.

Institucionet përgjegjëse drejtuese:

MAS me programet buxhetore arsimit bazë (përfshirë parashkollorin) dhe arsimit i mesëm (i përgjithshëm)

Institucionet kryesore pjesëmarrëse:



AKKSHI (Fonde për Shkencën), ASCAP, MFE me programin buxhetor arsimit mesëm (profesional)

Lidhja e objektivit specifik me nënkapitullin përkatës të BE-së sipas MSA-së

Ky objektivi është i lidhur me kapitullin 26 dhe kapitullin 25 të *acquis*, përkatësisht arsimit dhe kultura, shkenca dhe kërkimi shkencor.

Lista e masave për arritjen e objektivit specifik 3.1:

Masat që duhet të ndërmerren për të realizuar objektivin janë si më poshtë:

Objektivi specifik 3.1: Reformimi i kurrikulës së shkencës në arsimin parauniversitar duke përfshirë STEM-in në edukim	
	<i>Masat:</i>
3.1.1	Identifikimi i praktikave ndërkombëtare në drejtim të rishikimit të kurrikulave për përfshirjen e STEM-it në edukim
3.1.2	Përgatitja e stafit pedagogjik, lidhur me realizimin e praktikave kërkimore dhe zhvillimin e projekteve kërkimore në sistemin parauniversitar
3.1.3	Promovimi dhe përfshirja e orëve jashtëkurrikulare në arsimin parauniversitar mbi STEM-in
3.1.4	Përmirësimi i laboratorëve për zhvillimin e lëndëve STEM

Tabela nr. 8: Lista e masave për arritjen e objektivit specifik 3.1.

Treguesit kryesorë të rezultateve

Tregues 1: Përqindja e punonjësve të arsimit parauniversitar të trajnuar mbi shkrimin e projekteve kërkimore.

Tregues 2: Numri i fushatave të informimit në nivel të arsimit parauniversitar në fushën e shkencës, teknologjisë dhe inovacionit.

Tregues 3: Kurrikula e arsimit parauniversitar e reformuar me qëllim përfshirjen e STEM-it.

Objektivi specifik 3.2: Sensibilizimi në të gjitha nivelet e edukimit parauniversitar, për fuqizimin e rolit të të rinjve në kërkim dhe inovacion

Analiza e situatës dhe sfidat

Aktualisht në arsimin parauniversitar shpërndahet informacion minimal, në lidhje me kërkimin dhe inovacionin. Rol të rëndësishëm luajnë projektet e financuara nga donatorët e huaj, por edhe fushata të ndërmarra nga institucione të ndryshme si ministri i shtetit për Rininë dhe Fëmijët apo Ministria e Arsimit dhe Sportit. Duke pasur parasysh që brezat e rinj janë të lidhur drejtpërdrejtë

me teknologjinë dhe duke pasur parasysh eksperiencën e vendeve të tjera të botës mendohet se është i domosdoshëm sensibilizimi, duke filluar ndoshta nga klasa e parë, që të rinjtë dhe të rejtat të përfshihen sa më shumë në kërkim dhe inovacion.

Rezultatet që pritet të arrihen përmes zbatimit të masave që lidhen me objektivin specifik

- Kurse jashtëshkollore për inovacionin.

Institucionet përgjegjëse drejtuese:

MAS me programet buxhetore arsimit bazë (përfshirë parashkollorin) dhe arsimit mesëm (i përgjithshëm), ASCAP

Institucionet kryesore pjesëmarrëse:

AKKSHI (fonde për shkencën), MFE-ja (arsimi mesëm (profesional)), DPPI-ja, NJQV-të

Lidhja e objektivit specifik me nënkapitullin përkatës të BE-së sipas MSA-së

Ky objektivi është i lidhur me kapitullin 26 dhe kapitullin 25 të *acquis*, përkatësisht arsimit dhe kultura, shkenca dhe kërkimi shkencor

Lista e masave për arritjen e objektivit specifik 3.2:

Objektivi specifik 3.2: Sensibilizimi në të gjitha nivelet e edukimit parauniversitar, për fuqizimin e rolit të të rinjve në kërkim dhe inovacion

Masat:

3.2.1	Angazhimi i vazhdueshëm për mirinformimin e nxënësve të klasave të 9-ta dhe nxënësit/nxënëset e gjimnazeve për mundësitë që vijnë nga përfshirja në kërkim dhe inovacion
3.2.2	Promovimi dhe përfshirja e orëve/kurseve/aktiviteteve jashtëkurrikulare për inovacionin në sistemin parauniversitar

Tabela nr. 9: Lista e masave për arritjen e objektivit specifik 3.

Treguesit kryesorë të rezultateve

Tregues 1: Numri i fushatave ndërgjegjësuere me nxënësit/nxënëset e klasave të 9-ta dhe nxënësit/nxënëset e gjimnazeve për mundësitë që vijnë nga përfshirja në kërkim dhe inovacion.

Objektivi specifik 3.3: Zhvillimi i kompetencës digjitale.

Analiza e situatës dhe sfidat

Aktualisht në arsimin parauniversitar janë pjesë e kurrikulave edhe lëndët e teknologjisë që i pajisin nxënësit/nxënëset me informacionet bazë të domosdoshme. Megjithatë, sidomos pas periudhës së vështirë të kaluar gjatë mbylljes së detyruar prej COVID-19, doli domosdoshmëri zgjerimi i njohurive që marrin nxënësit/nxënëset. Kjo bëri që qeveria të marrë një sërë masash. Kështu që në vitin shkollor 2022–2023, në bashkëpunim me AADF-në, në Shqipëri ka nisur pilotimi i projektit “Inteligjenca Artificiale për të rinjtë” (Intel® AI for Youth). Që nga viti 2023, ky program zbatohet në më shumë se 27 vende në mbarë botën. Teknologjitë në zhvillim si inteligjenca artificiale (IA) po ndryshojnë dhe po riformojnë botën, duke pasur ndikim të jashtëzakonshëm në sektorin e punësimit dhe të ekonomisë, ndaj dhe ky projekt ka për qëllim të rrisë aftësitë që lidhen me teknologjinë dhe inteligjencën artificiale tek nxënësit/nxënëset shqiptare, të moshës nga 13 deri 19 vjeç. Të rinjtë do të mund të mësojnë nëpërmjet një kurrikule të ndërtuar nga Intel® Corporation, lider në industrinë e prodhimit të gjysmëpërçuesve, e cila është një ndër kompanitë më të mëdha të teknologjisë në botë. Janë bërë pjesë e projektit 9 institucione publike të arsimit të mesëm të lartë, në të cilët kurrikula e IA zhvillohet si orë jashtëkurrikulare dhe janë krijuar 2 kurse private falas për të rinjtë. Janë bërë pjesë e projektit 160 nxënës dhe trajnuar 25 mësues. Në të njëjtën linjë, MAS-i dhe Fondacioni Vodafone

Albania kanë nënshkruar në dhjetor 2021 memorandumën e bashkëpunimit për zbatimin e projektit “STEM”. Projekti, një program edukativ jashtë kurrikulës, i cili fuqizon mësuesit/mësueset dhe nxënësit/nxënëset nëpërmjet metodologjisë STEM, si dhe zhvillon aftësitë e tyre digjitale. Programi ka në fokus mësues dhe nxënës të shkollave publike në Shqipëri, të cilët do të trajnohen me metodologjinë STEM dhe do të mësojnë dhe zhvillojnë aftësitë nëpërmjet mjeteve digjitale (*Arduino*, kodimi, *App Inventor* etj.), do të identifikojnë çështje në komunitetin e tyre dhe do të zhvillojnë idetë e tyre për të zgjidhur probleme sociale nëpërmjet teknologjisë. Pjesë e projektit në vitin 2022 ishin 12 shkolla, me 258 nxënës përfitues dhe 20 mësues të trajnuar. Nga Komisioni i Akreditimit të Programeve/Moduleve të Trajnimit janë akredituar 57 module trajnimi ose 10.3% e totalit, për mësuesit/mësueset dhe për vitin 2022 janë trajnuar 2685 mësues në fushën e TIK-ut.

Rezultatet që pritet të arrihen përmes zbatimit të masave që lidhen me objektivin specifik

- Shkolla që kanë laboratorët për të ofruar kodimin;

- Nxënës me njohuri digjitale të përfituara.

Institucionet përgjegjëse drejtuese:

ASCAP, MAS me program buxhetor arsimit bazë (përfshirë parashkollorin), AKSHI

Institucionet kryesore pjesëmarrëse:

MAS me program buxhetor arsimit të mesëm (i përgjithshëm), ASCAP

Lidhja e objektivit specifik me nënkapitullin përkatës të BE-së sipas MSA-së

Ky objektivi është i lidhur me kapitullin 26 dhe kapitullin 25 të *acquis*, përkatësisht arsimit dhe kultura, shkenca dhe kërkimi shkencor.



Lista e masave për arritjen e objektivit specifik 3.3:

Objektivi specifik 3.3: Zhvillimi i kompetencës digjitale	
	Masat:
3.3.1	Përmirësimi i kurrikulës, futja e TIK-ut në klasën e parë
3.3.2	Zhvillimi i kompetencave digjitale të mësuesve përmes trajnimeve
3.3.3	Përmirësimi i infrastrukturës, <i>smartlab</i> -eve dhe pajisjeve të tjera të nevojshme

Tabela nr. 10: Lista e masave për arritjen e objektivit specifik 3.3.

Treguesit kryesorë të rezultateve

Tregues 1: Përqindja e mësuesve të trajnuar mbi kompetencat digjitale.

PJESA IV – ZBATIMI, LLOGARIDHËNIA DHE KOORDINIMI

Zbatimi efektiv dhe i suksesshëm i SKKSHTI 2023–2030, do të arrihet përmes një sistemi monitorimi dhe vlerësimi për të verifikuar progresin në plotësimin ose jo të objektivave specifikë dhe masave të vendosura në Planin e Veprimit. I gjithë procesi i monitorimit dhe vlerësimit do të menaxhohet përmes Komitetit Drejtues Sektorial për Strategjinë Kombëtare të Kërkimit Shkencor, Teknologjisë dhe Inovacionit 2023–2030, siç parashikohet në urdhrin e Kryeministrit nr. 157, datë 22.10.2018, “Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale dhe krijimin, dhe funksionimin e një mekanizmi të integruar sektorial/ndërsektorial”.

Komiteti Drejtues për Strategjinë e Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit do të operojë përmes grupeve tematike të cilat do të jenë pjesë e Grupit për Menaxhimin e Integruar të Politikave për sektorin e shkencës dhe arsimit, dhe institucionet e tjera pjesëmarrëse, si dhe nëpërmjet Sekretariatit Teknik i cili do të formalizohet me urdher të ministrit Arsimit dhe Sportit.

Raportet e monitorimit do të hartohen në bashkëpunim me të gjitha institucionet e përfshira, si dhe do të diskutohen në grupet tematike të krijuara për këtë qëllim sipas objektivave specifikë të SKKSHTI 2023–2030 dhe më pas miratohen në Komitetin Drejtues Sektorial për sektorin e shkencës dhe kërkimit shkencor.

Gjithashtu, është dakordësuar që të ngrihet një grup pune midis menaxhimit të nivelit të mesëm nga MAS-i dhe AKKSHI për të diskutuar problematikat dhe pengesat që dalin gjatë zbatimit të SKKSHTI-së dhe gjatë ushtrimit normal të aktiviteteve të institucioneve përkatëse, të cilat kërkojnë një qasje të përbashkët.

Metodologjia e monitorimit

MAS-i do të hartojë raporte gjashtëmuajore dhe vjetore, monitorimi dhe vlerësimi, bazuar në standardet IPSIS, për monitorimin dhe raportimin e dokumenteve strategjike, të cilët do të prodhojnë informacion të nevojshëm dhe në kohë për politikbërësit mbi progresin e zbatimit të masave që janë parashikuar në Planin e Veprimit të SKKSHTI-së për çdo vit. Gjithashtu, do të parashikohet dhe një monitorim afatmesëm për zbatimin në fund të vitit 2027. Plani i veprimit të dokumentit strategjik, duke marrë në konsideratë shkallën e mobilizimit të burimeve financiare për zbatimin e tij, do të rishikohet çdo 2–3 vjet për të siguruar në këtë mënyrë një vlerësim real për zbatimin e tij.

MAS-i do të përdorë metodologjinë e monitorimit të bazuar në standardet IPSIS, që do të përcaktojnë se si do të kryhet procesi i monitorimit dhe vlerësimit, me qëllim krijimin e një sistemi efektiv, të unifikuar dhe sistematik të raportimit të të dhënave të të gjithë institucioneve të përfshira në zbatimin e sistemit IPSIS. Sipas këtij dokumenti strategjik, secili institucion raporton mbi nivelin e zbatimit të secilit objektiv dhe masë, mbi buxhetin e alokuar, problemet e hasura dhe vlerësimin e progresit të strategjisë në përgjithësi. Për monitorimin e zbatimit të angazhimeve të ndërmarra, në lidhje me zbatimin e masave, procesi i monitorimit do të realizohet në nivel objektiv. Verifikimi i të dhënave të raportuara realizohet pjesërisht *online* për të garantuar saktësinë e tyre. Përpunimi statistikor i të dhënave kryhet me anë të shifrimit të përgjigjeve sipas raporteve të marrë. Këto raporte janë kryesisht të karakterit narrativ, por edhe statistikor duke përdorur indikatorë të performancës.

Në përputhje me procedurat që do të ndiqen për raportimin dhe monitorimin, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 290, datë 11.4.2020, “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të sistemit informatik të planifikimit të integruar



(SIPI/IPSIS)”, për përgatitjen e raporteve të monitorimit do të ndiqen fazat e mëposhtme:

Faza 1. Marrja e të gjithë kontributeve nga institucionet raportuese dhe konsolidimi i paketës, në përputhje me standardet e sistemit (të rishikohet raportin).

Faza 2. Dërgimi i paketës së plotë për vlerësim në SASPAC në Kryeministri, në përputhje me standardet e sistemit. Paketa e plotë do të duhet të përfshijë materialet e mëposhtme:

2.1 Raportprogresin e konsoliduar, në përputhje me standardet e sistemit dhe metodologjinë e SASPAC.

2.2 Planin e zbatueshmërisë së masave për periudhën referuese, në përputhje me standardet e sistemit dhe metodologjinë e SASPAC.

2.3 Pasaportën e Indikatorëve, në përputhje me standardet e sistemit për periudhën referuese, në përputhje me të gjithë indikatorët e pasaportës për reformën në administratën publike.

2.4 Bazën e të dhënave për vitin referues në zbatim të indikatorëve të pasaportës.

Faza 3: Konsolidimi i paketës pas marrjes dhe reflektimit të komenteve të sjella nga SASPAC në Kryeministri.

Faza 4: Organizimi i mbledhjes së KDS-së për konsultimin e paketës së konsoliduar dhe marrjen e komenteve nga aktorët.

Faza 5: Reflektimi i komenteve dhe finalizimi i paketës së Raportit të Monitorimit.

Faza 6: Publikimi i raportit vjetor.

Faza 7: Dërgimi i procedurave (shënimet e takimit, konkluzionet operacionale) të mbledhjes së KDS-së dhe paketa finale, së bashku me *link*-un për njohjen e Departamentit të Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes në Kryeministri.

PJESA V – PLANI I VEPRIMIT DHE VLERËSIMET FINANCIARE

Plani i detajuar i veprimit është bashkangjitur si aneks i këtij dokumenti strategjik, është hartuar në përputhje me metodologjinë e sistemit IPSIS. Gjithashtu, kostimi i planit të veprimit është bërë sipas metodologjisë së kostimit të integruar në sistemin IPSIS dhe buxhetet e detajuara japin ndarjen e duhur për programet buxhetore, edhe sipas institucioneve.

Kjo pjesë e Strategjisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor, Teknologjisë dhe Inovacionit 2023–2030 përmban informacion në lidhje me financimin e këtij dokumenti, duke e specifikuar sipas financimit që

nevojitet për secilin nga qëllimet, në mënyrë që të realizohen secili prej tyre. Vlen të theksohet se në kostimin e masave, objektivave dhe qëllimeve të strategjisë është ndjekur metodologjia sipas standardeve IPSIS dhe nuk ka dublikim masash me strategji të tjera kombëtare sektoriale apo ndërsektoriale. Në pjesën *Korniza ligjore dhe institucionale, arrijtjet dhe mësimet e nxjerra*, nënçështja e tretë jep lidhjen e strategjive të tjera sektoriale, duke identifikuar qëllimet e politikës/objektivat specifikë/masat e përfshira në këto strategji që ndikojnë drejtpërdrejtë edhe në realizimin e qëllimeve të SKKSHTI 2023–2030. Gjithashtu, një element tjetër që është e vështirë, për momentin, të kostohet saktë është pikërisht sasia e investimeve në teknologji dhe inovacion, që realizojnë bizneset që zhvillojnë veprimtarinë e tyre në vend. Duke mbledhur të gjithë informacionin mund të merret buxheti i plotë.

Fillimisht jepet shpërndarja e burimeve sipas qëllimeve të politikës, si dhe nevojat e paplotësuara me financim ose hendeuku financiar për secilin nga qëllimet. Burimet e financimit të hendeikut financiar të çdo qëllimi janë buxheti i shtetit, donatorët nëpërmjet granteve apo edhe fonde të tjera të asistencës teknike.

Siç edhe është përmendur më lart, strategjia ka 3 qëllime politike dhe MAS-i është institucioni përgjegjës për të koordinuar veprimet dhe për të bërë të lehtësuara veprimet dhe mundur që masat e parashikuara në strategji të realizohen me sukses.

Për sa i përket hendeikut të financimit, pjesa më e madhe e tij përbëhet nga shpenzimet trajnime, studim i situatës për një çështje të caktuar, shpërndarje informacioni, platforma *online* apo edhe ndryshim strukture të AKKSHI-t.

Kostoja totale e strategjisë për të tetë vitet është **29,373,746,090** lekë dhe hendeuku financiar është 28.8%. Hendeuku financiar në total është - **8,457,937,512** lekë. Në grafikun e mëposhtëm jepet hendeuku financiar për secilin nga qëllimet e politikës.

Nëse analizohet hendeuku financiar sipas qëllimeve vihet re se për qëllimin e parë ai kap vlerën 5,035,396,847 lekë, për qëllimin e dytë kap vlerën 3,387,380,677 lekë dhe për qëllimin e tretë kap vlerën 35,159,988 lekë. Pra, qëllimi i parë që lidhet edhe me ngritjen e kapaciteteve kap vlerën më të lartë të hendeikut të financimit. Qëllimi i tretë kap vlerën më të vogël të financimit.

NEVOJAT PËR SHPENZIME KAPITALE DHE SHPENZIME KORENTE

Identifikimi i shpenzimeve korente dhe shpenzimeve kapitale bëhet i mundur pas përcaktimit të kuadrit strategjik, pra të qëllimeve, objektivave specifike dhe masave të strategjisë. Tre qëllimet e politikës për të cilat janë identifikuar edhe shpenzimet përkatëse janë:


1. Rritja e efikasitetit dhe qëndrueshmërisë së sistemit për mbështetjen e kërkimit shkencor, të integruar në nivel ndërkombëtar, në të gjithë spektrin e fushave të shkencave natyrore,

inxhinierike dhe teknologjike, mjekësore, bujqësore, sociale dhe humane;

2. Krijimi i një mjedisi që lehtëson dhe inkurajon mekanizmat e ndërveprimit dhe transferimit të teknologjive për bashkëpunim midis komunitetit të kërkimit, ekonomisë, inovacionit dhe institucioneve publike;

3. Promovimi i kulturës së shkencës dhe inovacionit në edukim për të siguruar një qasje didaktike me theksin në praktikat kërkimore dhe projektet.

Grafiku 1. Burimet e financimit




Pjesa më e madhe e financimit me rreth 40% të kostove mbulohet nga buxheti i shtetit dhe lidhet me pagat, investimet kapitale dhe grantet që qeveria jep nëpërmjet AKKSHI-t fondet për *startup*-et, politikë që zbatohet nga ministri i Shtetit për Mbështetjen e Sipërmarrjes, fonde të thirrjeve të bëra nga AIDA në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, fonde të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës apo edhe fonde që mbështesin iniciativë si zgjerimi i njohurive për kodimin. 11% financohet nga donatorët si EU, AADF, madje edhe fonde të organizatave si Vodafone etj., dhe 28.8% janë kosto të pambuluara dhe pjesa tjetër me rreth 20% janë fonde të të tretëve, në këtë rast janë fondet e universiteteve të cilat përdoren për kërkim shkencor.

Hendeku financiar përbëhet kryesisht nga shpenzimet për krijimin e portaleve apo sistemeve interaktive që mundësojnë lidhjen e kërkuesve shkencorë dhe gjithashtu, pasjen e të gjitha të dhënave në lidhje me infrastrukturën, burimet njerëzore apo edhe mundësitë në Shqipëri për kërkim shkencor dhe inovacion. Gjithashtu, të pambuluara janë studimet e situatës aktuale, ngritje kapacitetesh të institucioneve që merren dhe janë përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e politikave të kërkimit shkencor, teknologjisë dhe inovacionit, dhe investimet që duhen kryer për të pasur infrastrukturën e duhur për të nxitur ndërveprimin *quadruple helix*.

Bazuar në klasifikimin ekonomik, 20% e kostos totale përbëhet nga shpenzimet korente dhe 80% përbëhet nga shpenzimet kapitale.


Grafiku 2. Përbërja e kostos totale bazuar tek klasifikimi ekonomik



Pjesa më e madhe e shpenzimeve korente përbëhet nga shpenzimet e tjera korente. Pjesa tjetër janë pagat dhe shpenzimet e punonjësve të AKKSHI-t, MAS-it, ASHSH-së, apo punonjësve të institucioneve të tjera buxhetore.

Duke pasur parasysh se në strategji janë paraqitur tre qëllime politike, më poshtë jepet kostoja për secilin nga këto qëllime

Grafiku 3. Kosto sipas qëllimeve



Tek dy nga të tre qëllimet shpenzimet kapitale zënë një peshë të madhe. Kjo vjen si pasojë e financimit të projekteve që bëhet nga institucionet shtetërore apo edhe ato të huaja.

Kostot e realizimit të qëllimit të parë janë ato që zënë peshën më të madhe me 72% të kostove totale. Kostot për realizimin e qëllimit të dytë zënë rreth 23% të kostove totale. Ndërkohë kostot e realizimit të qëllimit të tretë zënë 5% të kostove totale.

Për sa i përket alokimit të fondeve sipas viteve, mund të thuhet se tendenca është rritëse.


Tabela 11: Alokimi i fondeve sipas viteve (në lekë)

	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030	Total
Qëllimi i Politikës I: Rritja e efikasitetit dhe qëndrueshmërisë së sistemit për mbështetjen e kërkimit shkencor, të integruar në nivel ndërkombëtar, në të gjithë spektrin e fushave të shkencave natyrore, inxhinierike dhe teknologjike, mjekësore, bujqësore, sociale dhe humane	1257432063	2042956176	2106190807	2979839573	3146436910	3252717710	3447587710	3442757710	21,675,918,658
Qëllimi i Politikës II: Krijimi i një mjedisi që lehtëson dhe inkurajon mekanizmat e ndërveprimit dhe transferimit të teknologjive për bashkëpunim midis komunitetit të kërkimit, ekonomisë, inovacionit dhe institucioneve publike	324638988.9	284334549.2	588293821	875470888.3	866668499.4	967159730.5	1167223499	1364958499	6,438,748,476
Qëllimi i politikës 3 – Promovimi i kulturës së shkencës dhe inovacionit në edukim për të siguruar një qasje didaktike me theksin në praktikën kërkimore dhe projektet.	394215958.4	394171032.4	395946612.4	17184588.26	14390191.2	14390191.2	14390191.2	14390191.2	1,259,078,956
Total	1,976,287,011	2,721,461,758	3,090,431,240	3,872,495,049	4,027,495,600	4,234,267,631	4,629,201,400	4,822,106,400	29,373,746,090

Siç vihet re edhe nga tabela, edhe sipas prioritetit të shpallur, synohet financimi më i lartë i kërkimit shkencor, inovacionit dhe teknologjisë, me synimin e arritjes së buxhetit sa 1% e PBB-së së Shqipërisë.


Për sa i përket burimeve të financimit, të tre qëllimet kanë financim të brendshëm dhe financim të huaj. Ndërkohë tek qëllimi i parë përfshihet edhe financimi i kërkimit shkencor që bëhet nga vetë universitetet.

Grafiku 4. Burimi i financimit



Për të tre qëllimet e politikës janë identifikuar në total 10 objektiva specifike. Grafiku i mëposhtëm jep peshën që zë çdo objektiv në koston totale të llogaritur për strategjinë.

Grafiku 5. Peshë e objektivave specifike në koston totale të strategjisë





Siç shihet edhe nga grafiku, objektivi 1.2 dhe objektivi 2.4 kanë peshën më të madhe të shpenzimeve totale, me përkatësisht 71% dhe 15%. Objektivi 1.2 është i lidhur drejtpërdrejtë me zhvillimin e kapaciteteve njerëzore dhe infrastrukturës mbështetëse të kërkimit shkencor dhe përfshin edhe mbështetjen e shtetit dhe donatorëve, dhe objektivi 2.4, që ka të bëjë fuqizimin dhe rritjen e kapaciteteve të qendrave të transferimit të teknologjisë për të avancuar njohuritë në një fushë të caktuar ose për të zhvilluar më tej teknologjinë. Objektivi 2.2 dhe objektivi 3.2 kanë peshat më të vogla me 0.26% dhe 0.08%.

Nëse analizohen fondet që duhen për të realizuar secilin qëllim të politikës, duke u bazuar tek pesha që kanë objektivat tek qëllimi, vihet re se për qëllimin e parë, të tre objektivat kanë financim të huaj dhe objektivi i dytë ka vlerën më të lartë të këtij financimi. Ky objektiv ka gjithashtu edhe hendekun më të lartë ndër tre objektivat e qëllimit të parë.

Tek objektivi i parë janë përmbledhur të gjitha masat ligjore dhe rregullatore që bëjnë të mundur që sistemi të përmirësohet dhe të arrihet rritja e standardeve të kërkimit shkencor, dhe rregullimi i mëtejshëm i tij. Mbështetja e donatorëve është e ndjeshme dhe e dukshme tek objektivi i dytë që lidhet me zhvillimin e kapaciteteve njerëzore, dhe infrastrukturës mbështetëse, ku janë planifikuar një sërë masash për të dy këto lloje kapacitetesh. Të tre objektivat kanë hendek financiar që pritet të mbulohet kryesisht me mbështetjen e donatorëve dhe më pak me mbështetjen e buxhetit të shtetit.

Ndërkohë, nëse analizohet financimi i objektivave të qëllimit të dytë, mund të thuhet se për tre nga katër objektivat e qëllimit nuk ka financim nga donatorët. Objektivi i parë ka vlerën më të lartë të financimit nga donatorët. Te këta objektiva vihet fokusi te fuqizimi i qendrave të transferimit të teknologjisë dhe rritjes së kapaciteteve për transferimin ndërkombëtar të teknologjive.

Për sa i përket hendekut financiar, hendekun e financimit më të lartë e ka objektivi i katërt që përfshin rritjen e kapaciteteve për të avancuar njohuritë në një fushë të caktuar ose për të zhvilluar më tej teknologjinë. Gjithashtu, objektivi i parë, realizimi i të cilit do të çonte në rritjen e bashkëpunimit mes katër aktorëve, ka hendek financiar të lartë.

Te qëllimi i tretë përfshihen objektivat, realizimi i të cilëve do të ndihmonte përhapjen e informacionit, njohurive dhe inovacionit, jo vetëm te katër aktorët e përmendur tek qëllimi i dytë por edhe tek arsimi parauniversitar. Në dy nga tri objektivat, financimi i huaj është i lartë dhe lidhet drejtpërdrejtë me mbështetjen që ka dhënë AADF-ja dhe Vodafone për zhvillimin e aftësive për kërkim shkencor dhe teknologji edhe në arsimin parauniversitar.

Në këtë qëllim, përfshihen masat për të përfshirë TIK-un në klasat e para dhe pastaj më tutje edhe në klasat e II dhe III dhe me radhë, Gjithashtu, parashikohet rritje e kapaciteteve të mësuesve dhe përmirësim i ndjeshëm i infrastrukturës dhe laboratorëve që përdoren për STEM-in dhe *smart labs*.



ANEKS 1

PLANI I VEPRIMIT I KOSTUAR

	Qëllimi i politikës I: Rritja e efikasitetit dhe qëndrueshmërisë së sistemit për mbështetjen e kërkimit shkencor, të integruar në nivel ndërkombëtar, në të gjithë spektrin e fushave të shkencave natyrore, inxhinierike dhe teknologjike, mjekësore, bujqësore, sociale dhe humane											
Nr.	Titulli	Institucionet përgjegjëse		Periodha e zbatimit		Kostoja indikative						
		Institucioni drejtues	Institucionet pjesëmarrëse	Data e fillimit	Data e mbarimit						Të tjerë (buxheti i institucioneve)	Hendeku financiar
						Korente	Kapitale	Total kosto	Total BSH	Total FH		
1.1	I. Objektivi specifik: Plotësimi dhe zbatimi i kuadrit ligjor dhe rregullator për të garantuar cilësinë, etikën dhe efektivitetin në zhvillimin dhe aplikimin e kërkimit në përputhje me fushat prioritare	MAS, AKKSHI, AKSHI	AKKSHI, IAL, ASCAL, RASH, ASHSH, ML, AKSHI	2023	2030							
1.1.1	1.1.1 Miratimi i ligjit të ri "Për shkencën në Republikën e Shqipërisë"	MAS	AKKSHI, IAL, - ASCAL, ASHSH, ML	2023	2023	2,028,830	0	2,028,830	2,028,831	0	0	1
1.1.2	1.1.2 Miratimi i paketës së akteve nënligjore në zbatim të ligjit të ri "Për shkencën në Republikën e Shqipërisë"	MAS	AKKSHI, ASHSH, IAL, ML	2024	2024	2,612,986	0	2,612,986	2,612,986	0	0	0
1.1.3	1.1.3 Zhvillimi i fushatave sensibilizuese për ligjin "Për shkencën në Republikën e Shqipërisë".	MAS	AKKSHI, IAL, ML	2024	2024	69,969	0	69,969	69,969	0	0	0
1.1.4	1.1.4 Krijimi i një strukture koordinuese kombëtare për politikën mbi shkencën, teknologjinë dhe inovacionin	MAS	ML, ASHSH, AKKSHI AKSHI	2025	2025	1,670,925	0	1,670,925	95,928	0	0	-1,574,997
1.1.5	1.1.5 Hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore lidhur me Statusin e Kërkuarit Shkencor	MAS	AKKSHI, ASHSH, RASH, IAL, ML	2024	2025	1,797,700	0	1,797,700	1,797,700	0	0	0
1.1.6	1.1.6 Hartimi dhe miratimi i Kodit të Etikës në Kërkimin Shkencor	MAS	AKKSHI,ASHSH, ML	2024	2025	1,540,445	0	1,540,445	1,540,445	0	0	0
1.1.7	1.1.7 Hartimi i kritereve dhe treguesve për vlerësimin e kërkimit shkencor dhe renditja e IAL-ve sipas performancës në kërkimin shkencor	MAS	AKKSHI,ASHSH, ML	2026	2030	3,764,555	0	3,764,555	3,764,575	0	0	20
1.1.8	1.1.8 Rishikimi i akteve ligjore në kuadër të kapitullit 25 të BE-së "Shkenca dhe kërkimi shkencor"	MAS	AKKSHI, RASH, IAL, ASHSH, ML	2023	2030	57,724,232	0	57,724,232	16,024,232	1,700,000	40,000,000	0
1.1.9	1.1.9 Rishikimi i kuadrit rregullator përfshirë atë institucional për kërkimin shkencor, në kuadër të detyrimeve që burojnë nga procesi i asociimit në BE, lidhur me kapitullin 25 të BE-së "Shkenca dhe kërkimi shkencor"	MAS	AKKSHI, ASHSH, ML	2023	2030	32,989,757	0	32,989,757	1,189,756	31,800,000	0	-1
1.1.10	1.1.10 Përmirësimi i akteve normative lidhur me përcaktimin e fushave priontare të kërkimit shkencor	MAS	AKKSHI, IAL, ML	2023	2030	11,872,020	0	11,872,020	11,272,024	0	0	-599,996



1.1.11	1.1.11 Hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore që garantojnë aksesin në publikime të kërkuesve shkencorë të vendit për të qenë në linjë me strategjitë e <i>Open Access</i> që zbatohen në nivel evropian	AKKSHI, AKSHI	MAS, ASHSH, RASH, IAL	2024	2025	7,384,591	0	7,384,591	6,664,592	0	0	-719,999
1.1.12	1.1.12 Hartimi i një plani kombëtar për promovimin e barazisë gjinore në shkencë, teknologji dhe inovacion	MAS	AKKSHI, IAL	2023	2030	20,064,000	0	20,064,000	0	2,400,000	0	-17,664,000
1.1.13	1.1.13 Miratimi dhe vënia në zbatim (funktionalizimi) i rregullores për krijimin e regjistrin kombëtar të revistave dhe periudikëve shkencorë, dhe për përcaktimin e kriterëve që duhet të plotësojnë revistat dhe periudikët shkencorë për t'u regjistruar në regjistrin kombëtar të Republikës së Shqipërisë.	MAS	IAL, AKKSHI, ASHSH, AKSHI	2023	2030	8,067,877	5,200,000	13,267,877	10,726,236	0	0	-2,541,641
Kostoja e objektivit specifik 1.1						151,587,887	5,200,000	156,787,887	57,787,274	35,900,000	40,000,000	-23,100,613
1.2	Objektivi specifik 2: Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore dhe infrastrukturës mbështetëse të kërkimit shkencor (infrastrukturës akademike) për rritjen e performancës në programet kombëtare dhe ndërkombëtare	MAS, AKKSHI, RASH	IAL, Institutet kërkimore pranë ML, AMSHC, MAS, AKFAL, RASH, ASHSH, ML, AKD	2023	2030							
1.2.1	1.2.1 Ngritja e kapaciteteve për shkrimin e projekteve kombëtare shkencore, në mënyrë që përmbytja dhe arrijtjet e tyre të kontribuojnë në cilësinë, rëndësinë dhe efektivitetin e kërkimit dhe përmbytjen e qëllimeve strategjike në fushat prioritare	AKKSHI	MAS, IAL, MM Institutet kërkimore pranë ML	2023	2030	30,500,000	80,000,000	110,500,000	103,180,000	0	0	-7,320,000
1.2.2	1.2.2 Organizimi i ditëve informative dhe i aktiviteteve promovuese për thirrjet e projekteve në programe ndërkombëtare	AKKSHI	IAL, Institutet kërkimore pranë ML, AMSHC	2023	2030	8,064,000	0	8,064,000	5,760,000	0	0	-2,304,000
1.2.3	1.2.3 Trajnimi i stafëve akademike lidhur me aplikimin në programe ndërkombëtare	MAS	AKKSHI	2023	2030	14,981,069	0	14,981,069	12,823,438	0	0	-2,157,631
1.2.4	1.2.4 Ngritja dhe forcimi i qendrave kombëtare shkencore të ekselencës që integrojnë studiues dhe burime kërkimore në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar	AKKSHI	MAS, IAL, ASHSH	2023	2030	101,669,040	16,450,000,000	16,551,669,040	2,950,000,000	2,830,000,000	5,900,000,000	-4,871,669,040
1.2.5	1.2.5 Krijimi i Hartës Kombëtare të Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor në Shqipëri, në përputhje me ESFRI (<i>European Strategic Framework of Research Infrastructure</i>)	AKKSHI	MAS, AKFAL	2024	2026	3,663,813	50,000,000	53,663,813	2,463,813	0	0	-51,200,000
1.2.6	1.2.6 Forcimi i sistemit të shkencës dhe kërkimit shkencor përmes bashkëpunimit në nivel ndërkombëtar	AKKSHI	MAS, IAL, ASHSH, AKD, ML	2023	2030	608,902,400	0	608,902,400	608,902,400	0	0	0
1.2.7	1.2.7 Krijimi i rrjeteve të kërkuesve shkencorë brenda dhe jashtë Shqipërisë	AKKSHI	RASH, ASHSH, AKD	2023	2030	10,560,000	0	10,560,000	4,700,000	0	0	-5,860,000
1.2.8	1.2.8 Krijimi dhe përditësimi periodik i databazës së kërkuesve shkencorë	RASH	IAL, AKKSHI, ASHSH	2024	2030	5,180,000	0	5,180,000	740,000	0	0	-4,440,000
1.2.9	1.2.9 Rritja e mbështetjes financiare për aplikimin në projekte kombëtare	AKKSHI	AKFAL, MK, ASHSH, AMSHC	2023	2030	4,005,201,563	6,325,000	4,011,526,563	4,001,241,560	0	0	-10,285,003
1.2.10	1.2.10 Forcimi i kapaciteteve të pikave kombëtare të kontaktit (programi <i>Horizon</i>)	AKKSHI /	MAS, ASHSH	2023	2030	9,840,000	0	9,840,000	0	0	0	-9,840,000



1.2.11	1.2.11 Zhvillimi i platformës (online) të të dhënave për kërkimin shkencor në RSH, në lidhje me kapacitetet njerëzore, infrastrukturë, biblioteka dhe arkivat	MAS, RASH	AKKSHI, IAL, MK, ASHSHI, AKD, AKSHI	2026	2030	10,489,200	12,000,000	22,489,200	0	0	0	-22,489,200
	Kostoja e objektivit specifik 1.2					4,809,051,084	16,598,325,000	21,407,376,084	7,689,811,211	2,830,000,000	5,900,000,000	-4,987,564,873
1.3	Objektivi specifik 3: Përmirësimi i mbledhjes, përpunimit, interpretimit dhe publikimi i treguesve statistikorë dhe të tjerë të kërkimit, zhvillimit të teknologjisë dhe inovacionit	INSTAT, AKKSHI, ASPA	MAS, AKKSHI, institucionet e kërkimit shkencor, IAL, AKFAL, ML, INSTAT	2023	2030							
1.3.1	1.3.1 Hartimi i metodologjisë së mbledhjes së të dhënave statistikore në fushën e kërkimit shkencor	INSTAT	MAS, AKKSHI, Institucionet e kërkimit shkencor, IAL, MK	2023	2023	488,915	0	488,915	488,915	0	0	0
1.3.2	1.3.2 Hartimi dhe publikimi i të dhënave për kërkimin shkencor sipas periodicitetit të përcaktuar në Programin e Statistikave Zyrtare 2022–2026	INSTAT	MAS, AKKSHI	2023	2030	83,029,716	16,150,000	99,179,716	83,029,716	1,750,000	0	-14,400,000
1.3.3	1.3.3 Hartimi dhe publikimi i buletinit të përvitshëm për kërkimin shkencor	AKKSHI	MAS	2023	2030	1,071,423	0	1,071,423	1,071,416	0	0	-7
1.3.4	1.3.4 Zhvillimi i kapaciteteve të stafit të MAS-it, AKKSHI-t dhe instituteve të tjera kërkimore për mbledhjen, analizën dhe raportimin e standardizuar të statistikave për kërkimin shkencor sipas standardeve ndërkombëtare (Eurostat, OECD)	ASPA	INSTAT, AKFAL, ML	2024	2030	7,675,200	0	7,675,200	0	0	0	-7,675,200
1.3.5	1.3.5 Hartimi i treguesve të performancës mbi kërkimin shkencor, me qëllim krahasimin në nivel evropian dhe ndërkombëtar	AKKSHI	MAS, IAL	2025	2030	3,339,434	0	3,339,434	683,279	0	0	-2,656,155
	Kostoja e objektivit specifik 1.3					95,604,687	16,150,000	111,754,687	85,273,326	1,750,000	0	-24,731,361
	Kostoja totale e qëllimit të politikës I (objektiva specifike 1.1+1.2+1.3)					5,056,243,658	16,619,675,000	21,675,918,658	7,832,871,811	2,867,650,000	5,940,000,000	-5,035,396,847



Qëllimi i politikës II: Krijimi i një mjedisi që lehtëson dhe inkurajon mekanizmat e ndërveprimit dhe transferimit të teknologjive për bashkëpunim midis komunitetit të kërkimit, ekonomisë, inovacionit dhe institucioneve publike											
Nr.	Titulli	Institucionet përgjegjëse		Periudha e zbatimit		Kostoja indikative					
		Institucioni drejtues	Institucionet pjesëmarrëse	Data e fillimit	Data e mbarimit						
						Korente	Kapitale	Total kosto	Total BSH	Total FH	Te tjerë (buxheti i institucioneve)
2.1	Objektivi specifik 1: Rritja e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë, institucioneve të pushtetit qendror dhe pushtetit vendor, sektorit të biznesit dhe shoqërisë civile, nëpërmjet zgjerimit të kërkimit dhe zhvillimit të projekteve të përbashkëta (<i>Quadruple Helix Model</i>)	MAS, MFE, AKKSHI,	MAS, AIDA, IAL, ML, NJQV, AKSHI, AKKSHI	2023	2030						
2.1.1	2.1.1 Krijimi i skemave novatore për bashkëfinancimin e programeve të kërkimit shkencor që forcojnë bashkëpunimin me sektorin e biznesit për zgjidhjen e sfidave aktuale shoqërore	MFE	MAS, AIDA, Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Supërmarrjes	2023	2030	0	1,776,000,000	1,776,000,000	1,076,000,000	0	0
2.1.2	2.1.2 Informimi dhe njohja e të gjitha grupeve të interesit me mekanizmat dhe instrumentet e financimit	AKKSHI	MFE, MAS, AIDA, IAL	2023	2030	8,639,852	0	8,639,852	5,503,908	0	0
2.1.3	2.1.3 Promovimi i modeleve të kërkimit shkencor në pjesëmarrjen e projekteve të përbashkëta (<i>Quadruple Helix model</i>)	AKKSHI	MAS, ML	2023	2030	7,960,190	0	7,960,190	2,081,376	0	0
2.1.4	2.1.4 Hartimi i udhëzuesve (që përfshijnë protokollet dhe procedurat) për projekte të përbashkëta	AKKSHI	MAS	2023	2024	1,680,000	0	1,680,000	0	0	0
2.1.5	2.1.5 Forcimi i kapaciteteve të IAL-ve, përfaqësuesve të biznesit, institucioneve qendrore dhe vendore për hartimin e projekteve të përbashkëta	AKKSHI	MAS, IAL, AIDA, ML, NJQV, AKSHI	2025	2030	13,082,924	0	13,082,924	185,291	0	0
2.1.6	2.1.6 Fuqizimi i kapaciteteve të strukturave të vlerësimit të projekteve të kërkimit shkencor me qëllim përfaqësimin e biznesit në këto struktura	MAS	AKKSHI	2025	2030	2,974,462	0	2,974,462	382,462	0	0
	Kostoja e objektivit specifik 2.1					34,337,428	1,776,000,000	1,810,337,428	1,084,153,037	0	0
2.2	2.2 Objektivi specifik 2: Përmirësimi i mekanizmave dhe rritja e mbështetjes së transferimit ndërkombëtar të teknologjisë (TNT)	DPPI, AKKSHI, MFE	MAS, IAL ML, AKKSHI	2023	2030						
2.2.1	2.2.1 Plotësimi i bazës ligjore të nevojshme për transferimin ndërkombëtar të teknologjive (TNT)	DPPI	MAS, MFE, ML, AKKSHI	2023	2030	34,812,246	0	34,812,246	33,577,444	0	0
2.2.2	2.2.2 Fuqizimi i kapaciteteve të IAL-ve për transferimin ndërkombëtar të teknologjisë	AKKSHI	MFE, MAS, MBZHR, IAL MSHMS	2025	2030	3,390,803	0	3,390,803	1,149,202	0	0
2.2.3	2.2.3 Zhvillimi i infrastrukturave të reja që mundësojnë transferimin ndërkombëtar të teknologjive	MFE	MAS, MBZHR, IAL MSHMS	2026	2030	25,084,665	29,894,200	54,978,865	0	29,342,200	0
2.2.4	2.2.4 Promovimi i programeve ndërkombëtare që mbështesin transferimin e teknologjisë dhe njohja e të gjitha grupeve të interesit me mekanizmat, instrumentet e financimit/mbështetjes së transferimit ndërkombëtar të teknologjisë	AKKSHI	MAS, IAL, ML	2024	2030	3,803,101	0	3,803,101	464,100	0	0
2.2.5	2.2.5 Hartimi i udhëzuesve (që përfshijnë protokollet dhe procedurat) për hartimin e projekteve të përbashkëta	AKKSHI	MAS	2026	2030	1,320,000	0	1,320,000	0	0	0
	Kostoja e objektivit specifik 2.2					68,410,816	29,894,200	98,305,016	35,190,746	29,342,200	0



2.3	2.3 Objektivi specifik 3: Rritja e rolit të shkencës dhe inovacionit në zhvillimin teknologjik	AKKSHI, AKFAL, MFE	MAS, DPPI, IAL ML AKSHI	2023	2030							
2.3.1	2.3.1 Hartimi i një udhëzuesi (guide) për lëvrimin e granteve për financimin e programeve kombëtare të kërkim-zhvillimit dhe inovacionit	AKKSHI, AKFAL	MAS	2024	0	1,067,294	0	1,067,294	1,067,294	0	0	0
2.3.2	2.3.2 Promovimi i projekteve shkencore me ndikim në inovacion dhe zhvillimin teknologjik	AKKSHI	DPPI, IAL, - ML	2023	2030	3,155,616	361,364,126	364,519,742	362,205,290	0	0	-2,314,452
2.3.3	2.3.3 Vlerësim i nevojave për zhvillimet teknologji/inovacion, me qëllim orientimin e projekteve kombëtare	AKKSHI	DPPI, IAL, - MAS, AKSHI, ML	2026	2030	2,689,194	0	2,689,194	0	0	0	-2,689,194
2.3.4	2.3.4 Hartimi i projekteve për krijimin e qendrave rajonale të teknologjisë dhe inovacionit, me qëllim mbështetjen e zhvillimit teknologjik	MFE,	IAL, ML, MFE, AKSHI	2026	2030	29,027,274	0	29,027,274	28,307,274	0	0	-720,000
	Kostoja e objektivit specifik 2.3					35,939,379	361,364,126	397,303,505	391,579,858	0	0	-5,723,647
2.4	2.4 Objektivi specifik 4: Fuqizimi dhe rritja e kapaciteteve të qendrave të transferimit të teknologjisë për të avancuar njohuritë në një fushë të caktuar ose për të zhvilluar më tej teknologjinë	MBZHR, AKKSHI, ML	MAS, DPPI, IAL, institute kërkimore, ML, QTT	2023	2030							
2.4.1	2.4.1 Plotësimi i bazës ligjore për mirëfunksionimin e qendrave të transferimit të teknologjisë	MBZHR, ML	IAL, MAS DPPI, institute kërkimore jashtë, ML, QTT	2023	2030	15,289,711	0	15,289,711	15,289,704	0	0	-7
2.4.2	2.4.2 Fuqizimi i marrëdhënieve midis QTT-së dhe akademisë	AKKSHI	IAL, ML, QTT	2023	2030	480,000	4,037,890,000	4,038,370,000	1,419,676,000	0	0	-2,618,694,000
2.4.3	2.4.3 Rritja e kapaciteteve të punonjësve të QTT-së mbi shkëmbimin e projekteve	AKKSHI	ML, , QTT	2024	2030	4,483,908	0	4,483,908	2,253,348	0	0	-2,230,560
2.4.4	2.4.4. Nxitja bashkëpunimit midis QTT-së dhe IAL-ve përmes projekteve të përbashkëta	AKKSHI	IAL, ML, QTT	2024	2030	4,658,908	70,000,000	74,658,908	73,882,906	0	0	-776,002
	Kostoja e objektivit specifik 2.4					24,912,527	4,107,890,000	4,132,802,527	1,511,101,958	0	0	-2,621,700,569
	Kostoja totale e qëllimit të politikës II (objektiva specifike 2.1+2.2+2.3+2.4)					163,600,150	6,275,148,326	6,438,748,476	3,022,025,599	29,342,200	0	-3,387,380,677
	Qëllimi i politikës 3 – Promovimi i kulturës së shkencës dhe inovacionit në edukim për të siguruar një qasje didaktike me theksin në praktikat kërkimore dhe projektet.											
Nr.	Titulli	Institucionet përgjegjëse		Periudha e zbatimit		Kostoja indikative						
		Institucioni drejtues	Institucionet pjesëmarrëse	Data e fillimit	Data e mbarimit							Hendeku financiar
						Korente	Kapitale	Total kosto	Total BSH	Total FH	Të tjerë (buxheti i institucioneve)	
3.1	3.1 Objektivi specifik 3.1 Reformimi i kurrikulës së shkencës në arsimin parauniversitar duke përfshirë STEM-in në edukim.	MAS	AKKSHI, ASCAP, MFE	2023	2030							
3.1.1	3.1.1 Identifikimi i praktikave ndërkombëtare në drejtim të nishimit të kurrikulave për përfshirjen e STEM-it në edukim	MAS	AKKSHI, ASCAP	2023	2030	724,420	0	724,420	4,420	0	0	-720,000
3.1.2	3.1.2 Përgatitja e stafit pedagogjik, lidhur me realizimin e praktikave kërkimore dhe zhvillimin e projekteve kërkimore në sistemin parauniversitar	MAS	AKKSHI	2023	2030	6,162,455	0	6,162,455	2,062,457	0	0	-4,099,998



3.1.3	3.1.3 Promovimi dhe përfshirja e orëve jashtëkurrikulare në arsimin parauniversitar mbi STEM-in	MAS	AKKSHI, MFE	2023	2030	26,397,401	0	26,397,401	25,721,000	0	0	-676,401
3.1.4	3.1.4 Përmirësimi i laboratorëve për zhvillimin e lëndëve STEM	MAS	MFE, ASCAP	2023	2025	0	362,951,472	362,951,472	240,000,000	122,951,472	0	0
	Kostoja e objektivit specifik 3.1					33,284,276	362,951,472	396,235,748	267,787,877	122,951,472	0	-5,496,399
3.2	3.2 Objektivi specifik 2: Sensibilizimi në të gjithë nivelet e edukimit parauniversitar, për fuqizimin e rolit të të rinjve në kërkim dhe inovacion	MAS, ASCAP	AKKSHI, MFE, NJQV, DPPI, ASCAP	2023	2030							
3.2.1	3.2.1 Angazhimi i vazhdueshëm për minimimin e nxënësve të klasave të 9-ta dhe nxënësit/nxënëset e gimnazëve për mundësitë që vijnë nga përfshirja në kërkim dhe inovacion	MAS	AKKSHI, MFE, NJQV, DPPI, ASCAP	2023	2030	6,948,808	0	6,948,808	4,675,214	0	0	-2,273,594
3.2.2	3.2.2 Promovimi dhe përfshirja e orëve/kurseve/aktiviteteve jashtëkurrikulare për inovacionin në sistemin parauniversitar	ASCAP	MAS	2023	2030	16,389,061	0	16,389,061	2,059,060	0	0	-14,330,001
	Kostoja e objektivit specifik 3.2					23,337,869	0	23,337,869	6,734,274	0	0	-16,603,595
3.3	3.3 Objektivi specifik 3: Zhvillimi i kompetencës digjitale	MAS, AKSHI, ASCAP	MAS, ASCAP	2023	2030							
3.3.1	3.3.1 Përmirësimi i kurrikulës, futja e TIK-ut në klasën e parë	ASCAP	MAS	2023	2030	68,090,389	0	68,090,389	64,590,388	0	0	-3,500,001
3.3.2	3.3.2 Zhvillimi i kompetencave digjitale të mësuesve përmes trajnimeve	ASCAP	MAS	2023	2030	12,905,804	0	12,905,804	3,345,805	0	0	-9,559,999
3.3.3	3.3.3 Përmirësimi i infrastrukturës, <i>smart lab</i> -eve dhe pajisjeve të tjera të nevojshme	MAS, AKSHI	ASCAP	2023	2030	1,359,147	757,150,000	758,509,147	545,359,152	213,150,000	0	5
	Kostoja e objektivit specifik 3.3					82,355,339	757,150,000	839,505,339	613,295,345	213,150,000	0	-13,059,994
	Kostoja totale e qëllimit të politikës III (objektivat specifikë 3.1+3.2+3.3)					136,777,484	1,120,101,472	1,256,878,956	887,817,496	336,101,472	0	-35,159,988
	Kostoja totale e Planit të Veprimit = QP I + QP II + QP III					5,358,821,292	24,014,924,798	29,373,746,090	11,742,714,906	3,233,093,672	5,940,000,000	-8,457,937,512



ANEKS 2

TREGUESIT E MONITORIMIT TË DOKUMENTIT TË STRATEGJISË

Treguesit e Monitorimit të SKKSHTI-së do të bazohen në përdorimin e një numri treguesish kryesorë të performancës, në lidhje me qëllimet e politikës dhe objektivat specifike të planit të veprimit, siç pasqyrohen në këtë të fundit. Progresi i zbatimit të SKKSHTI-së do të monitorohet dhe vlerësohet duke matur periodikisht treguesit, të cilët janë vendosur në përputhje me qëllimet dhe objektivat e politikës përkatëse. Më poshtë, tabela e treguesve kryesorë të performancës sipas tre qëllimeve të politikës të SKKSHTI-së.

Tabela: Treguesit e Monitorimit të SKKSHTI 2023–2030

Nr.	Treguesit	Vlera bazë	Vlera e synuar 2030	Burimi i verifikimit
Qëllimi i politikës 1: Rritja e efikasitetit dhe qëndrueshmërisë së sistemit për mbështetjen e kërkimit shkencor, të integruar në nivel ndërkombëtar, në të gjithë spektrin e fushave të shkencave natyrore, inxhinierike dhe teknologjike, mjekësore, bujqësore, sociale dhe humane				
1.	Indeksi evropian i inovacionit/permanca e Shqipërisë në EU <i>Innovation Scoreboard</i>	2022 41.7/160	78/160	Raporti vjetor i Komisionit Evropian “Rezultatet Evropiane të Inovacionit” <i>European Innovation Scoreboard</i>
2.	Përqindja e buxhetit të shtetit dedikuar për kërkimin shkencor	2022 0.3%	1%	Raportet e MFE-së/MAS-it
Objektivi specifik 1.1	Plotësimi dhe zbatimi i kuadrit ligjor dhe rregullator për të garantuar cilësinë, etikën dhe efektivitetin në zhvillimin dhe aplikimin e kërkimit në përputhje me fushat prioritare			
1.1a	Ligji “Për shkencën në Republikën e Shqipërisë”, i përfunduar dhe miratuar	2022 Ligji jo i miratuar	Ligji i përfunduar dhe miratuar	Raportet e MAS-it
1.1b	Struktura Kombëtare e Koordinimit të Politikave mbi SHTI e ngritur dhe funksionale	2022 Struktura jo e ngritur	Struktura mbi koordinimin e politikave mbi SHTI funksionale	Raportet e MAS-it
1.1c	Kuadri ligjor dhe rregullator mbi shkencën, teknologjinë dhe inovacionin, i harmonizuar dhe në përputhje me direktivat dhe rregulloret e BE-së, në kuadër të kapitullit 25 “Shkenca dhe kërkimi shkencor”	2022 Hartimi i tabelave të përputhshmërisë	Kuadri ligjor dhe rregullator mbi SHTI i harmonizuar dhe në përputhje me direktivat dhe rregulloret e BE-së	Raportet e MAS-it
1.1e	Kodi i Etikës në kërkimin shkencor i hartuar dhe miratuar	2022 Kodi i Etikës në kërkimin shkencor jo i hartuar	Kodi i Etikës, i miratuar dhe në fuqi	Raportet e MAS-it, AKKSHI-it
1.1f	Paketa e akteve nënligjore, lidhur me ligjin “Për shkencën në Republikën e Shqipërisë”, e finalizuar dhe miratuar	2022 Paketa e akteve nënligjore jo e hartuar	Paketa e akteve nënligjore e finalizuar dhe miratuar	Raportet e MAS-it
1.1g	Plani kombëtar për promovimin e barazisë gjinore në shkencë, teknologji dhe inovacion, i hartuar dhe miratuar	2022 Plani kombëtar për promovimin e barazisë gjinore në shkencë, teknologji dhe inovacion, jo i hartuar	Plani Kombëtar për Promovimin e Barazisë Gjinore në SHTI i miratuar dhe në fuqi	Raportet e MAS-it
Objektivi specifik 1.2	Përmirësimi i kapaciteteve njerëzore dhe infrastrukturës mbështetëse të kërkimit shkencor për rritjen e performancës në programet kombëtare dhe ndërkombëtare			
1.2 a	Përqindja e kërkuesve shkencorë të trajnuar mbi shkrimin dhe	2022 -	Trend rritës	Raportet e AKKSHI-it



	aplikimin në projekte kombëtare/ndërkombëtare			
1.2 b	Përqindja e grave dhe vajzave drejtuese të projekteve shkencore kombëtare të kërkimit	2021 55%	Trend rritës	Raportet e AKKSHI-it
1.2 c	Harta Kombëtare e Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor në Shqipëri e krijuar në përputhje me ESFRI (<i>European Strategic Framework of Research Infrastructure</i>)	2022 Harta jo e krijuar	Harta Kombëtare e Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor, e krijuar në përputhje me ESFRI	Raportet e MAS-it
1.2.c	Përqindja e personelit akademik të IAL-ve trajnuar lidhur me aplikimin në programe ndërkombëtare	2022 -	Trend rritës 5% mbi vitin paraardhës	Raportet e AKKSHI-it
1.2.d	Numri i kërkuesve shqiptarë që kanë përfituar nga programet e shkëmbimit/mobilitetit në kërkim	2022 -	Trend rritës 5% mbi vitin paraardhës	Raportet e AKKSHI-it
Objektivi specifik 1.3	Përmirësimi i mbledhjes, përpunimit, interpretimit dhe publikimi i treguesve statistikorë dhe të tjerë të kërkimit, zhvillimit të teknologjisë dhe inovacionit			
1.3 a	Metodologjia e mbledhjes së të dhënave statistikore në fushën e kërkimit shkencor, e hartuar dhe miratuar	2022 Metodologjia jo e hartuar	Metodologjia e miratuar dhe në fuqi	Raportet e MAS-it, INSTAT-it
1.3 b	Përqindja e stafit të MAS-it, AKKSHI-t të trajnuar mbi mbledhjen, analizën dhe raportimin e standardizuar të statistikave për kërkimin shkencor	2022 -/-	90%	Raportet e MAS-it, ASPA-s
Qëllimi i politikës 2: Krijimi i një mjedisi që lehtëson dhe inkurajon mekanizmat e ndërveprimit dhe transferimit të teknologjive për bashkëpunim midis komunitetit të kërkimit, ekonomisë, inovacionit dhe institucioneve publike				
2.1.b	Përqindja e projekteve të përbashkëta sipas modelit <i>Quadruple Helix</i> financiar nga AKKSHI	2022 -	50%	Raportet e AKKSHI-it
2.1.c	Përqindja e personelit akademik të trajnuar mbi hartimin e projekteve të përbashkëta (<i>Quadruple Helix</i>)	2022 -	90%	Raportet e AKKSHI-it, IAL-së
2.1.d	Përqindja e fondeve të AKKSHI-t dedikuar për garantët e përbashkët të komunitetit të kërkuesve shkencor-biznes	2022 -		Raportet e AKKSHI-it
Objektivi specifik 2.3	Rritja e rolit të shkencës dhe inovacionit në zhvillimin teknologjik			
2.3.a	Përqindja e projekteve shkencore me ndikim në inovacion dhe zhvillimin teknologjik financiar nga AKKSHI	2022 -		Raportet e AKKSHI-it
Objektiv Specifik 2.4	Fuqizimi dhe rritja e kapaciteteve të qendrave të transferimit të teknologjisë për të avancuar njohuritë në një fushë të caktuar ose për të zhvilluar më tej teknologjinë			
2.4.a	Numri i qendrave të transferimit të teknologjisë, të ngritura çdo vit	6	Trend rritës	ML-së
2.4.b	Përqindja e IAL-ve që kanë nënshkruar marrëveshje	2022 -	70%	IAL-së



	bashkëpunimi me qendrat e transferimit të teknologjisë			
Qëllimi i politikave 3: Promovimi i kulturës së shkencës dhe inovacionit në edukim për të siguruar një qasje didaktike me theksin në praktikën kërkimore dhe projektet				
Objektivi specifik 3.1	Reformimi i kurrikulës së shkencës në arsimin parauniversitar duke përfshirë STEM-in në edukim			
3.1.a	Kurrikula e arsimit parauniversitar e reformuar me qëllim përfshirjen e STEM-it	2021 - Kurrikula jo e reformuar	STEM-i i përfshirë në kurrikulën e arsimit parauniversitar	Raportet e MAS-it
3.1.b	Përqindja e punonjësve të arsimit parauniversitar të trajnuar mbi shkrimin e projekteve kërkimore	2022 -	Trend rritës +5%	Raportet e MAS-it
3.1.c	Numri i fushatave të informimit në nivel të arsimit parauniversitar në fushën e shkencës, teknologjisë dhe inovacionit	2022 -	Trend rritës	Raportet e MAS-it
Objektivi specifik 3.2	Sensibilizimi në të gjitha nivelet e edukimit parauniversitar, për fuqizimin e rolit të të rinjve në kërkim dhe inovacion			
3.2.a	Numri fushatave të ndërgjegjësimit me nxënësit/nxënëset e klasave të 9-ta dhe nxënësit/nxënëset e gjimnazeve për mundësitë që vijnë nga përfshirja në kërkim dhe inovacion	2021 -	5% rritje mbi vitin paraardhës	Të dhënat e MAS-it
Objektivi specifik 3.3	Zhvillimi i kompetencës digjitale			
3.3.a	Përqindja e mësuesve të trajnuar mbi kompetencat digjitale	2022 -	5% rritje mbi vitin paraardhës	Të dhënat e MAS-it

UDHËZIM

Nr. 1, datë 19.9.2023

**PËR DISA NDRYSHIME NË
UDHËZIMIN NR. 4, DATË 31.12.2020,
“MBI KRITERET DHE PROCEDURËN
PËR CERTIFIKIMIN E OPERATORËVE
TË TURIZMIT DETAR”**

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe pikës 3, të nenit 5, të ligjit nr. 43, datë 27.4.2020, “Për aktivitetet e turizmit detar”,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 4, datë 31.12.2020, “Mbi kriteret dhe procedurën për certifikimin e operatorëve të turizmit detar” bëhen këto ndryshime:

1. Shkronja “a” e pikës 2, të kreut III shfuqizohet.

2. Pika 1, e kreut IV ndryshohet si më poshtë:

“Kërkesa me dokumentacionin, sipas kreut 3, pika 2, të këtij udhëzimi depozitohet online, nëpërmjet portalit qeveritar
Faqe | 15876

“e-Albania” dhe shqyrtohet nga Komisioni i Standardizimit të Veprimtarive Turistike.”.

3. Pika 2, e kreut IV ndryshohet si më poshtë:

“Komisioni, brenda 10 ditëve pune nga data e aplikimit dhe ngarkimit të dokumentacionit në portalin qeveritar “e-Albania”, sipas pikës 2, të kreut III, nis shqyrtimin e kërkesës”.

4. Pika 3, e kreut IV, ndryshohet si më poshtë:

“Në qoftë se kërkesa e subjektit për pajisjen me certifikatë nuk është në përputhje me sa parashikohet në pikat 1 deri në 2, të kreut III, Komisioni, brenda 5 ditëve pune nga data e shqyrtimit të kërkesës, njofton aplikuesin nëpërmjet portalit qeveritar “e-Albania, për plotësimin e dokumentacionit ose korrigjimin e pasaktësive dhe i cakton atij një afat prej 7 ditë pune për paraqitjen e dokumentacionit përkatës.”.

5. Pika 5 e kreut IV ndryshohet si më poshtë:

“Në përfundim të procesit të shqyrtimit, Komisioni i Standardizimit merr vendim për lëshimin ose jo të certifikatës “Operator i turizmit detar”. Vendimi i njoftohet kërkuar nëpërmjet portalit qeveritar “e-Albania brenda 5 ditë pune nga data e marrjes së vendimit. Në rastet kur komisioni refuzon kërkesën për pajisje me certifikatë, vendimi duhet të jetë i arsyetuar.”

6. Pika 3, e kreut V ndryshohet si më poshtë:



“Për çdo ndryshim të të dhënave të operatorit të turizmit detar, subjekti është i detyruar, nëpërmjet portalit qeveritar e-Albania, të informojë ministrinë përgjegjëse për turizmin.”

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
Mirela Kumbaro Furxhi

KËRKESË PËR PAJISJEN ME CERTIFIKATË “OPERATOR I TURIZMIT DETAR”

SEKSIONI A	
Informacion mbi përfaqësuesin ligjor	
Emri	
Mbiemri	
Numër personal	
Adresa	
Numër telefoni	
Adresë e-mail	
Informacion mbi subjektin	
Emri tregtar	
NIPT	
Numër licence	
Adresa	
Numër telefoni	
Adresë email	
SEKSIONI B	
Zona e ushtrimit të aktivitetit	
Përshkrimi i aktivitetit / aktiviteve të parashikuara	

SEKSIONI C:

Dokumentacion shoqërues:

- fotokopje të licensës XIII.1.B dhe një kopje e ekstraktit historik të QKR;
- kontratën e vendbazimit (lidhur mes subjektit aplikues dhe subjektit që administron vendbazimin;
- plani i menaxhimit të emergjencave (nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor i subjektit);
- dokumenti që vërteton pronësinë apo kontratën noteriale (lidhur për përdorimin e mjeteve lundruese me qëllim aktivitetin detar);
- lista me të dhënat e mjeteve të lundrimit (në funksion të aktiviteve që do të ofrohen):
 - lloji i mjetit;
 - numri i identifikimit;

- flamuri (për mjetet me flamuj të huaj, një kopje të licensës VII.4.1);
- kapaciteti;
- viti i prodhimit;
- personi përgjegjës;
- numri i kontaktit;
- f) certifikata e sigurisë apo klasës së lëshuar nga shoqëria klasifikuese (sipas legjislacionit në fuqi për mjetet lundruese);
- g) policë sigurimi e mjetit lundrues, të përgjegjësishë ndaj palëve të tretat;
- h) deklarata e nënshkruar (nga subjekti) ku angazhohet të respektojë kriteret e përcaktuara në Kodin e Etikës së Operatorit të Turizmit Detar.



UDHËZIM

Nr. 106, datë 12.9.2023

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN
NR. 10, DATË 20.4.2022, “PËR
PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS,
LLOJIT DHE MËNYRËS PËR DHËNIEN
E SHËRBIMEVE *ONLINE* TË
SHËRBIMIT GJEOLGJIK SHQIPTAR”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të ligjit nr. 111/2015, “Për shërbimin gjeologjik shqiptar”; të vendimit nr. 111, datë 2.3.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë”, të ndryshuar, si dhe në përputhje me urdhrin e Kryeministrit, nr. 153, prot., datë 25.11.2019, “Për marrjen e masave dhe rregullimin e dispozitave ligjore për aplikimin e shërbimeve vetëm *online* nga data 1.1.2020”,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 10, datë 20.4.2022, “Për përcaktimin e procedurës, llojit dhe mënyrës për dhënie e shërbimeve *online* të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar”, të ndryshuar, bëhet ndryshimi si më poshtë:

1. Pika 3, ndryshon si më poshtë:

“3. Kostot për marrjen e shërbimeve të parashikuara në pikën 1 janë specifike, sipas dokumentit gjeologjik të kërkuar, bazuar në tarifat e përcaktuara në udhëzimin e përbashkët me nr. 6, datë 7.3.2023, të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, “Për shërbimet me të tretët që kryhen nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar”, tarifa dhe mënyra e përdorimit të të ardhurave të krijuara nga këto shërbime.”.

2. Ngarkohet Shërbimi Gjeologjik Shqiptar për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
DHE MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku**

URDHËR

Nr. 498, datë 20.9.2023

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje dhe në zbatim të nenit II/b, të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”; të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; si dhe të nenit 11, pikave 2 dhe 3 të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, z. Endrit Musaj, Drejtor i Inspektimit dhe Trajnimeve, për shkak të mungesës me arsye të titullarit të këtij institucioni.

2. Kompetencat e drejtorit të përgjithshëm të Arkivave do të ushtrohen për periudhën nga data 21.9.2023 deri në datën 22.9.2023.

3. Nuk delegohen kompetencat e drejtuesit lidhur me personelin, si dhe kompetencat e tjera të padelegueshme, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

4. Për veprimet e kryera në zbatim të këtij urdhri, drejtori i Inspektimit dhe Trajnimeve do të ruajë kopje të kartelave shoqëruese të praktikave shkresore, të iniciuara apo të përfunduara prej tij, së bashku me afatet e përcaktuara dhe ecurinë e mbarëvajtjes e çështjeve dhe do t’ia bëjë të ditura titullarit me rikthimin e tij në detyrë.

5. Për zbatimin e urdhrit ngarkohet drejtori i Inspektimit dhe Trajnimeve, z. Endri Musaj.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ardit Bido**



VENDIM

Nr. 00-2023-3406 (258), datë 7.7.2023

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me trup gjykues të përbërë nga:

Sokol Sadushi	kryesues;
Asim Vokshi	anëtar;
Arbena Ahmeti	anëtare;
Gentian Medja	anëtar;
Sokol Ngresi	anëtar.

Sot, më datë 7.7.2023, përfundoi së shqyrtuari në seancë gjyqësore publike, çështjen administrative nr. 30002-00151-00-2023, që u përket palëve:

PARASHTRUES: Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë

OBJEKTI: Përcaktimin e kompetencës lëndore midis Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

BAZA LIGJORE: Neni 13, pika 5, i ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

Në çështjen administrative me palë:

PADITËS: Brunilda Gjeçi

TË PADITUR: Drejtoria Rajonale Arsimore e Qarkut Tiranë

Shkolla 9-vjeçare “Mihal Grameno” Tiranë

OBJEKTI: Detyrimin e palës së paditur të dëmshpërblejë paditësen me 12 muaj pagë për zgjidhjen e kontratës së punës në mënyrë të menjëhershme dhe pa shkaqe të arsyeshme. Detyrimin e palës së paditur të dëmshpërblejë paditësen me 2 muaj pagë për mosrespektim të afatit të njoftimit. Detyrimi i palës së paditur të dëmshpërblejë paditësen me 2 muaj pagë mujore për mosrespektim të procedurës së largimit nga puna. Detyrimin e palës së paditur të dëmshpërblejë paditësen për vjetërsi në punë me pagën e një 15 ditëshi për çdo vit pune. Detyrimin e palës së paditur të paguajë shpenzimet gjyqësore.

BAZA LIGJORE: Nenet 12, 21, 143, 144, 145, 146, 149, 153 e 155 të Kodit të Punës, nenet 31, 32, 106, 153, 154 e vijues të Kodit të Procedurës Civile. Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS
SË LARTË

pasi dëgjoi relatimin e gjyqtarës Arbena Ahmeti, shqyrtoi çështjen në seancë gjyqësore publike dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Siç rezulton nga konstatimi i faktit prej gjykatave më të ulëta, paditësja ka ushtruar funksionin e mësueses pranë shkollës 9-vjeçare “Mihal Grameno” dhe fillimisht marrëdhënia juridike e punës është formalizuar me vendimin nr. 12, datë 28.10.2016, nëpërmjet të cilit paditësja Brunilda Gjeçi është emëruar “Mësuese provizore” deri në përfundim të paaftësisë së përkohshme në punë të mësueses E.K. Në kushtet kur paaftësia e përkohshme në punë e mësueses së profilit ka vijuar, paditësja është rimëruar më datë 11.9.2017 si mësuese provizore me kushtin që marrëdhënia punës do të përfundonte kur të përfundonte paaftësia e përkohshme në punë e mësueses E.K.

2. Rezulton se mësuesja e emëruar në profilin anglisht E.K. ka dalë në pension 25.5.2021. Drejtoria Arsimore Rajonale Tiranë, me vendimin nr. 197, datë 8.7.2021, ka vendosur të ndërpresë marrëdhënien e punës me paditësen Brunilda Gjeçi si mësuese zëvendësuese/provizore në shkollën 9-vjeçare “Mihal Grameno” Tiranë, për arsye të mbarimit të afatit provizor të kontratës. Në kontratën e punës së paditëses është bërë shënimi për përfundimin e marrëdhënies së punës më datë 21.7.2021, për shkak të përfundimit të afatit.

3. Pala paditëse ka pretenduar se largimi nga puna si mësuese pranë shkollës 9-vjeçare “Mihal Grameno” përbën zgjidhje të menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës në referim të nenit 155 të Kodit të Punës (në vijim “KP”). Në këto rrethana, më datë 15.12.2021 i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me padinë objekt gjykimi.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 6068, datë 18.11.2022 ka vendosur:

“Shpalljen e moskompetencës lëndore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për gjykimin e çështjes nr. 17713/9192 regj. them, datë regjistrimi 16.12.2021. Dërgimin e çështjes nr. 17713/9192 regj. them, datë



regjistrimi 16.12.2021, gjykatës kompetente që është Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë.”

5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vlerësuar se Kolegji Civil i Gjykatës së lartë ka ndryshuar praktikën e Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2020-297, datë 24.6.2020, sipas së cilës në një çështje analoge që ka të bëjë me mosmarrëveshje të marrëdhënies së punës mes punëmarrësit, arsimtarit (mësues) me punëdhënësin, drejtorinë e shkollës dhe Zyrën Vendore Rajonale Arsimore. Në këtë vendim nga Kolegji vlerësohet se marrëdhënia e punës është në lëndën administrative, duke e vlerësuar aktin e lëvizjes paralele të mësuesit si akt administrativ. Për pasojë sipas Kolegjit Civil duke qenë se për zgjidhjen e mosmarrëveshjes zbatohet ligji i posaçëm nr. 69, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, atëherë në bazë të nenit 7, pika “ç” e ligjit nr. 49/2012, “Për gjykata administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, kompetente për gjykimin e saj është gjykata administrative. Gjykata referuar ndryshimit të praktikës gjyqësore të Gjykatës së Lartë në lidhje me kompetencën lëndore të gjykatës që duhet të shqyrtojë mosmarrëveshjet e marrëdhënieve të punës mes mësuesve dhe drejtorive të shkollave përkatëse, si dhe drejtorive arsimore, e konsideron mosmarrëveshje administrative pasi rregullohet marrëdhënia e punës përmes një rregullimi të posaçëm ligjor (ligji nr. 69, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”).

6. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin e datës 31.1.2023 ka vendosur:

“Të parashtrorë çështjen e konfliktit të kompetencave për çështjen me nr. 5363/1866 akti me palë paditëse Brunilda Gjeçi.”

7. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë vlerëson se paditësja ka referuar në kërkesëpadi edhe ligjin nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Në përcaktimin e kompetencës lëndore i referohet identifikimit të natyrës së mosmarrëveshjes, nëse është e natyrës civile apo administrative. Pra, vetë ligji i posaçëm nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” referon si ligj të zbatueshëm dispozitat e KP-së. Pala paditëse sipas shkakut të padisë ka parashtruar se marrëdhënia e

punës që pretendon se është ndërprerë i referohet kontratës pa afat sipas nenit 151/1 të KP-së pasi në vijim të dy kontratave të njëpasnjëshme, kontrata në vijim të vendimit nr. 12, datë 28.10.2016 dhe kontrata në vijim të vendimit nr. 26, datë 11.9.2017 marrëdhënia e punës ka vazhduar në mënyrë të heshtur. Pala paditëse pretendon se në zbatim të nenit 155 të KP-së, pala e paditur ka ndërprerë marrëdhënien e punës në mënyrë të menjëhershme dhe të pajustificuar. Në këto kushte, Gjykata e Shkallës së Parë Administrative Tiranë çmon se kompetente për shqyrtimin e kësaj çështjeje është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

8. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë, më datë 30.3.2023, pas shqyrtimit të çështjes në dhomë këshillimi, vendosi kalimin e çështjes në seancë gjyqësore me qëllim njësimin e praktikës duke shtruar për njësim pyetjen: *“Cila është gjykata kompetente që gjykon mosmarrëveshjet që lindin nga marrëdhënia e punësimit të mësuesve pranë sistemit arsimor parauniversitar publik në Republikën e Shqipërisë?”*

9. Gjykata e Lartë për shkak të interesit që paraqiste njësimi, bazuar në nenin 62(a)(7) të ligjit nr. 49/2012, kërkoj paraqitjen e mendimit me shkrim nga Avokatura e Shtetit për çështjen ligjore të shtruar për njësim.

10. Avokatura e Shtetit me shkresën nr. 2815, datë 19.5.2023 ka depozituar mendimin me shkrim, në të cilin ka mbajtur qëndrimin se gjykatat kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve që lindin nga marrëdhënia e punësimit të mësuesve janë gjykatat e juridiksionit administrativ. Avokatura e Shtetit, ndër të tjera, ka parashtruar se:

- Referuar ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” dhe udhëzimit nr. 56, datë 12.11.2013, “Për procedurat e emërimit dhe të largimit nga puna të mësuesit në institucionin publik të arsimit parauniversitar” ka një rregullim të posaçëm që i përket marrëdhënies së punës së mësuesve.

- Ndërkohë lidhur me aspekte të cilat nuk janë rregulluar nga ligji nr. 69/2012, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” siç janë dëmshpërblimet që rrjedhin nga konstatimi i paligjshëm i zgjidhjes së marrëdhënies së punës çmojmë se duhet të zbatohen dispozitat e KP-së.

- Fakti që dispozitat e KP-së, zbatohen për të rregulluar zgjidhjen e problemeve që nuk i jep



zgjidhje ligji i posaçëm, nuk bën kompetente gjykatën e juridiksionit të përgjithshëm, për sa kohë që marrëdhënia e punës së punonjësit ka një rregullim të posaçëm.

- Ligji nr. 69/2012, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcakton parimet bazë për strukturën, veprimtarinë dhe qeverisjen e sistemit arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë. Qëllimi i këtij ligji është garantimi i së drejtës kushtetuese për arsimim, sipas kuadrit ligjor përkatës për funksionimin e sistemit arsimor parauniversitar. Fusha e zbatimit të këtij ligji është sistemi arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, përveç aspekteve të strukturës, veprimtarisë dhe qeverisjes së arsimit profesional, që rregullohen me ligj të veçantë. Vlen të theksohet se mësuesi ushtron një funksion publik, ku nga puna e tij përfiton i gjithë publiku, nëpërmjet arsimimit të brezave të rinj.

- Në këtë ligj në kreun IX, gjen rregullim edhe “Statusi i personelit mësues”, duke gjetur rregullim të posaçëm edhe emërimi, shkarkimi i drejtorit të institucionit arsimor, dhe mësuesit, kualifikimi, pranimi dhe largimi nga puna e mësuesit.

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ

A. Mbi nisjen e procedurës së gjyqësorisë

11. Paraprakisht Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (në vijim Kolegji) çmon të nevojshme të sqarojë se më datë 20.3.2023 në Gjykatën e Lartë u regjistrua parashtresa e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për përcaktimin e kompetencës lëndore në rastin objekt gjykimi.

12. Kolegji, më datë 30.3.2023, planifikoi për shqyrtim në dhomë këshillimi çështjen nr. 30002-00151-00-2023 regjistri themeltar, datë regjistrimi 20.3.2023. Kolegji konstatoi se për sa i përket gjykatës kompetente për gjykimin e mosmarrëveshjeve të punësimit për mësuesit, vihen re praktika të ndryshme gjyqësore, në lidhje me faktin nëse gjykimi i tyre i përket gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm apo gjykatave administrative.

13. Kolegji ka identifikuar se në vendimet nr. 31003-01255-00-2018, datë 5.6.2018 dhe nr. 00-2021-718 datë 27.5.2021, ka mbajtur qëndrimin se mosmarrëveshjet mbi zgjidhjen e marrëdhënies së punës të mësuesit përbëjnë mosmarrëveshje civile, të cilat rregullohen nga dispozitat e KP-së, pasi sipas ligjit nr. 39/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në

ligjin nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, marrëdhëniet e punës në administratën publike, në gjykatë ose në prokurori, të cilat bazohen në KP, janë përjashtuar nga kompetenca lëndore e gjykatave administrative nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij ligji. Ligji i posaçëm nr. 69, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, (në vijim “ligji 69/2012”) nuk rregullon marrëdhënien në kuptim të nenit 7, shkronja “ç” të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar. Fakti që parashikohet një pikë e dispozitës e cila përcakton se si emërohet një mësues nuk përbën dhe nuk ka kuptimin e ligjit të posaçëm sipas dispozitës së sipërcituar. Në kuptim të nenit 7, shkronja “ç”, të ligjit 49/2012, i ndryshuar, do të kuptohet si ligj i posaçëm vetëm ai ligj i cili bënë një rregullim të qartë të marrëdhënies së punës, duke filluar nga mënyra e përcaktimit të kriterëve të punësimit, rekrutimit, lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, të drejtat dhe detyrimet e punonjësit, përfitimet përkatëse, masat disiplinore, të drejtën e ankimit dhe organin përkatës i cili ushtron këtë funksion, afatet dhe mënyrën e zgjidhjes së marrëdhënies së punës, si dhe çdo masë apo kriter tjetër që shërben për rregullimin e kësaj marrëdhënie pune. Pra, ky ligj do të quhet i posaçëm në kuptim të nenit 7/ç, të ligjit 49/2012 dhe që nuk referon në KP për rregullime të tjera apo për mënyrën e zgjidhjes së marrëdhënies së punës. Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, parashikon në nenin 60, pika 2, shkronja “a”, se “... Drejtori i institucionit publik largon mësuesit nga institucioni për a) shkelje të dispozitave të Kodit të Punës, të këtij ligji e të akteve të tjera nënligjore”. Pra, po vetë ligji i posaçëm nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, referon si ligj të zbatueshëm dispozitat e KP-së.

14. Ndërsa në vendimet nr. 00-2022-1806, datë 21.7.2022 dhe nr. 00-2023-324, datë 7.2.2023, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka mbajtur qëndrimin se në kuptim të nenit 57, pika 4, të ligjit nr. 69/2012, si dhe aktit nënligjor të dalë në zbatim të tij, në rastin konkret, udhëzimi nr. 38, datë 6.10.2015, i ministrit të Arsimit parashikon një procedurë të hollësishme mbi emërimin dhe, në veçanti, për largimin nga puna të mësuesve, rregulla të cilat duhet të respektohen, si nga punëdhënësi, ashtu edhe nga punëmarrësi. Marrëdhënia e punës me mësuesit gjen rregullim nga ligji i posaçëm nr.



69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe jo nga KP-ja, pasi në ligjin e posaçëm parashikohet, procedura e rekrutimit të mësuesve, e cila kalon në disa faza, ku, midis të tjerave, parashikohet edhe rruga e ankimit për çdo fazë konkurrimi.

15. Gjithashtu, Kolegji konstaton se në Gjykatën e Lartë, në lidhje me objektin e mësipërm, janë paraqitur një numër çështjesh mbi mosmarrëveshjen për kompetencë ndërmjet gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm dhe gjykatave administrative. Rezulton se midis këtyre gjykatave ka qëndrime të ndryshme se cila është gjykata që ka kompetencën lëndore për gjykimin e çështjeve që lidhen me mosmarrëveshjet që lindin nga marrëdhënia e punësimit të mësuesve pranë sistemit arsimor parauniversitar publik në Republikën e Shqipërisë.

16. Në lidhje me sa më sipër, në referim të nenit 62(a)(2) të ligjit nr. 49/2012, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, më datë 30.3.2023, në dhomë këshillimi, vendosi kalimin e çështjes në seancë gjyqësore me qëllim njësimin e praktikës gjyqësore, duke shtruar për njësim pyetjen:

Cila është gjykata kompetente që gjykon mosmarrëveshjet që lindin nga marrëdhënia e punësimit të mësuesve pranë sistemit arsimor parauniversitar publik në Republikën e Shqipërisë?

B. Ligji i zbatueshëm

17. Neni 7(ç) i ligjit nr.49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” (i ndryshuar), parashikon se:

“Gjykatat administrative janë kompetente, për:
[...]

c) mosmarrëveshjet në fushën e marrëdhënieve të punës të nëpunësve civilë, nëpunësve civilë gjyqësorë, nëpunësve civilë të prokurorisë dhe të nëpunësve shtetërorë që sipas ligjit organik kanë një rregullim të posaçëm. Përfshihen nga ky rregull punonjësit në administratën publike, në gjykatë ose prokurori, marrëdhënia e punës e të cilëve bazohet në Kodin e Punës;

[...]”

18. Neni 13 i ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” (i ndryshuar) parashikon:

“1. Moskompetenca lëndore dhe funksionale ngrihet edhe kryesisht në çdo gjendje e shkallë të shqyrtimit.

2. Moskompetenca tokësore mund të ngrihet ose kundërshtohet nga palët vetëm para se të ketë filluar shqyrtimi gjyqësor i provave.

3. Gjykata shpall me vendim moskompetencën e saj për shkaqet e parashikuara në këtë nen dhe urdhëron dërgimin e akteve gjykatës kompetente. Vendimi për shpalljen e moskompetencës dhe vendimi për rrëzimin e kërkesës për shpalljen e moskompetencës ankimohen së bashku me vendimin përfundimtar.

4. Ka mosmarrëveshje për kompetencën, kur dy ose më shumë gjykata, në të njëjtën kohë, marrin ose nuk pranojnë të marrin për shqyrtim të njëjtën çështje administrative.

5. Gjykata, me kërkesë të palëve ose kryesisht, ngre çështjen e mosmarrëveshjes me vendim të arsyetuar, me të cilin i paraqet Gjykatës së Lartë kopjen e akteve të nevojshme për zgjidhjen e saj. Gjykata, që ka dhënë vendimin, njofton menjëherë gjykatën në mosmarrëveshje. Vendimi për ngritjen e mosmarrëveshjes, së bashku me aktet, i dërgohet Gjykatës së Lartë brenda 5 ditëve.

6. Mosmarrëveshjet zgjidhen nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i cili vendos në dhomë këshillimi me 3 gjyqtarë brenda 10 ditëve nga data e marrjes së akteve. Vendimi u njoftohet menjëherë gjykatave në mosmarrëveshje dhe palëve.”

19. Neni 61(1) i Kodit të Procedurës Civile (në vijim “KPC”), parashikon:

“1. Gjykata, kur konstaton se nuk është kompetente për shkak të lëndës, funksionit ose të kompetencës tokësore ekskluzive, sipas neneve 45 dhe 46, të këtij Kodi, kryesisht ose me kërkesë të palëve, vendos moskompetencën e saj dhe i dërgon aktet në gjykatën kompetente.”

20. Neni 64 i KPC-së, parashikon:

“Çështja që dërgohet për shqyrtim nga një gjykatë në një gjykatë tjetër të së njëjtës kategori ose nga një gjykatë më e lartë, duhet të pranohet dhe të shqyrtohet nga gjykata së cilës i dërgohet.

Konfliktet për kompetencë midis gjykatave nuk lejohen, por gjykata ka të drejtë t’ia parashtrijë qëndrimin e saj Gjykatës së Lartë, e cila vendos për rregullimin e kompetencës në dhomë këshillimi, me trup gjykues të përbërë nga 3 gjyqtarë.

Gjykata e Lartë shprehet me vendim të arsyetuar jo më vonë se 30 ditë nga momenti i depozitimit të parashtrësës.

Gjykata e Lartë në vendimin e saj për rregullimin e kompetencës jep udhëzimet e nevojshme për procesin gjyqësor të zhvilluar dhe për vazhdimin e tij nga gjykata që deklarohet kompetente.”

21. Neni 60 i ligjit nr. 69, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), i titulluar “Pranimi dhe largimi nga puna i mësuesit” që bën pjesë në kreun IX të këtij ligji, i cili titullohet “Statusi i personelit mësimor”, parashikon:



“1. Në institucionin arsimor publik, përfshirë dhe atë parashkollor, pranimi dhe emërimi i mësuesit në një vend të lirë pune mbështetet në parimin e meritës dhe të drejtën për zgjedhjen e institucionit arsimor. Emërimi i mësuesit bëhet nga drejtori i institucionit arsimor, sipas renditjes në portalin “Mësues për Shqipërinë”. Procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune, si dhe administrimi i portalit “Mësues për Shqipërinë” përcaktohen me udhëzim të ministrit.

2. Drejtori i institucionit publik largon mësuesin nga institucioni për:

a) shkelje të dispozitave të Kodit të Punës, të këtij ligji e të akteve të tjera nënligjore;

b) shkelje të etikës e të sjelljes në institucion;

c) mosarritje të nxënësve, të përcaktuara në mënyrë objektive, si testimet e drejtorisë së institucionit ose të njësisë arsimore vendore, rezultatet në provimet kombëtare dhe vlerësimi i institucionit përgjegjës për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar.

3. Drejtori i institucionit arsimor publik fillon procedurën e largimit të mësuesit edhe me kërkesë të prindërve dhe vendos largimin pasi konsultohet me përfaqësues të prindërve të institucionit arsimor, sipas procedurave të përcaktuara me udhëzim të ministrit.”

22. Udhëzimi nr. 13, datë 22.5.2019, “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”, në kreun 9, të titulluar “Pezullimi dhe largimi nga puna i mësuesit”, parashikon:

“1. Drejtori i shkollës merr masën e pezullimit ndaj mësuesit kur gjykata vendos ndaj mësuesit masë të sigurimit personal deri në vendimin e formës së prerë.

2. Mësuesit të pezulluar i ndërpriten marrëdhëniet financiare për kohën e pezullimit.

3. Rastet e tjera të pezullimit nga detyra të mësuesit përcaktohen në aktet e tjera nënligjore në fuqi.

4. Largimi i mësuesit nga puna bëhet sipas akteve nënligjore në fuqi.”

23. Udhëzimi nr. 12, datë 10.6.2021, “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”, i cili ka shfuqizuar udhëzimin nr. 13, datë 22.5.2019, (hyrë në fuqi pas datës 16.6.2021), në kreun 10, të titulluar “Pezullimi dhe largimi nga puna i mësuesit” parashikon:

“1. Drejtori i LAP-së merr masën e pezullimit ndaj mësuesit kur ndaj tij gjykata ka vendosur masat e sigurimit personal.

2. Mësuesit të pezulluar i ndërpriten marrëdhëniet financiare për kohën e pezullimit. Masa e pezullimit përfundon me shuarjen e shkaqeve të pezullimit ose të largimit nga detyra. Rastet e tjera të pezullimit nga detyra të mësuesit përcaktohen në aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

3. Mësuesi largohet nga detyra:

a) nëse në fund të procesit gjyqësor dënohet nga gjykata me vendim të formë së prerë me burgim për kryerjen e një vepre penale;

b) nëse në fund të procesit gjyqësor dënohet nga gjykata me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale kundrejt të miturve.

c) nëse është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale që lidhet me institucionet arsimore parauniversitare.

4. Largimi i mësuesit nga puna bëhet sipas procedurave të Kodit të Punës dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.”

24. Kreu 11 i udhëzimit të mësipërm nr. 12, datë 10.6.2021, i titulluar “Ankimi”, parashikon se:

“1. Çdo kandidat ka të drejtën e ankimit për secilën prej fazave të zhvilluara për vendet e lira të punës për pozicionin e mësuesit sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

2. Ankimi i kandidatit protokollohet në institucionin ku bëhet ankimi menjëherë pas shpalljes së vendimeve të komisionit / ve dhe jo më vonë se 3 (tri) ditëpunë pas shpalljes së tyre.

3. Ankimi shqyrtohet nga institucioni në bashkëpunim me komisionin përkatës brenda 5 (pesë) ditëve pune.

4. Vendimi i arritur pas përfundimit të shqyrtimit të ankimit i bëhet i njohur ankuarit me shkrim nga institucioni.

5. Vendimet e institucioneve ankohen tek organi epror sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.”

C. Analiza e çështjes së shtruar për njësim

25. Kolegji, referuar jurisprudencës së Gjykatës së Lartë, vlerëson se kompetenca nuk është gjë tjetër veçse sasia e juridiksionit ose masa e juridiksionit që i është dhënë në ushtrimin e funksioneve të saj çdo gjykate. Kompetenca lëndore përbën një nga parakushtet procedurale me qëllim që gjykata të marrë në shqyrtim themelin e pretendimeve dhe të prapësimeve të palëve. Mungesa e kompetencës lëndore për një forum gjyqësor bën që çdo veprimtari procedurale e kryer prej tij të konsiderohet nul. Shkelja e dispozitave që normojnë këtë lloj kompetence është e tillë që nuk mund të anashkalohet nga gjykata e shkallës së parë që shqyrton çështjen dhe as të vlefësohet nga shkallët



më të larta të pushtetit gjyqësor, edhe sikur çështja të jetë zgjidhur drejt (*shih vendimin nr. 917, datë 11.5.2017, nr. 00-2022- 3905, datë 15.12.2022; nr. 00-2023-2318, datë 22.5.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë*).

26. Kompetenca lëndore është një parakusht procedural, i cili përcakton konceptin e gjykatës së krijuar me ligj. “Gjykata e krijuar me ligj” është pjesë e parimit të procesit të rregullt ligjor të parashikuar edhe nga neni 6(1) i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim KEDNJ). Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (në vijim “GJEDNJ”) në jurisprudencën e saj të konsoliduar ka trajtuar kuptimin e “gjykatës së krijuar me ligj”, duke përcaktuar se në kuadër të procesit të rregullt ligjor gjykatat gjithmonë duhet të jenë të krijuara me ligj. Shprehja “e caktuar me ligj” përfshin bazën ligjore për ekzistencën e gjykatës, pajtueshmërinë e veprimtarisë së gjykatës me normat e veçanta që rregullojnë veprimtarinë e saj, si dhe përbërjen (kompozimin) e gjykatës në çdo rast që ajo merr në shqyrtim. (*Shih GJEDNJ Posokhov v Russia, nr. aplikimi 63486/00, datë 4.6.2003, paragrafi 39; Fatullayev v Azerbaijan nr. aplikimi 40984/07, datë 4.10.2010, paragrafi 144.*) Kjo shprehje pasqyron parimin e shtetit të së drejtës që është pjesë e pandarë e sistemit të mbrojtjes së të drejtave të njeriut parashikuar nga KEDNJ-ja dhe protokollet e saj. (*shih GJEDNJ Jorgic v Germany nr. aplikimi 74613/01, datë 12.7.2007, paragrafi i 64; Richert v Poland, nr. aplikimi 54809/07, datë 25.1.2012, paragrafi 41*). Një organ i pa krijuar me ligj, do të privohej nga legjitimiteti i kërkuar në një shoqëri demokratike për të dëgjuar ankesat e individëve. (*Shih GJEDNJ Lavents v Latvia nr. aplikimi 58422/00 datë 28.2.2003 paragrafi 114; Gorgiladze v Georgia; nr. aplikimi 4313/04 datë 20.10.2009 paragrafi 67; Kontalexis v Greece nr. aplikimi 59000/08 datë 21. 11. 2011 paragrafi 38*).

27. Doktrina dhe jurisprudenca kushtetuese evropiane, ndër vite, kanë përpunuar disa kritere themelore, për të garantuar që shtetasi do të gjykohej nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Para së gjithash, gjykata duhet të jetë e krijuar me ligj, ku të jetë përcaktuar qartë kompetenca lëndore dhe tokësore e saj në shqyrtimin e çështjeve. Me fjalë të tjera, ligji për krijimin e gjykatës duhet t’i paraprijë shqyrtimit të çështjeve konkrete (*shih vendimin nr. 31, datë 5.7.2011 të Gjykatës Kushtetuese*) dhe ky është rregulli i përgjithshëm se si një gjykatë e zakonshme merr juridiksion dhe kompetencë për çështjet.

28. Kolegji vlerëson thelbësore të evidentojë se në kuptim të nenit 6(1) të KEDNJ-së, sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së, në termin “ligj” përfshihet jo vetëm legjislacioni që përcakton krijimin dhe funksionimin (kompetencën) e organeve gjyqësore, por edhe çdo dispozitë ligjore të legjislacionit të brendshëm që, nëse shkelet, do ta shndërronte pjesëmarrjen e një ose më shumë gjyqtarëve në shqyrtimin e një çështje konkrete në një pjesëmarrje të paligjshme. (*Shih GJEDNJ Pandjigidze and others v Georgia nr. aplikimi 30323/02, datë 27.1.2010, paragrafi 104*). Gjithashtu edhe jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese mbi termin “ligj” të përdorur në Kushtetutë dhe në përgjithësi në legjislacion, ka mbajtur qëndrimin se një parashikim i tillë nënkupton një interpretim të gjerë, duke mos përjashtuar, në varësi të formulimit të përdorur, aktet nënligjore. Kjo ka të bëjë me rastet që u përkasin rregullimeve të përgjithshme, që nënkuptojnë përdorimin e termit “ligj”, në kuptim të legjislacionit ose të së drejtës, dhe jo të aktit të organit ligjvënës (Kuvendit). Për të përcaktuar nëse ndodhemi para njërit ose tjetrit variant, rëndësi ka të sqarohet konteksti, nga i cili del qëllimi i normës. Nisur nga konteksti, termi “ligj”, në nenin 17 të Kushtetutës, nuk ka të njëjtin kuptim me atë të përdorur në nenin 18, *barazia para ligjit*. Kjo e fundit identifikohet me të drejtën në përgjithësi, ndërsa e para të referon në kompetencën e një organi të vetëm. Konteksti, në të cilën është përdorur togfjalëshi “vetëm me ligj” nuk lejon të bëhet interpretim i zgjeruar. Kjo edhe për faktin se një interpretim i tillë i normave kushtetuese mund të bëhet vetëm në aspektin pozitiv, kur ky interpretim shkon në favor të mbrojtjes së të drejtave dhe jo e kundërta, si në rastin në shqyrtim. Këtë qëndrim ka mbajtur dhe GJEDNJ-në në praktikën e saj (*shih vendimi Delcourt kundër Belgjikës, datë 17.1.1970*). Koncepti i zgjeruar i termit “ligj” që përdoret në doktrinë, nuk vlen për nenin 17 të Kushtetutës. Togfjalëshi përjashtues “vetëm me ligj”, i përdorur në nenet 11(3) dhe 17 të Kushtetutës, ka të bëjë me kufizime të të drejtave dhe ka kuptim të njëjtë, atë të interpretimit të ngushtë, në dallim nga dispozitat e tjera ku termi “ligj” mund të kuptohet më gjerë. Në këtë përfundim, veç sa u përmend, arrihet edhe duke iu referuar fjalës *vetëm* që përmendin nenet 11(3) e 17 të Kushtetutës. Përdorimi i kësaj fjale nuk është i rastit, por ai është bërë për të treguar se kufizime të tilla nuk mund të vendosen me ndonjë akt tjetër



përveç ligjit. Gjykata Kushtetuese ka çmuar se rregullimi i parashikuar në nenin 17 për kufizimin e të drejtave dhe lirive vetëm me ligj, ka të bëjë edhe me përcaktimin e kompetencës së një organi konkret që në këtë rast është vetëm Kuvendi. Një shprehje e tillë të referon në kompetencën e organit ligjvënës dhe nxjerrja e akteve të tjera për të rregulluar marrëdhënie të tilla, cenon kompetencat e këtij organi (*shih vendimin nr. 20, datë 11.7.2006, vendim nr. 7 datë 27.2.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Duke marrë në konsideratë standardet e vendosura nga jurisprudenca e GJEDNJ-së, jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese mbi interpretimin e normës, si dhe bazuar në interpretimin teleologjik dhe logjik të saj, Kolegji çmon se terminologjia e përdorur në nenin 7, shkronja “ç” të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar ia ka njohur ligjit, në kuptimin e gjerë të tij, të drejtën e parashikimit të dispozitave të posaçme për rregullimin e marrëdhënies juridike. Pra, formulimi i nenit 7, shkronja “ç” të ligjit nr. 49/2012 ka lidhur kompetencën e gjykatave administrative me kushtin e rregullimit të marrëdhënies së punës me ligj organik. Konkretisht, në këtë dispozitë ligjore parashikohet: “ç) mosmarrëveshjet në fushën e marrëdhënieve të punës të nëpunësve civilë, nëpunësve civilë gjyqësorë, nëpunësve civilë të prokurorisë dhe të nëpunësve shtetërorë që sipas ligjit organik kanë një rregullim të posaçëm. Përjashtohen nga ky rregull punonjësit në administratën publike, në gjykatë ose prokurori, marrëdhënia e punës e të cilëve bazohet në Kodin e Punës.”. Vlen të theksohet se pas ndryshimit të vitit 2017, edhe neni 17(1)(g) do të shihet i lidhur me nenin 7(ç) të ligjit nr.49/2012 dhe do të interpretohet sipas kuptimit të këtij neni.

30. Në vijim, pas trajtimit të bërë për kuptimin e termit “ligj” për efekt të parashikimit që bëhet në nenin 7(ç) të ligjit nr. 49/2012, lidhur me rastin objekt gjykimi, Kolegji vlerëson të nevojshme të analizojë natyrën e ligjit nr. 69, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të udhëzimit nr. 13, datë 22.5.2019, “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”, si edhe të udhëzimit nr. 12, datë 10.6.2021, “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”, i cili ka shfuqizuar udhëzimin nr. 13, datë

22.5.2019 (hyrë në fuqi pas datës 16.6.2021), për sa i përket klasifikimit të marrëdhënies së punësimit të mësuesve si “nëpunës shtetërorë që sipas ligjit organik kanë një rregullim të posaçëm”.

31. Neni 7(ç) i ligjit nr. 49/2012 përbëhet nga dy fjali, ku e para vendos rregullin e zbatueshëm dhe e dyta përjashtimin nga ky rregull. Sipas fjalisë së parë të këtij neni, rregulli është se në kompetencën lëndore të gjykatave administrative janë mosmarrëveshjet që lindin në fushën e marrëdhënieve të punës, të:

1) nëpunësve civilë (*rregulluar sipas ligjit nr. 153/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar*);

2) nëpunësve civilë gjyqësorë (*rregulluar me ligjin nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar*);

3) nëpunësit civil të prokurorisë (*rregulluar me ligjin nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar*);

4) nëpunësit shtetërorë që sipas ligjit organik kanë rregullim të posaçëm.

32. Fjalja e dytë përjashton nga rregulli i mësipërm kategorinë e mëposhtme:

1) punonjësit në administratën publike, në gjykatë ose në prokurori, marrëdhënia e punës e të cilëve bazohet në KP.

33. Kolegji vëren se në rastin e dispozitave, si ajo e nenit 7(ç), të ligjit nr. 49/2012, për identifikimin e rregullit të së drejtës që ato përmbajnë, zbatohet teknika e interpretimit e quajtur “Ejusdem Generis” (të të njëjtit lloj dhe natyrë). Sipas kësaj teknike interpretimi, kur fjalë apo fraza të përgjithshme pasojnë një renditje të dy apo më shumë personave, sendeve apo rrethanave specifike, ato (fjalët e përgjithshme) gjejnë zbatim vetëm për personat, sendet apo rrethanat që përfshihen në të njëjtin lloj të përgjithshëm apo klasë me ato që përmenden specifiksht. Pra, për të kuptuar se nga se përbëhet bashkësia e “nëpunësve shtetërorë që sipas ligjit organik kanë rregullim të posaçëm”, nevojitet të gjendet e përbashkëta e tri kategorive specifike të përmendura nga dispozita që janë “nëpunësit civilë”, “nëpunësit civilë gjyqësorë” dhe “nëpunësit civilë të prokurorisë”.

34. Një nga të përbashkëtat e marrëdhënies së punës të kategorive “nëpunës civil”, “nëpunës civil gjyqësor” dhe “nëpunës civil të prokurorisë” është se në të tria rastet ka një ligj organik të veçantë që rregullon marrëdhënien e tyre të punës, në mënyrë më shumë apo më pak të detajuar, si dhe



parashikimin nga këto ligje të rregullimit me akte nënligjore të aspekteve të veçanta të këtyre marrëdhënieve. Pra, e përbashkëta që i vendos të tri këto kategori në një bashkësi, është rregullimi i aspekteve kryesore të marrëdhënies së tyre të punës ekskluzivisht me ligj të veçantë dhe në vijim rregullimi i detajuar i saj me akte nënligjore, të dala në bazë dhe për zbatimin e këtyre ligjeve. Për këtë mjafton të shihet formulimi i neneve 19(9), 22(6), 23(5), 24(5), 25(5), 26(9), 28(6), 48(7), 50(9), 56(5), 59(10) etj., të ligjit nr. 153/2013 “Për nëpunësin civil” (*i ndryshuar*); neneve 34(9), 41(2), 42(10), 43(3), 44(3), 54(7), 57(13), 58(6) etj., të ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; apo neneve 59(2), 73(9), 74(7), 77(14), 78(6), 83(4), 85(11), 86(7), 88(4), 102 etj., të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Dispozitat e mësipërme i kanë deleguar organeve të caktuara të drejtën për rregullimin e detajuar të aspekteve me rëndësi për emërimin, ecurinë në punë, transferimin apo lirin nga detyra të kategorive të ndryshme të nëpunësve sipas ligjeve të veçanta. Pra, rregullimi i marrëdhënies së tyre të punës nuk bëhet vetëm nga ligji, por edhe nga aktet nënligjore, të cilat së bashku përbëjnë kuadrin ligjor të rregullimit të marrëdhënies së punës.

35. Në këtë linjë arsyetimi, Kolegji vlerëson se do të konsiderohen marrëdhënie juridike të rregulluara me ligj organik të posaçëm edhe rastet kur përveç rregullimit pjesor të lëndës me ligj, ky i fundit në zbatim të nenit 118 të Kushtetutës autorizon nxjerrjen e akteve nënligjore që rregullojnë në mënyrë më të detajuar marrëdhënien e punës, duke përcaktuar organin kompetent, çështjet që duhen rregulluar, si dhe parimet në bazë të të cilave nxirren këto akte nënligjore. Ky arsyetim gjen zbatim për sa kohë ligjvënësi (ligji nr. 49/2012) nuk e ka kushtëzuar rregullimin e posaçëm të marrëdhënies së punës “vetëm me ligj”.

36. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë për nxjerrjen e akteve nënligjore, në nenin 118 përcakton: “1. *Aktet nënligjore nxirren në bazë dhe për zbatim të ligjeve nga organet e parashikuara në Kushtetutë* 2. *Ligji duhet të autorizojë nxjerrjen e akteve nënligjore, të përcaktojë organin kompetent, çështjet që duhen rregulluar, si dhe parimet në bazë të të cilave nxirren këto akte*. 3. *Organi i autorizuar me ligj për të nxjerrë akte nënligjore, siç specifikohet në paragrafin 2 të këtij neni, nuk mund t’ia*

delegojë kompetencën e tij një organi tjetër. Kolegji vlerëson se neni 118 i Kushtetutës vendos disa kritere, të cilat, nga njëra anë, e detyrojnë ligjvënësin t’u përmbahet atyre në mënyrë rigoroze dhe, nga ana tjetër, orientojnë dhe kufizojnë pushtetin normativ të organeve të tjera shtetërore në nxjerrjen e akteve nënligjore. Kuvendi, nëse nëpërmjet ligjit autorizon nxjerrjen e akteve nënligjore, duhet të përcaktojë organin kompetent, çështjet që duhen rregulluar, si dhe parimet në bazë të të cilave nxirren këto akte.

37. Konkretisht, neni 60 i ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, ia ka deleguar përcaktimin e procedurave të detajuara për konkurrimin, vlerësimin, si dhe largimin nga detyra të mësuesit, ministrit, duke i njohur këtij të fundit të drejtën për të nxjerrë akte nënligjore (udhëzime). Kolegji çmon se ajo është një dispozitë deleguese, e cila respekton rezervën ligjore relative, si dhe kriteret për nxjerrjen e akteve nënligjore, të sanksionuara në nenin 118 të Kushtetutës. Në këtë dispozitë ligjore të titulluar “*Pranimi dhe largimi nga puna i mësuesit*”, parashikohet: “1. *Në institucionin arsimor publik, për një vend të lirë pune, mësuesi emërohet nga drejtori i institucionit arsimor, me konkurrim të hapur. Në komisionet e vlerësimit marrin pjesë përfaqësues të prindërve. Procedurat e konkurrimin dhe vlerësimit përcaktohen me udhëzim të ministrit*. 2. *Drejtori i institucionit publik largon mësuesin nga institucioni për: a) shkelje të dispozitave të Kodit të Punës, të këtij ligji e të akteve të tjera nënligjore; b) shkelje të etikës e të sjelljes në institucion; c) mosarritje të nxënësve, të përcaktuara në mënyrë objektive, si testimet e drejtorisë së institucionit ose të njësisë arsimore vendore, rezultatet në provimet kombëtare dhe vlerësimi i Inspektoratit Shtetëror të Arsimit*. 3. *Drejtori i institucionit arsimor publik fillon procedurën e largimit të mësuesit edhe me kërkesë të prindërve dhe vendos largimin pasi konsultohet me përfaqësues të prindërve të institucionit arsimor, sipas procedurave të përcaktuara me udhëzim të ministrit*.”. Pra, neni 60 i ligjit nr. 69/2012 ka autorizuar nxjerrjen e akteve nënligjore, ka përcaktuar organin kompetent, si dhe çështjet specifike që duhen rregulluar mbi bazën e primeve kryesore për emërimin dhe largimin nga detyra të mësuesve.

38. Për sa më sipër del në pah qëllimi i ligjvënësit për ta deleguar me akte nënligjore rregullimin e procedurës së pranimin, emërimin, largimit apo lëvizjes paralele të mësuesve, por edhe të procedurës që subjektet duhet të ndjekin pranë këtij organi në sistemin arsimor parauniversitar. Në respektim të këtij delegimi, ministri i Arsimit dhe Sportit ka



nxjerrë udhëzimin nr. 38, datë 6.10.2015, “*Procedurat e lëvizjes paralele, emërimit, dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar*” dhe në vijim, udhëzimin nr. 13, datë 22.5.2019, “*Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”*” (që shfuqizon udhëzimin nr. 38, datë 6.10.2015), si dhe udhëzimin nr. 12, datë 10.6.2021, “*Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”*”, i cili ka shfuqizuar udhëzimin nr. 13, datë 22.5.2019, (hyrë në fuqi pas datës 16.6.2021).

39. Kolegji, duke e analizuar dhe në këndvështrimin e interpretimit evolutiv, vlerëson se udhëzimi nr. 38, datë 6.10.2015, të ministrit të Arsimit, “*Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar*”, përcaktonte rregulla të hollësishme si për emërimin ashtu edhe për largimin nga puna të mësuesve. Në pikën 1, paragrafi 2, dhe 4, parashikonte se, “[...] 2. Në institucionin arsimor publik, për një vend të lirë pune, mësuesi emërohet nga drejtori i institucionit arsimor, me konkurrim të hapur. [...] 4. Kandidatët e interesuar për të ushtruar profesionin e mësuesit marrin pjesë në konkurrimin, i cili zhvillohet në tri faza: a. Konkurrim me dosje. b. Konkurrim nëpërmjet testimit “Mësues për Shqipërinë”. c. Zgjedhje e vendit të punës”. Pika 6 e titulluar “Ankimimi”, parashikonte se “Çdo kandidat ka të drejtën të ankimojë vendimet e komisionit në secilën prej procedurave të zhvilluara për vendet e lira të punës për pozicionin e mësuesit. Ankimimi i kandidatit protokollohet në njësinë arsimore vendore brenda tri ditëve pune nga shpallja e akteve të komisionit. Ankimimet shqyrtohen nga drejtuesi i njësisë arsimore vendore, në bashkëpunim me komisionin përkatës, brenda tri ditëve pune. Vendimi i arritur pas përfundimit të shqyrtimit të ankimit i bëhet i njohur ankimesit me shkrim nga njësinë arsimore vendore. Vendimi i njësisë arsimore mund të ankimohet në MAS”. Gjithashtu, udhëzimi në pikën 8, paragrafët 1 dhe 4, shkronja “j” të tij “Pezullimi dhe largimi i mësuesit nga puna”, parashikonte se: “1. Drejtori i institucionit merr masën e pezullimit ndaj mësuesit, kur ndaj mësuesit zhvillohet një proces penal dhe/ose administrativ. 4. Drejtori i institucionit arsimor fillon procedurat disiplinore të largimit të mësuesit nga institucioni publik i arsimit parauniversitar në rastet e mëposhtme: j) Ka ankim me shkrim nga prindër të nxënësve të atij institucioni.”.

40. Në vijim, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ka nxjerrë udhëzimin nr. 13, datë 22.5.2019, “*Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”*” (udhëzimi në fuqi në kohën e lindjes së mosmarrëveshjes), i cili në kreun 10, pika 4 ka shfuqizuar udhëzimin nr. 38, datë 6.10.2015, të ministrit të Arsimit, “*Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar*”. Megjithatë, vihet re se sërish udhëzimi i ri përmban detajime dhe procedura të hollësishme lidhur me rregullimin e marrëdhënies së punës së mësuesit. Në këtë udhëzim parashikohen procedurat e pranimit, të emërimit në një vend të lirë pune dhe të lëvizjes paralele të mësuesit. Në kreun 1, pikat 2 dhe 3, përcaktohet se: “*Shpallja e vendeve të lira të punës, konkurrimi, renditja e kandidatëve për mësuesit dhe pranimi në një vend të lirë pune realizohen nëpërmjet portalit “Mësues për Shqipërinë”*”. 3. *Procedurat udhëhigen nga parimet e ligjshmërisë e të përgjegjshmërisë, si dhe nga vlerat e profesionalizmit, transparencës, meritës, së drejtës për zgjedhjen e institucionit arsimor, barazisë dhe interesit më të lartë të nxënësve.*” Në vijim, udhëzimi nr. 13, datë 22.5.2019 përmban në kreun 2 një detajim të hollësishëm të procedurës së konkurrimin, e cila zhvillohet me dy faza, vlerësimi me dosje dhe testimi i informatizuar. Drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar krijojnë komisione të posaçme për vlerësimin e dosjeve të kandidatëve sipas parashikimeve në kreun 6. Udhëzimi nr. 13, datë 22.5.2019 përmban një procedurë të hollësishme edhe për lëvizjen paralele të mësuesve, ku dhe për këtë proces parashikon ngritjen e komisioneve të posaçme, konkretisht komisionin e vlerësimit të dosjeve të lëvizjes paralele, sipas përcaktimeve të kreut 7. Gjithashtu, udhëzimi parashikon një shkallë ankimi administrativ në kreun 8, i cili përcakton: “1. Çdo kandidat ka të drejtën e ankimit për vendimet e komisionit në secilën prej procedurave të zhvilluara për vendet e lira të punës për pozicionin e mësuesit sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. 2. Ankimi i kandidatit protokollohet në drejtorinë e institucionit ka bëhet ankimi. Menjëherë pas shpalljes së vendimeve të komisionit/ve dhe jo më vonë se 3 (tri) ditë pune pas shpalljes së tyre. 3. Ankimi/et shqyrtohen nga institucioni në bashkëpunim me komisionin përkatës brenda 5 (pesë) ditëve pune. 4. Vendimi i arritur pas përfundimit të shqyrtimit të ankimit, i bëhet i njohur ankimesit



me shkrim nga institucioni. 5. Vendimet e institucioneve ankimohen tek organi epror, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi”. Ndërsa në kreun 9 parashikohet “Pezullimi dhe largimi nga puna i mësuesit”, si vijon: “1. Drejtori i shkollës merr masën e pezullimit ndaj mësuesit kur gjykata vendos ndaj mësuesit masë të sigurimit personal deri në vendimin e formës së prerë. 2. Mësuesit të pezulluar i ndërpriten marrëdhëniet financiare për kohën e pezullimit. 3. Rastet e tjera të pezullimit nga detyra të mësuesit përcaktohen në aktet e tjera nënligjore në fuqi. 4. Largimi i mësuesit nga puna bëhet sipas akteve nënligjore në fuqi.”

41. Kolegji vlerëson se marrëdhënia e punësimit të mësuesve ka qenë objekt i ndryshimeve të shpeshta të bëra me akte nënligjore, ku nëpërmjet udhëzimeve të reja janë shfuqizuar apo ndryshuar udhëzimet e mëparshme. Në këto kushte, udhëzimi nr. 12, datë 10.6.2021, “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë” ka shfuqizuar udhëzimin nr. 13, datë 22.5.2019, sipërcituar. Në tërësinë e tij ky udhëzim përmban të njëjtat etapa, faza dhe procedura, si udhëzimet e mëparshme, por ajo që vihet re është një detajim dhe shtimi i procedurave mbi konkurrimin, komisionet e vlerësimit, administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”, procedurën e emërimit në detyrë të mësuesit, lëvizjen paralele etj. Vlen për t’u theksuar rregullimi që i bëhet procedurës së pezullimit dhe largimit nga detyra dhe së drejtës së ankimit në kreun 10 dhe 11 të udhëzimit nr. 12, datë 10.6.2021, ku parashikohet se “1. Drejtori i LAP-së merr masën e pezullimit ndaj mësuesit kur ndaj tij gjykata ka vendosur masat e sigurimit personal. 2. Mësuesit të pezulluar i ndërpriten marrëdhëniet financiare për kohën e pezullimit. Masa e pezullimit përfundon me shuarjen e shkaqeve të pezullimit ose të largimit nga detyra. Rastet e tjera të pezullimit nga detyra të mësuesit përcaktohen në aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi. 3. Mësuesi largohet nga detyra: a) Nëse në fund të procesit gjyqësor dënohet nga gjykata me vendim të formës së prerë me burgim për kryerjen e një veprë penale; b) Nëse në fund të procesit gjyqësor dënohet nga gjykata me vendim të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale kundrejt të miturve. c) Nëse është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale që lidhet me institucionet arsimore parauniversitare. 4. Largimi i mësuesit nga puna bëhet sipas procedurave të KP-së dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi”. Kreu 11 “Ankimi”, “1. Çdo kandidat ka të drejtën e ankimit për secilën prej fazave të zhvilluara për vendet e lira

të punës për pozicionin e mësuesit sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. 2. Ankimi i kandidatit protokollohet në institucionin ku bëhet ankimi menjëherë pas shpalljes së vendimeve të komisionit/ve dhe jo më vonë se 3 (tri) ditë pune pas shpalljes së tyre. 3. Ankimi shqyrtohet nga institucioni në bashkëpunim me komisionin përkatës brenda 5 (pesë) ditëve pune. 4. Vendimi i arritur pas përfundimit të shqyrtimit të ankimit i bëhet i njohur ankuesit me shkrim nga institucioni. 5. Vendimet e institucioneve ankohen tek organi epror sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.”

42. Kolegji vlerëson se në kuptim të nenit 57, pika 4, të ligjit nr. 69/2012, si dhe aktit nënligjor të dalë në zbatim të tij, në rastin konkret, udhëzimit nr. 13, datë 22.5.2019, por edhe atij pasardhës me nr. 12, datë 10.6.2021 të ministrit të Arsimit, janë bërë parashikime të hollësishme të procedurës mbi pranimin, emërimin, lëvizjen paralele dhe largimin nga puna të mësuesve, rregulla të cilat duhet të respektohen, si nga punëdhënësi, ashtu edhe nga punëmarrësi në sektorin publik. Përpara se të ushtrojnë profesionin e mësuesit, personat e interesuar duhet që paraprakisht të kenë kryer me sukses praktikën profesionale, të kenë kaluar në provimin e shtetit dhe në vijim të futen në konkurrimin e hapur, i cili kalon në tri faza, ku është parashikuar edhe procedura e ankimit për çdo fazë të konkurrimin. Ndërsa në dispozitat vijuese të ligjit përcaktohet mënyra e përfundimit të marrëdhënieve të punës së mësuesit.

43. Kolegji thekson se për sa kohë, për çdo procedurë e fazë konkurrimi parashikohet e drejta e ankimit administrativ, rrjedhimisht edhe padia në procesin gjyqësor do të duhet të merret në shqyrtim nga gjykata administrative, e cila do të vlerësojë ligjshmërinë e veprimeve/mosveprimeve të organit publik. Ky qëndrim është mbajtur, si nga Kolegji Civil, ashtu dhe nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, të cilët në mënyrë konsistente kanë arsyetuar se në rastet e kundërshtimit të akteve të nxjerra nga institucionet arsimore, kompetente është gjykata administrative të shkallës së parë. Kundërshtimi i vendimmarrjes së një organi publik lidhur me një veprim administrativ individual dhe bazueshmëria e tij në ligj, nuk mund të shqyrtohet nga gjykata civile, sepse mosmarrëveshja është e natyrës administrative dhe ajo çka kërkohet të shqyrtohet është pikërisht nëse ky organ ka vepruar në përputhje me ligjin nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. (shih vendimin



nr. 00-2023-322 datë 7.2.2023, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë; vendimin nr. 00-2022-399 (43), datë 9.2.2022; vendimin nr. 00-2020-297, datë 24.6.2020 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë).

44. Në këto rrethana, Kolegji vlerëson se do të ishte e pakuptimtë që për kundërshtimin e procedurës së ndjekur nga institucioni arsimor për konkurrimin, emërimin apo lëvizjen paralele, një mësues t'i drejtohej gjykatës administrative dhe për largimin nga detyra të investonte gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm. Marrëdhënia e punësimit të mësuesve pranë sistemit arsimor parauniversitar publik në Republikën e Shqipërisë që rregullohet nga ligji nr. 69/2012 dhe udhëzimet e dala në zbatim të tij, mbrojnë një marrëdhënie juridike. Nga kjo marrëdhënie juridike (marrëdhënia e punës) duhet të burojnë të drejta dhe detyrime, të cilat kontrollohen nga i njëjti juridiksion, si në etapat e para të nisjes së saj, ashtu edhe në përfundim. Në të kundërt, copëzimi i kompetencës lëndore sipas fazës së konkurimit apo largimit nga detyra, do të prodhonte procese gjyqësore jo efektive, do të rriste ngarkesën e gjykatave dhe mundësinë për dhënien e vendimeve kontradiktore nga juridiksione të ndryshme.

45. Në lidhje me sa më sipër, Kolegji arrin në përfundimin se marrëdhënia e punës e mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar publik, rregullohet nga ligji organik nr. 69/2012, "Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar), si dhe udhëzimet e ministrit përkatës (nr. 13, datë 22.5.2019, apo udhëzimi nr. 12, datë 10.6.2021), me të cilat janë detajuar rregullat e zbatueshme për marrëdhënien e punës së kësaj kategorie nëpunësish shtetërorë. Për shkak të bazës së mësipërme ligjore, marrëdhënia e punës së mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar publik, është pjesë e bashkësisë së nëpunësve shtetërorë, që sipas ligjit organik, marrëdhënia e tyre e punës ka rregullim të posaçëm. Fakti që ligji nr. 69/2012 nuk ka bërë të njëjtin rregullim të marrëdhënies së punës të mësuesve në sektorin publik, në raport me rregullimin që kanë bërë ligjet nr. 153/2013, 98/2016 apo 97/2016 për nëpunësit civilë, nëpunësit civilë gjyqësorë apo nëpunësit civilë të prokurorisë, nuk e përjashton këtë marrëdhënie nga të klasifikuarit si e rregulluar në mënyrë të posaçme me ligj të veçantë (përfshirë edhe aktet nënligjore të zbatueshme). Përderisa ligji nr. 69/2012, si dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të

tij kanë përcaktuar në mënyrë të detajuar procedurën për konkurrimin, pranimin, emërimin, vlerësimin, lëvizjen paralele, si dhe largimin nga detyra të mësuesit, por edhe procedurën që subjektet duhet të ndjekin pranë organit në sistemin arsimor parauniversitar, Kolegji vlerëson se të gjithë këto elemente e identifikojnë këtë mënyrë të rregullimit ligjor si të posaçëm. Mënyrat e ndryshme të përdorimit të teknikës legjislative, diku me procedura më të detajuara e diku më pak, por që nxjerrin në pah qartësisht të gjithë fazat në të cilat kalon procesi i rekrutimit e deri në largimin nga puna të nëpunësve, apo të procedurave të ankimit, janë një zgjedhje e ligjvënës që nuk zbeh cilësinë e qenies së marrëdhënies së punës si të rregulluar me ligj të posaçëm, konform nenit 7(ç) të ligjit nr. 49/2012.

46. Ndaj, në kuptim të kësaj dispozite, Kolegji vëren se është në kompetencën e gjykatave administrative zgjidhja e mosmarrëveshjeve të punës së nëpunësve shtetëror, mjafton që nëpunësi shtetëror të ushtrojë një funksion publik për të cilin ka një rregullim të posaçëm me një ligj të së drejtës publike dhe marrëdhënia e tij e punës të jetë normuar po nga ky ligj, i cili të ketë autorizuar njëkohësisht rregullimin e mëtejshëm të kësaj marrëdhënie edhe me akte nënligjore. Parashikimi i nenit 60 të ligjit organik nr. 69/2012 (i ndryshuar), si dhe udhëzimet e sipërcituara të ministrit të Arsimit, përmbushin mjaftueshëm kriterin e një rregullimi ligjor të posaçëm të marrëdhënies së punës së mësuesve në sektorin publik të arsimit parauniversitar, pasi nëpërmjet kësaj baze ligjore rregullohen dhe detajohen rregullat e së drejtës që do të duhet të mbahen parasysh në të gjitha hallkat e marrëdhënies së punës së mësuesve, duke filluar nga emërimi, transferimi dhe deri tek largimi i tyre nga puna.

47. Fakti se për aspekte të veçanta të marrëdhënies së punës të kategorive të ndryshme të nëpunësve shtetëror (për të cilat nuk ka rregullim të posaçëm, ligjor ose nënligjor), gjen zbatim edhe KP-ja, nuk do të thotë se këto pushojnë së qeni të rregulluara me ligj të posaçëm, në kuptim të nenit 7(ç) të ligjit nr. 49/2012. KP-ja është *lex generalis*, i cili gjen zbatim për çdo aspekt të marrëdhënies së punës, për të cilën nuk ka rregullim të posaçëm *lex specialis*. P.sh: nëse në ligjin e posaçëm mungojnë dispozita për sigurimin dhe mbrojtjen e shëndetit në punë, atëherë do të gjejnë zbatim rregullat e KP-së,



apo ligjeve të tjera të zbatueshme (sipas rastit). Kjo është parashikuar shprehimisht edhe në nenin 4 të KP-së, kur është parashikuar se:

“Përfshihen nga fusha e zbatimit të këtij Kodi:

- punësimi i personave që rregullohet me ligj të veçantë.

Dispozita të veçanta të këtij Kodi zbatohen edhe ndaj personave, punësimi i të cilëve rregullohet me ligj të veçantë, nëse ligji i veçantë nuk parashikon zgjidhje për probleme të lidhura me marrëdhëniet e punës.”

48. Nga ana tjetër, në interpretim të përjashtimit që parashikon fjalia e dytë e nenit 7(ç) të ligjit nr. 49/2012, i cili përforcon rregullin e trajtuar më sipër, arrihet në përfundimin se nuk është në kompetencën lëndore të gjykatave administrative zgjidhja e mosmarrëveshjeve të punës së punonjësve në administratën publike, në gjykatë ose prokurori, marrëdhënia e punës e të cilëve bazohet në KP. Për të kuptuar se cilën kategori punonjësish përfshin fjalia e dytë e nenit 7(ç), të ligjit nr. 49/2012 na ndihmon interpretimi që iu bë më sipër fjalisë së parë, në lidhje me të përbashkëtat e katër kategorive të nëpunësve, për të cilët ligji i posaçëm ka rregullim të veçantë. E përbashkëta e këtyre katër kategorive është se ato veçohen nga ligjet e posaçme nga kategoria e punonjësve të tjerë që punojnë në të njëjtët institucione, por që nuk ushtrojnë funksione publike të mirëfillta. P.sh.: në nenin 4(1)(d) të ligjit nr. 153/2012 “Për nëpunësin civil” (i ndryshuar) është dhënë përkufizimi si vijon: “d) *“Punonjës administrativ” është punonjësi që kryen veprimtari administrative, sekretarie, mirëmbajtjeje, shërbimi, ruajtjeje dhe nuk ushtron një funksion publik.*” Ndërkohë sipas nenit 2(g) të ligjit nr. 153/2012, punonjësit administrativë përjashtohen nga fusha e zbatimit të këtij ligji, duke u rregulluar marrëdhënia e tyre e punës nga KP-ja. Kësisoj, marrëdhënia e punës e punonjësit administrativ, të punësuar në administratën publike, në ndihmë apo mbështetje të nëpunësve civile, kur marrëdhënia e tyre e punës nuk rregullohet me ligj të veçantë, nuk është në kompetencën lëndore të gjykatave administrative. Ngjashëm në nenin 70, të ligjit nr. 97/2016, janë përcaktuar kategoritë e nëpunësve civilë në prokurori, ndërsa në nenin 71 të këtij ligji është përcaktuar se “*marrëdhënia e punës e punonjësve të tjerë në prokurori rregullohet nga Kodi i Punës.*”. Kjo do të thotë se të gjithë punonjësit e tjerë të prokurorisë, që nuk përfshihen në kategoritë sipas nenit 70, por që marrëdhënia e tyre e punës normohet kryesisht nga KP-ja dhe jo me ligj organik të veçantë, nëse do të

kenë mosmarrëveshje nga marrëdhënia e punës, nuk i përkasin kompetencës lëndore të gjykatave administrative. Edhe ligji nr. 98/2016 ka një rregullim të ngjashëm, ku në nenin 50 të tij përcaktohen kategoritë e nëpunësve civilë gjyqësor, ndërsa në nenin 51 thuhet se “*marrëdhënia e punës e punonjësve të tjerë në gjykatë rregullohet nga Kodi i Punës.*”. Edhe mosmarrëveshjet e këtyre punonjësve në administratën publike, për të cilët ligji organik nuk bën rregullim të posaçëm të marrëdhënies së punës, por referon te KP-ja, nuk do të jenë në kompetencën lëndore të gjykatave administrative.

49. Bazuar në çka u tha më sipër, edhe punonjësit e tjerë në administratën publike të sistemit arsimor parauniversitar publik, për të cilët ligji organik nr. 69, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), si dhe aktet përkatëse, nuk kanë parashikuar rregullim të posaçëm të marrëdhënies së tyre të punës, nuk do të jenë në kompetencën e gjykatave administrative. Ndërsa mësuesit në sektorin arsimor parauniversitar publik, për të cilët ligji i posaçëm dhe aktet nënligjore të dala në bazë e për zbatim të këtij ligji, kanë rregulluar posaçërisht procedurën e konkurrit, pranimit, emërimit, vlerësimit, lëvizjes paralele, si dhe largimit nga detyra të mësuesit, duke parashikuar madje edhe të drejtën e ankimit dhe kompetencën për shqyrtimin e saj. Për fazat paraprake të punësimit, hyjnë në kategorinë e nëpunësve shtetërorë që ushtrojnë një funksion publik, të rregulluar sipas ligjit organik në mënyrë të posaçme, që trajtohen nga gjykatat administrative.

50. Kolegji vlerëson gjithashtu se ligji nr. 69/2012 përcakton parimet bazë për strukturën, veprimtarinë dhe qeverisjen e sistemit arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë duke përfshirë këtu institucionet e arsimit publik dhe ato privat, duke përjashtuar në mënyrë të shprehur aspekte të strukturës, veprimtarisë dhe qeverisjes së arsimit profesional, të cilat rregullohen me ligj të veçantë. Për aspekte të përgjithshme ky ligj është baza dhe shërben si ligj i posaçëm si për institucionet arsimore publike edhe për ato private. Megjithatë, përse i përket aspekteve që normojnë marrëdhënien e punësimit të mësuesit në interpretim sistematik të neneve 42, 55 të ligjit nr. 69/2012, si dhe bazuar në parashikimet eksplicite të nenit 60, Kolegji vlerëson se parashikimet mbi procedurën që duhet të ndjekin mësuesit për pranimin, emërimin, largimin apo lëvizjen paralele janë të detyrueshme vetëm për



mësuesit në institucionet arsimore publike. Për rrjedhojë, për sa kohë udhëzimi nr. 38, datë 6.10.2015, “*Procedurat e lëvizjes paralele, emërimit, dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar*” dhe në vijim, udhëzimi nr. 13, datë 22.5.2019 “*Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”*” (i cili shfuqizon udhëzimin nr. 38, datë 6.10.2015), apo ai i vitit 2021 që shfuqizoi këtë të fundit, janë nxjerrë në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 60 të ligjit 69/2012, ato kanë si fushë zbatimi vetëm rregullimin dhe përcaktimin e procedurave të emërimit, largimit apo lëvizjes paralele të mësuesve të institucioneve arsimore publike.

51. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se ky ligj, pavarësisht se përcakton kriteret bazë të arsimimit apo kualifikimit që duhet të plotësojë një mësues për të ushtruar profesionin e tij në Republikën e Shqipërisë (*si një nga profesionet e rregulluara sipas ligjit të posaçëm*), nuk rregullon aspektet që lidhen me marrëdhënien e punës për mësuesit në institucionet arsimore private, duke e lënë në lirinë kontraktore të privatëve rregullimin e marrëdhënies së punës. Për rrjedhojë nuk mund të konsiderohet se përmban dispozita që të përbëjnë rregullim të posaçëm sipas kërkesave të nenit 7, shkronja “ç”, të ligjit nr. 49/2012, për këtë kategori të punësuarish.

52. Referuar jurisprudencës së deritanishme, Kolegji thekson se për të identifikuar një mosmarrëveshje, si administrative ose jo, duhet që kumulativisht të plotësohen tri kushte. Kriteret që gjykatat duhet të mbajnë parasysh, nëse një mosmarrëveshje është apo jo e natyrës administrative kanë të bëjnë me: a) njëra nga palët në mosmarrëveshje ka natyrën e organit të administratës publike, në kuptim të rregullimit ligjor në fuqi dhe, në kuadër të kryerjes së veprimtarisë të njohur nga ligji, ushtron pushtetin e tij diskrecional ndaj palës tjetër; b) veprimtaria e organit të administratës publike bazohet në një ligj të posaçëm të së drejtës publike dhe vetë marrëdhënia juridike që krijohet në mes palëve buron nga një ligj i së drejtës publike; c) kjo veprimtari e organit të administratës publike, që konkretizohet me nxjerrjen e aktit, duhet të veprojë në drejtim dhe të ketë si bazë interesin publik (*shih vendimin nr. 2, datë*

10.3.2014, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë § 23).

53. Koncepti i marrëdhënieve juridike në fushën e së drejtës publike nënkupton ato marrëdhënie juridike që përfshijnë në mënyrë kumulative ose alternative shumë elemente, siç janë raportet e pabarazisë mes palëve, kryerjen e një misioni shërbimi publik, ushtrimin e prerogativave të fuqisë (pushtetit) publike, si dhe përmbushjen e interesit publik. Kolegji thekson se, të gjithë këto elemente që karakterizojnë të drejtën publike kanë për qëllim përmbushjen e misionit thelbësor të administratës publike, që është misioni i përmbushjes së interesit publik.

54. Kolegji për identifikimin e kuptimit të nenit 7(ç) të ligjit nr. 49/2012 (sipas ndryshimeve me ligjin nr. 39/2017) vlerëson të nevojshme referimin edhe në relacionin shpjegues të Komisionit mbi Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në Kuvend. Gjatë diskutimeve mbi projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 49/2012 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, ndër të tjera përcaktohet se “[...] Është bërë një riformulim i gjuhës “ç” të nenit 7, ku thuhet: “Mosmarrëveshjet në fushën e marrëdhënieve të nëpunësve civilë, nëpunësve civilë gjyqësorë nëpunësve civilë të prokurorisë nëpunësve shtetërorë që sipas ligjit organik kanë një rregullim të posaçëm”, ku përfshihet policia, shërbimet e inteligjencës e të tjerë. “Përfshihen nga ky rregull punonjësit në administratën publike në gjykatë ose në prokurori, marrëdhëniet e të cilëve bazohen në Kodin e Punës [...]”. Siç rezulton dhe nga diskutimet mbi projektligjin në Komision, qëllimi i ndryshimeve ligjore ka qenë përfshirja në kompetencë të gjykatave administrative edhe e punonjësve të tjerë përveç nëpunësve civilë, nëpunësve civilë gjyqësorë dhe nëpunësve civilë të prokurorisë, duke e lënë të hapur mundësinë e interpretimit në varësi të rregullimeve të posaçme që gëzon një marrëdhënie juridike punësimi. Kolegji vlerëson se një parashikim i tillë nuk kushtëzon përfshirjen në kompetencë të gjykatave administrative vetëm të kategorisë së subjekteve që kanë të njëjtën garanci, si nëpunësit civil, të cilët përfitojnë rikthimin në detyrë. Nëse ligjvënësi do kishte pasur këtë qëllim, do kishte lidhur përcaktimin e kompetencës jo me rregullimin e posaçëm në ligjin organik, por me pasojat që do të vinin nga zgjidhja e paligjshme e marrëdhënies së punës (që një nga rastet mund të jetë rikthimin në



detyrë). Ligjvënësi e ka lënë të hapur kategorinë e subjekteve që synon të mbrojë apo t'i japë një garanci më të madhe nëpërmjet parashikimit të nenit 7, shkronja “ç” të ligjit nr. 49/2012, pa dashur të përcaktojë një listë shteruese të tyre, duke e lidhur domosdoshmërisht vetëm me kriterin e ekzistencës së një ligji organik që ka një rregullim të posaçëm. Pikërisht, përcaktimi si i posaçëm i rregullimit ligjor që i bëhet kategorisë së nëpunësve shtetërorë përcakton edhe kompetencën e gjykatës.

55. Kolegji çmon se në rastin objekt gjykimi marrëdhënia e punës së paditëses me palën e paditur në pozicionin e “Mësuese provizore në shkollën 9-vjeçare “Mihal Grameno”, Tiranë, që ka filluar prej vitit 2016, rregullohet nga ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij. Kolegji vlerëson se vendimi nr. 6068, datë 18.11.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që ka shpallur moskompetencën për shqyrtimin e çështjes, është rrjedhojë e zbatimit të drejtë të ligjit dhe si i tillë duhet të lihet në fuqi dhe çështja duhet t'i dërgohet Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për vijimin e shqyrtimit të mosmarrëveshjes. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë (sot Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë) ka kualifikuar drejt natyrën e mosmarrëveshjes, duke individualizuar drejt nga pikëpamja lëndore edhe gjykatën kompetente. Nëse një gjykatë nuk ka juridiksion/kompetencë për të gjykuar çështjen objekt shqyrtimi, në përputhje me dispozitat që zbatohen sipas legjislacionit përkatës nuk mund të kryejë asnjë veprim procedural. Përcaktimi i kompetencës lëndore i referohet identifikimit të natyrës së mosmarrëveshjes, nëse është e natyrës civile apo administrative.

56. Kolegji përcakton se kriter për ndarjen e kompetencës lëndore është natyra juridike e marrëdhënies midis palëve ndërgjyqëse, që në rastin konkret është marrëdhënie punësimi, e cila gjen rregullim primar nga ligji i posaçëm nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe jo nga KP-ja, siç është arsyetuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë. Me ndryshimet e bëra ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, me ligjin nr. 39/2017, konkretisht neni 7, shkronja “ç”, të ligjit nr. 49/2012, konkludohet se për shkak të rregullimit që i bëhet marrëdhënies konkrete me ligj të

posaçëm, kompetencën lëndore për gjykimin e mosmarrëveshje të marrëdhënieve të punës të mësuesve e ka gjykata e juridiksionit të posaçëm administrativ dhe në rastin në gjykim, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë.

57. Vlen të përmendet se në vendimin nr. 00-202-718, datë 27.5.2021, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i është referuar nenit 60, pika 2, shkronja “a”, të ligjit nr. 69/2012, i cili parashikon se “[...] Drejtori i institucionit publik largon mësuesit nga institucioni për a) shkelje të dispozitave të Kodit të Punës, të këtij ligji e të akteve të tjera nënligjore”, por ky përfundim nuk duhet të merret i shkëputur nga rasti konkret që është shqyrtuar. Pavarësisht nga referimi që përdoret për atë rast, formulimi në dispozitën e mësipërme ku përdoret si shkak për largimin e mësuesit “shkelje e dispozitave të Kodit të Punës”, nuk do të thotë se aplikohet procedura e këtij Kodi për mësuesit. Përderisa ka një rregullim me ligj të posaçëm, ku parashikohen shprehimisht kriteret e emërimit apo shkaqet e largimit të mësuesve nga puna me detyrimin për zbatimin e një procedure të hollësishme, atëherë kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve të tyre është gjykata administrative. (shih vendimin nr. 00-2022-1806, datë 21.7.2022, i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë).

58. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se në mbështetje të këtij arsyetimi dhe rregullave të interpretimit të sipërcituara, sipas kuptimit të ndryshimeve ligjore të vitit 2017 në nenin 7(ç), të ligjit nr. 49/2012, dhe parashikimit të posaçëm ligjor dhe nënligjor të procedurave të hollësishme mbi marrëdhënien e punës së mësuesit, mënyrën e konkurrimit, pranimit, emërimit, lëvizjes paralele, pezullimit të mësuesit nga detyra, largimin, të drejtën e ankimit tek organi publik del në pah qartë qëllimi për rregullimin e posaçëm ligjor të kësaj marrëdhënieje punësimi. I gjithë kuadri ligjor që rregullon marrëdhënien e punës së mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar publik në Republikën e Shqipërisë përmbush standardin e kërkuar nga neni 7 shkronja “ç” të ligjit nr. 49/2012, pra përbën ligji organik që ka një rregullim të posaçëm, duke hyrë mosmarrëveshjet e punës në këto raste, në kompetencën lëndore të gjykatave administrative.

Ç. Rregulli i së drejtës për çështjen e shtruar për njësim

59. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, bazuar në arsyetimin e mësipërm, referuar çështjes



së shtruar për njësim, arrin në këtë përfundim njëses:

- Gjykatat kompetente për gjykimin e mosmarrëveshjeve që lindin nga marrëdhënia e punësimit të mësuesve pranë sistemit arsimor parauniversitar publik në Republikën e Shqipërisë janë gjykatat administrative.

D. Në lidhje me zgjidhjen e parashtrimit objekt shqyrtimi

60. Në vështrim të analizës së mësipërme, Kolegji arrin në përfundimin se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me të cilin është shpallur moskompetenca lëndore për gjykimin e çështjes, duhet të lihet në fuqi dhe çështja të dërgohet për shqyrtim pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me të njëjtin trup gjyqësor.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, mbështetur në nenet 13(6), 62/a dhe 63(1)(c)(2) të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Rregullimin e kompetencës lëndore duke përcaktuar si gjykatë kompetente Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë të Tiranë.

2. Lënien në fuqi të vendimit nr. 6068, datë 18.11.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

3. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 7.7.2023

Kryesues: Sokol Sadushi

Anëtarë: Asim Vokshi, Gentian Medja, Sokol Ngresi

Anëtarë (kundër): Arbena Ahmeti

MENDIM I GJYQTARIT TË MBETUR NË PAKICË

Unë, gjyqtare Arbena Ahmeti, me cilësinë e anëtares të trupës gjyqësore dhe njëkohësisht relatore e çështjes jam kundër vendimit të Kolegjit Administrativ (në vijim “Kolegji”) për njësimin e praktikës gjyqësore, në lidhje me rregullimin e kompetencës lëndore midis gjykatave administrative dhe gjykatave të rretheve gjyqësore për gjykimin e mosmarrëveshjeve që lindin nga marrëdhënia e punësimit të mësuesve pranë sistemit arsimor parauniversitar publik në Republikën e Shqipërisë, duke u përcaktuar kompetente Gjykata Administrative. Vlerësoj se, në rregullimin e kompetencës lëndore, Kolegji duhet të kishte disponuar ndryshe, duke përcaktuar si kompetente për nga pikëpamja lëndore gjykatat e rretheve gjyqësore (*aktualisht, me riorganizimin e tyre, të emërtuara Gjykata e Juridiksionit të Përgjithshëm*).

Në zbatim të nenit 1, pg. 2, nenit 7 germa “ç”, nenit 8, germa “b”, nenit 13, pika 6, të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar (referuar edhe si “LGJA”), nenit 42 e vijues të Kodit të Procedurës Civile, nenit 307, pg. 2, neni 308, pg. 1, si dhe nenit 35(3), të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

- Arsyet e votës kundër në këtë gjykim janë, si vijon:

I. Baza juridike për mendimin e mbetur në pakicë

- Ligji nr. 49/2012, i ndryshuar:

Neni 1, “Objekti”⁴⁷

1. Ky ligj përcakton rregulla të detyrueshme, për:

b) juridiksionin dhe kompetencën e gjykatave administrative;

2. Dispozitat e këtij ligji plotësohen me parashikimet e Kodit të Procedurës Civile, me përjashtim të rasteve dhe për aq sa ky ligj nuk parashikon ndryshe.

Neni 7, “Kompetenca lëndore” *para ndryshime të pësuara me ligjin nr. 39/2017*

Gjykatat administrative janë kompetente, për:

ç) mosmarrëveshjet në fushën e marrëdhënieve të punës, kur punëdhënësi është organ i administratës publike;

Neni 7, “Kompetenca lëndore”⁴⁸

⁴⁷ Shfuqizuar germa “a” e pikës 1 me ligjin nr. 39/2017, datë 30.3.2017.

⁴⁸ Ndryshuar germa “ç” me ligjin nr. 39/2017, datë 30.3.2017.



Gjykatat administrative janë kompetente, për:

c) mosmarrëveshjet në fushën e marrëdhënieve të punës të nëpunësve civilë, nëpunësve civilë gjyqësorë, nëpunësve civilë të prokurorisë dhe të nëpunësve shtetërorë që sipas ligjit organik kanë një rregullim të posaçëm. Përfshihen nga ky rregull punonjësit në administratën publike, në gjykatë ose prokurori, marrëdhënia e punës e të cilëve bazohet në Kodin e Punës.

Neni 8 “Mosmarrëveshjet, të cilat nuk shqyrtohen në gjykatën administrative”

Gjykata administrative nuk shqyrton mosmarrëveshjet:

b) shqyrtimi i të cilave, sipas legjislacionit në fuqi, është në kompetencën e një gjykate tjetër.

- *Kodi i Punës*

Neni 4,⁴⁹ që përcakton fushën e zbatimit të tij, *sipas personave*.

Përfshihen nga fusha e zbatimit të këtij Kodi:

- punësimi i personave që rregullohet me ligj të veçantë.

Ky nen, në pg. e dytë gjithashtu, përcakton dhe parimin e zbatimit subsidiar të Kodit të Punës në marrëdhëniet e punës, punësimi i të cilëve rregullohet me ligj të veçantë.

Dispozita të veçanta të këtij Kodi zbatohen edhe ndaj personave, punësimi i të cilëve rregullohet me ligj të veçantë, nëse ligji i veçantë nuk parashikon zgjidhje për probleme të lidhura me marrëdhëniet e punës.

Neni 11,⁵⁰ që përcakton “*Përparësia e normave të së drejtës*”

1. Të drejtat dhe detyrimet lidhur me marrëdhënien e punës *rregullohen në mënyrë përparësie nga këto burime:*

a) Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;

b) konventat ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë;

c) ky Kod dhe aktet e tij nënligjore;

d) kontrata kolektive e punës;

e) kontrata individuale e punës;

f) rregullorja e brendshme;

g) zakonet lokale dhe profesionale.

2. Aktet nënligjore dalin në plotësim dhe zbatim të dispozitave të parashikuara nga ky Kod. Ato

mund të përcaktojnë kushte pune më pak të favorshme për punëmarrësit sesa ato të parashikuara nga ky Kod vetëm kur kjo parashikohet shprehimisht në këtë të fundit.

3. Çdo dispozitë që shkel një dispozitë të një shkalle më të lartë, është e pavlefshme. Megjithatë, janë të vlefshme vetëm ato dispozita që përmirësojnë pozitën e punëmarrësit.

4. Punëmarrësi nuk mund të heqë dorë nga të drejtat, që rrjedhin nga dispozitat urdhëruese të këtij Kodi ose të kontratave kolektive të punës. Janë të vlefshme marrëveshjet e bëra në prani të inspektorit të punës ose në formën e parashikuar në kontratën kolektive të punës, që kanë si qëllim të mënjanojnë me pajtim një konflikt, duke bërë lëshime të dyanshme, të pranuar me vullnet të lirë nga të dyja palët. Marrëveshjet e sipërpërmendura nuk zbatohen për pushimet vjetore të paguara.

5. Zakonet profesionale zbatohen vetëm kur mungojnë dispozitat ligjore, parashikimet në marrëveshje, kontratë, si dhe kur dispozitat ligjore i referohen shprehimisht zakoneve profesionale.

- *Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”⁵¹*

Neni 1, pg. 3, “Objekti, qëllimi dhe fusha e zbatimit të ligjit”

Fusha e zbatimit të këtij ligji është sistemi arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, përveç aspekteve të strukturës, veprimtarisë dhe qeverisjes së arsimit profesional, që rregullohen me ligj të veçantë.

Neni 2, pika 15, “Përkufizime”

15. “Mësues” është personi që ka fituar të drejtën për të ushtruar profesionin e mësuesit në arsimin parauniversitar.

Neni 56 “Mësuesi”; neni 57 “Profesioni i mësuesit”; neni 58 “Zhvillimi i vazhdueshëm profesional”;

Neni 59 “Kualifikimi i mësuesve”

1. Kategoritë e kualifikimit të mësuesve janë tri:

a) “Mësues i kualifikuar”;

b) “Mësues specialist”;

c) “Mësues mjeshtr”.

2. Rritja në kategori e mësuesit bëhet nëpërmjet përvojës, trajnimit dhe pasi të ketë dhënë me sukses

⁴⁹ Ndryshuar me ligjin nr. 9125, datë 29.7.2003.

⁵⁰ Ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.3.1996; - ndryshuar me ligjin nr. 9125, datë 29.7.2003; - shtuar fjali në fund të pikës 4 me ligjin nr. 136/2015, datë 5.12.2015.

⁵¹ Ky ligj është përafruar plotësisht me: Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Europian (2000/C 364/01), datë 18 dhjetor 2000, numri CELEX 32000X1218(01) Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria C, nr. 364, datë 18.12.2000, faqe 1–22.



provimin përfundimtar të kategorisë përkatëse të kualifikimit. Kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve përcaktohen me udhëzim të ministrit.

3. Çdo kategori kualifikimi shoqërohet me një shtesë në pagë, masa e së cilës përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 60 “Pranimi dhe largimi nga puna i mësuesit”

1. Në institucionin arsimor publik, për një vend të lirë pune, mësuesi emërohet nga drejtori i institucionit arsimor, me konkurrim të hapur. Në komisionet e vlerësimit marrin pjesë përfaqësues të prindërve. Procedurat e konkurimit dhe vlerësimit përcaktohen me udhëzim të ministrit.

2. Drejtori i institucionit publik largon mësuesin nga institucioni, për:

a) shkelje të dispozitave të Kodit të Punës, të këtij ligji e të akteve të tjera nënligjore;

b) shkelje të etikës e të sjelljes në institucion;

c) mosarritje të nxënësve, të përcaktuara në mënyrë objektive, si testimet e drejtorisë së institucionit ose të njësisë arsimore vendore, rezultatet në provimet kombëtare dhe vlerësimi i Inspektoratit Shtetëror të Arsimit.

3. Drejtori i institucionit arsimor publik fillon procedurën e largimit të mësuesit edhe me kërkesë të prindërve dhe vendos largimin pasi konsultohet me përfaqësues të prindërve të institucionit arsimor, sipas procedurave të përcaktuara me udhëzim të ministrit.⁵²

II. Mendimi i mbetur në pakicë si duhet të rregullohet kompetenca lëndore.

Së pari, vlen të sillet në vëmendje se në vështirim krahasues midis rregullimit të dispozitës së nenit 7, germa “ç”, të ligjit nr. 49/2012 para ndryshimeve të pësuara me ligjin nr. 37/2017 dhe riformulimit pas ndryshimeve, ishte e qartë se mosmarrëveshjet në fushën e marrëdhënieve të punës, kur punëmarrës ishte mësuesi i arsimit para-universitar publik i takonin kompetencës lëndore të gjykatave administrative. *Pyetja që shtrohet për zgjidhje, pas ndryshimeve që pësoi ligji nr. 49/2012 në vitin 2017, për të arritur në njësimin e praktikës gjyqësore është a janë sërish kompetente për nga pikepamja lëndore gjykatat administrative, mbështetur në riformulimin e gërmës “ç” të nenit 7?*

Së dyti, vlerësoj se dispozita ligjore (neni 7 germa “ç” pas ndryshimeve të viti 2017) në fjalinë e parë

identifikon katër kategori të nëpunësve shtetërorë, të cilët për mbrojtjen e të drejtave subjektive në marrëdhënien e punësimit kanë të drejtë të paraqesin padi administrative për mbrojtje gjyqësore pranë gjykatave administrative dhe janë si vijon:

a) *Nëpunësit civilë*, punësimi i të cilëve rregullohet me ligj të veçantë, përkatësisht ligji nr. 152/2013 i ndryshuar “Për nëpunësin civil” dhe që nuk hyjnë në fushën e zbatimit të Kodit të Punës, sipas nenit 4, pg. 1 të tij. Duhet vënë në dukje se ligji nr. 152/2013 i ndryshuar është ligj i miratuar prej Kuvendit me shumicë të cilësuar. Në kategorinë e nëpunësve civilë janë: punonjësit e administratës tatimore (brenda sferës së fushës së zbatimit të ligjit nr. 9920/20008 i ndryshuar dhe akteve nënligjore përkatëse, të cilët gëzojnë statusin e nëpunësit civil dhe punojnë në një pozicion pune të shërbimit civil); punonjësit e administratës doganore, (brenda sferës së fushës së zbatimit të ligjit nr. 102/2014 Kodi Doganor dhe akteve nënligjore përkatëse, të cilët gëzojnë statusin e nëpunësit civil dhe punojnë në një pozicion pune të shërbimit civil); punonjës të administratës shtetërore (brenda sferës së fushës së zbatimit të ligjit nr. 90/2012 dhe akteve nënligjore përkatëse, të cilët gëzojnë statusin e nëpunësit civil dhe punojnë në një pozicion pune të shërbimit civil); punonjës administrate të njësive të qeverisjes vendore (brenda sferës së fushës së zbatimit të ligjit nr. 139/2015 dhe akteve nënligjore përkatëse, të cilët gëzojnë statusin e nëpunësit civil dhe punojnë në një pozicion pune të shërbimit civil); punonjës administrate të institucioneve të pavarura (brenda sferës së fushës së zbatimit të ligjit organik të institucionit, si p.sh., Kontrolli i Lartë i Shtetit, Banka e Shqipërisë, Avokati i Popullit etj. dhe akteve nënligjore përkatëse, të cilët gëzojnë statusin e nëpunësit civil dhe punojnë në një pozicion pune të shërbimit civil); kategoria e nëpunësve civilë kanë të përbashkët se, statusi i nëpunësit civil gëzohet pasi të jetë deklaruar me një akt të nxjerrë, sipas rastit, ose prej DAP⁵³ ose prej njësisë përgjegjëse të burimeve njerëzore.

b) *Nëpunës civil gjyqësorë*, brenda sferës së fushës së zbatimit të ligjit nr. 98/2016 i ndryshuar dhe akteve nënligjore përkatëse që nxjerr Këshilli i Lartë Gjyqësor, të cilët gëzojnë statusin e nëpunësit civil dhe punojnë në një pozicion pune të shërbimit civil.

c) *Nëpunësve civilë të prokurorisë* brenda sferës së fushës së zbatimit të ligjit nr. 97/2016 i ndryshuar dhe akteve nënligjore përkatëse që nxjerr Këshilli i

⁵² Ndryshuar me ligjin nr. 56/2015, datë 28.5.2015, botuar në FLZ nr. 105, datë 23.6.2015.

⁵³ Departamenti i Administratës Publike.



Lartë i Prokurorisë, të cilët gëzojnë statusin e nëpunësit civil dhe punojnë në një pozicion pune të shërbimit civil;

dhe

d) *nëpunësit shtetërorë*, që sipas ligjit organik kanë një rregullim të posaçëm. Në këtë kategori prej *praktikës gjyqësore të konsoliduar* prej gjykatave administrative por edhe prej gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm (*në rastin përjashtues*) janë: punonjësit e Policisë së Shtetit që kanë gradë policore; punonjës të shërbimit informativ që kanë gradë në shërbim; punonjës të Gardës së Republikës së Shqipërisë që kanë gradë në shërbim; magistratët, pra gjyqtarët dhe prokurorët e të gjitha niveleve; titullarët e institucioneve të pavarura, si Guvernatori, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Kryetari i Autoritetit të Konkurrencës, Kryeinspektori i ILKPDIK-së etj., të cilët në ligjin organik kanë një mandat kohor të përcaktuar për të ushtruar kompetencat; avokatët e shtetit; punonjës të shërbimit diplomatik të Republikës së Shqipërisë, që gëzojnë statusin e diplomatit sipas gradës së diplomatit apo gradës konsullore.

Vërej se, për secilin rast më lart në kategorinë e katërt, rezulton se kanë element të përbashkët faktin se në secilin akt normative rregullues të profesionit përkatës, është *forma e ligjit të miratuar prej Kuvendit*, për nga *pikëpamja procedurale* dhe së dyti për nga *pikëpamja materiale*, në secilin ligj (*ligji nr. 108/2014 i ndryshuar, ligji 96/2016; i ndryshuar, ligji nr. 97/2016 i ndryshuar, ligji nr. 98/2016 i ndryshuar, ligji nr. 23/2015 i ndryshuar etj.*) është përcaktuar shprehimisht se, në sferën e fushës së zbatimit të ligjit përkatës është rregullimi i punësimit të kategorisë së nëpunësve shtetëror përkatës, në mënyrë të posaçme, referuar përgjegjësi administrative. Të gjithë nëpunësit shtetërorë të kësaj kategorie, *të listuar më lart, për të cilët praktika gjyqësore është e konsoliduar*, janë gjithashtu, kategori e punonjësve, që përjashtohen prej fushës së zbatimit të Kodit të Punës, sipas nenit 4, pg. 1 të tij, element dallues dhe i përbashkët i kësaj kategorie me tri kategoritë e para, pra me nëpunësit civilë, me nëpunësit civilë gjyqësor dhe me nëpunësit civilë të prokurorisë. Kuptohet se, Kodi i Punës ndaj marrëdhënies së punësimit, për nga pikëpamja materiale, të gjithë tyre, pra të katër kategorive, gjen

zbatim, në secilin rast, sipas parimit të subsidiaritetit (pg. 2, neni 4, i Kodit të Punës).

Shtrohet natyrshëm pyetja, po mësuesit pranë sistemit arsimor parauniversitar publik në Republikën e Shqipërisë a janë nëpunës shtetëror, punësimi i të cilëve me ligjin nr. 69/2012 dhe rezervën ligjore përkatëse,⁵⁴ rregullohet në mënyrë të posaçme, si nga pikëpamja formale ashtu dhe nga pikëpamja materiale? A janë nëpunës shtetëror në të njëjtën nivel të aftësive profesionale, nivel drejtues dhe përgjegjës për ushtrimin e kompetencave administrative në të drejtën publike, me katër kategoritë e mësipërme?

Mësuesi, pranë sistemit arsimor parauniversitar publik në Republikën e Shqipërisë, referuar përkufizimit në pikën 15, të nenit 2, të ligjit nr. 69/2012, i ndryshuar, është personi që ka fituar të drejtën për të ushtruar profesionin e mësuesisë në arsimin para-universitar, duke mos u përcaktuar si nëpunës shtetëror, por arrij në përfundimin se, për shkak të varësisë financiare (*pagesat prej buxhetit të shtetit*) dhe varësisë administrative strukturore (*e cila është e dyfishtë midis ministrisë përgjegjëse, Ministria e Arsimit Rinisë dhe Sporteve dhe njësisë së qeverisjes vendore me anë të Zyrës Vendore të Arsimit*) është nëpunës shtetëror. A është punësimi i tyre i rregulluar me ligj organik në mënyrë të posaçme? Në zbatim të nenit 1, pg. 3, të ligjit nr. 69/2012, i ndryshuar,⁵⁵ nuk rezulton se punësimi i tyre të jetë në mënyrë të posaçme i rregulluar, pasi rregullat e përcaktuara në përmbajtje të ligjit nr. 69/2012, i ndryshuar, u drejtohet edhe mësuesve pranë arsimit parauniversitar të institucioneve private, duke mos qenë një rregullim i posaçëm.

Misioni dhe detyra e mësuesit në sistemin arsimor parauniversitar si në atë publik dhe pranë institucioneve private është shumë i rëndësishëm për shoqërinë, në të gjitha nivelet e jetës, qoftë sfera publike qoftë sfera private, pa bërë dallim midis punës që bën mësuesi në arsimin publik me punën që bën mësuesi në institucionin privat. Sigurisht që punësimi i mësuesve, për nga pikëpamja materiale, *pra në drejtim të volumit të të drejtave dhe detyrimeve, si përmbajtje e marrëdhënies së punës, rregullohet prej ligjit dhe akteve nënligjore*. Këtë parashikon dhe lejon neni 11 i Kodit të Punës, në përparësinë e normave dhe zbatimin e tyre, për rregullimin e marrëdhënies së

⁵⁴ Dispozita ligjore, neni 59, pg. 2, fjalio e dytë përcakton se: "Kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve përcaktohen me udhëzim të ministrit."

⁵⁵ Dispozita ligjore përcakton se: "Fusha e zbatimit të këtij ligji është sistemi arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, përveç aspekteve të strukturës, veprimtarisë dhe qeverisjes së arsimit profesional, që rregullohen me ligj të veçantë."



punës dhe kështu ndodh për çdo profesion, mësues, mjek, aktor, pedagog, marangoz, punonjës administrativ etj., por pavarësisht marrëdhënies së punës nuk përjashtohet prej fushës së zbatimit, sipas personave, nga Kodi i Punës, përkundrazi.

Kjo do të thotë se, referuar rregullimit të profesionit përkatës është e nevojshme për arsye nga më të ndryshme që me ligj (në kuptimin formal) apo me akte nënligjore të autorizuar prej tij, të përcaktohen kriteret dhe kushtet për punësim, që janë detajuese për këtë profesion dhe është e kuptueshme, pasi përmbajtja e marrëdhënies së punës, nuk mund të parashikohen vetëm prej Kodit të Punës, për çdo profesion specifik. Nga ana tjetër, “ky rregullim plotësues i profesionit” nuk barazohet me faktin se, marrëdhënia e punësimit ka një rregullim të posaçëm, të të njëjtës kategori dhe të njëjtut nivel me të katër kategoritë e germës “ç”, të nenit 7, të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar. Gjithashtu, si gjyqtare administrative vlerësoj se, në drejtim të nivelit të aftësive profesionale për ushtrimin e detyrës së mësuesit, të nivelit drejtues dhe nivelit të ushtrimit të përgjegjësisë dhe kompetencave administrative në të drejtën publike, nuk mundet objektivisht të jetë e njëjtë me katër kategoritë, e përcaktuara në nenin 7, germa “ç”, të ligjit me nr. 49/2012, i ndryshuar.

Gjithsesi, punësimi i mësuesve, duke qenë se hyn në fushën e zbatimit të Kodit të Punës, sipas personave, bën që sentenca unifikuese e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në vendimin me nr. 7, datë 1.6.2011 të jetë e detyrueshme për zbatim, në rastin e zgjidhjes së marrëdhënies së kontratës së punës. Kështu, Kolegjet e Bashkuara, në këtë vendim kanë shtruar midis të tjerave për unifikim dhe faktin që e trajtojnë zgjidhjen e kontratës së punës si konflikt administrativ apo si konflikt që rrjedh nga marrëdhëniet e punës dhe ato arrijnë në përfundimin se: **“Në rast të zgjidhjes së kontratës së punës, pavarësisht se organi administrativ për rastet e administratës publike shprehet me një akt të marrë nga drejtuesi i organit, kjo nuk do të thotë që jemi përpara marrëdhënieve administrative pra shprehjes së vullnetit të organit në kuptim të marrëdhënieve administrative por jemi përpara shprehjes së vullnetit të punëdhënësit për zgjidhjen e kontratës së punës. Pra, me këtë do të kuptojmë se kemi të bëjmë me një marrëdhënie pune midis punëdhënësit dhe punëmarrësit dhe jo më me një marrëdhënie administrative. Pra, punëmarrësi nuk mund të**

ngrejë padi për goditjen e aktit administrativ por mund të ngrejë padi për kërkimin e pasojave që rrjedhin nga zgjidhja e kontratës së punës.”

Ndërsa, për personat punësimi i të cilëve rregullohet me ligj të veçantë dhe që nuk hyn në fushën e zbatimit të Kodit të Punës, sipas personave, nuk gjen zbatim kjo sentencë unifikuese, që do të thotë që në të gjitha këto raste konflikti në gjykatë do jetë konflikt administrativ dhe rrjedhimisht mosmarrëveshja hyn në kompetencën lëndore të gjykatave administrative, ndaj dhe për katër kategoritë e germës “ç”, të nenit 7, gjykatat administrative përveçse shprehen për ligjshmërinë e veprimit administrativ, që ndikon në vijueshmërinë e marrëdhënies së punësimit, rregullojnë pasojat ligjore, në rastin që kanë vlerësuar paligjshmërinë. Në të tillë mënyrë veprimi, brenda sferës së tyre të kompetencës lëndore gjykatat administrative gëzojnë të gjitha atributet për të garantuar akses efektiv, në zbatim të nenit 42 dhe nenit 43 të Kushtetutës, në gjykimin e padive administrative për mbrojtjen e të drejtave subjektive, që rrjedhin prej punësimit të nëpunësve shtetërorë, sipas katër kategorive të listuara në germën “ç”, të nenit 7, të LGJA-së.

Përjashtimi i fjalisë së dytë në këtë dispozitë, duhet lexuar dhe rrjedhimisht kuptuar ngushtësisht, që i drejtohet për zbatim vetëm kategorisë së përcaktuar. Ky përjashtim sipas LGJA-së i referohet vetëm administratës në gjykatë dhe në prokurori. Përjashtimet e shprehura në ligj nuk mund të gjejnë zbatim me anë të analogjisë, për raste të ndryshme nga ato të përcaktuara në ligj. Nëse zbatojnë analogjinë mund të arrihet edhe në një përfundim tjetër në këtë rast, që është edhe më i thjeshtë, i cili mund të jetë që për sa kohë punësimi i mësuesit hyn në fushën e zbatimit të Kodit të Punës, bën përjashtim nga rregulli i germës “ç”, të nenit 7, të LGJA-së. Por, vetëm kjo metodë nuk mund të jetë e vlefshme për të identifikuar kompetencën lëndore midis gjykatave, ndaj duhet të analizohen në tërësi dhe të përdoren njëherësh dhe në mënyrë krahasuese disa metoda interpretimi të ligjit, për të arrirë një përfundim me baza në ligj. Vlerësoj se termi “ligji organik që ka rregullim të posaçëm” duhet interpretuar nga Kolegji brenda funksionit të tij kushtetues, pavarësisht kuptimit të termit “gjykata e caktuar me ligj” që përpunon GJEDNJ-ja, pasi siç vet ajo përcakton në shumë vendime të saj *konceptet e përpunuara në jurisprudencën e saj janë autonome në drejtim të zbatimit të KEDNJ-së*, ndërsa Kolegji ka detyrë të



interpretojë ligjin organik, në këtë rast, LGJA-ja dhe t'i japë kuptim këtij termi në zbatim të këtij ligji.

III. Për çështjen konkrete.

Pala paditëse ka ushtruar detyrën e mësueses pranë shkollës 9-vjeçare “Mihal Grameno”, ku është emëruar “Mësuese provizore” deri në përfundim të paaftësisë së përkohshme në punë të mësueses E.K. Në kushtet kur paaftësia e përkohshme në punë e mësueses së profilin ka vijuar, paditësja është riemëruar më datë 11.9.2017 si mësuese provizore me kushtin që marrëdhënia punës do të përfundonte kur të përfundonte paaftësia e përkohshme në punë e mësueses E.K.

Mësuesja e emëruar në profilin anglisht E.K. ka mbush moshën sipas ligjit për përfituar pensionin e pleqërisë dhe rrjedhimisht në datë 25.5.2021 është përfunduar marrëdhënia e punësimit. Me anë të vendimit nr. 197, datë 8.7.2021, punëdhënësi ka vendosur të përfundojë marrëdhënien e punës me paditësen Brunilda Gjeçi si mësuese zëvendësuese/provizore në shkollën 9-vjeçare “Mihal Grameno” Tiranë, me shkakun e mbarimit të afatit të kontratës.

Në kontratën e punës së paditëses është bërë shënimi për përfundimin e marrëdhënies së punës më datë 21.7.2021, për shkak të përfundimit të afatit.

Pala paditëse ka pretenduar se largimi nga puna si mësuese pranë shkollës 9-vjeçare “Mihal Grameno” përbën zgjidhje të menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës në referim të nenit 155 të Kodit të Punës. Në këto rrethana, në datë 15.12.2021 i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me padinë objekt gjykimi.

Në mbështetje të përfundimeve të arritura mbi analizën ligjore të mësipërme vlerësoj se, vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me të cilin është shpallur moskompetenca lëndore për gjykimin e çështjes është i pambështetur në ligj dhe duhet të priset duke dërguar çështjen për shqyrtim pranë saj si gjykata kompetentë në lëndë.

Tiranë, më datë 7.7.2023

GJYQTARE
Arbena Ahmeti

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2023

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 320 lekë